

Milena Ristovska

DORACAK
PËR
VENDOSJEN FEKTIVE DHE
IMPLEMENTIMIN E
TË MËSUARIT SHËRBYES NË
ARSIMIN SIPËROR

Redaktorë:

Ana M. Llazervska
Aleksandar Nikollov
Mirjana Stankoviq

Shkup, 2012

Milena Ristovska

**DORACAK
PËR
VENDOSJEN FEKTIVE DHE
IMPLEMENTIMIN E
TË MËSUARIT SHËRBYES NË
ARSIMIN SIPËROR**

Redaktorë:

**Ana M. Llazervska
Aleksandar Nikollov
Mirjana Stankoviq**

Shkup, 2012

Përkthimi nga gjuha angleze:
Milena Ristovska
Dejan Spaseski

Përkthimi në shqip
Gramoz Shabani

Faqosja teknike:
Ana Llazarevska
Aleksandar Arsov

Dizajni i ballinës:
Aleksandar Arsov

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

378.091.3

RISTOVSKA, Milena

Doracak për vendosjen efektive dhe implementimin e të mësuarit
shërbyes në arsimin supëror / Milena Ristovska ; redaktorë Ana M.
Llazarevska, Aleksandar Nikollov, Mirjana Stankoviq. - Skopje :
Makedonsko amerikanska alumni asocijacija, 2012. - X, 72 стр. ; 25
cm

Фусноти кон текстот. - Parathënie e kryeredaktorit / Ana
Llazarevska: стр. V-VII

ISBN 978-608-4700-08-1

a) Високо образование - Методи на учење
COBISS.MK-ID 92878346

Ky publikim u kushtohet të gjithë atyre që me pasion dhe vullnet mësojnë dhe të cilët gjatë angazhimeve të tyre kanë për qëllim të arrijnë diçka të rëndësishme, nuk frikësohen të ballafaqohen me sfidat dhe të ballafaqohen me frikët dhe dyshimet! Ky publikim, gjithashtu, u përkushtohet të gjithë mentorëve dhe këshilltarëve akademik, si dhe prindërve tuaj të cilët na japin liri të hulumtojmë, të cilët na treguan në cilin drejtim të shohim, por jo edhe çfarë të shohim dhe besuan te ne gjatë gjithë punës sonë! Pa orientimin e tyre me durim, inkurajimin e përhershëm dhe pa kritikën e tyre konstruktive nuk do të kishim arrirë deri te 'Itaka' jonë!

Itaka

nga Konstantin P. Kavafi¹

*Kur do të nisesh në rrugë për në Itakë,
kërko që udhëtimi të zgjasë gjatë,
të jetë plot me aventura, të kesh shumë drejtime.
Listrigonë dhe ciklopë,
Posedoni i zemëruar – aspak nuk trembet nga ata –
këtyllë si ata kurrë nuk do të takosh
derisa kanë mendime fisnike, të madhërishe,
derisa ndonjë ndjenjë e rrallë e prek shpirtin tënd dhe trupin tënd.
Listrigonët dhe ciklopët
dhe Poseidonin e zemëruar kurrë nuk do ti takosh,
nëse nuk i mbajnë në shpirtin e tyre,
nëse vetë shpirti yt nuk i radhit gatitu para teje.*

*Dëshiro që rruga jote të jetë e gjatë.
Kërko në agimin sumere të hysh
me zemër plot me falënderime, me gëzim –
për herë të parë t'i shoshi ato limane,
të qëndrosh në vendin ku nisen fenikasit
dhe të blesh mall të mirë –
sedef dhe koral, qelibar dhe fildish
dhe parfume seksuale të çdo lloji,
aroma seksuale që të magjepsin –
dhe atë sa na do shpirti.
dëshiro të vizitosh shumë qytete egjiptiane
dhe të mbledhin shumë dituri nga nxënësit.*

*Gjithnjë mbaje në mend Itakën!
Ti je caktuar të arrish deri te ajo.
Por, mos shpejto dhe të dëshirosh të mbarojë shpejt udhëtimi.
Më mirë të zgjatë me vite
që të arrish në ishull kur të jenë të moshuar,
i pasur me gjithë atë që e ke fituar gjatë rrugës,
pa pritur Itaka të të ofrojë çfarëdo pasurie.
Itaka të dhuroj udhëtim të mrekullueshëm.
Pa atë ti nuk do niseshe në rrugë të gjatë.
Ajo nuk ka më ç'të dhurojë.*

*Dhe nëse ti ja arsyeja se është e varfër, atëherë ta dish se Itaka nuk të ka mashtruar.
Ti bëju aq i mençur, plot me përvoja të jashtëzakonshme,
që edhe vetë kuptove çfarë në të vërtetë paraqet Itaka.*

¹ E marrë më 8 korrik 2012 nga: <http://www.poemhunter.com/poem/ithaca/>. Përkthimi nga gjuha angleze në maqedonisht sipas Milena Ristovska.

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	ii
LISTA E TERMEVE KRYESORE TË PËRDORURA	iv
PARATHËNIE E KRYEREDAKTORIT	v
PARATHËNIE E AUTORIT	viii
KAPITULLI 1: ÇFARË NË TË VËRTETË PARAQET TË MËSUARIT SHËRBYES?	1
Hyrje	1
Qasje për përcaktimin e të mësuarit shërbyes	4
Karakteristikat kryesore ose dimensionet e të mësuarit shërbyes	5
1) <i>Nga të mësuarit empirik deri te programet për ndihmë bashkësisë</i>	<i>6</i>
a) Të mësuarit empirik (të mësuarit përmes përvojave)	6
b) Programi për ndihmë bashkësisë	7
2) <i>Integrimi i të mësuarit shërbyes në procesin e realizimit të mësimit dhe në përmbajtjet mësimore nga lëndët.....</i>	<i>9</i>
a) Qëllimet e të mësuarit shërbyes	9
b) Qasjet drejt dizajnit të lëndës mësimore për të mësuarit shërbyes	11
c) Modele të lëndëve mësimore për të mësuarit shërbyes në programin mësimor	15
d) Implementimi i të mësuarit shërbyes në kuadër të procesit mësimor	17
e) Roli i kuadrit mësimor në projektin e të mësuarit shërbyes.....	19
f) Nxitja themelore për studentët të bëhen pjesë nga detyrat dhe projektet për të mësuarit shërbyes.....	21
3) <i>Dallimet mes të mësuarit shërbyes dhe llojeve tjera të mësuarit të bazuar në bashkësi... ..</i>	<i>22</i>
Bazat filozofike dhe pedagogjike të mësuarit shërbyes.....	24
Histori e shkurtër e të mësuarit shërbyes në SHBA.....	27
Efekte nga të mësuarit shërbyes.....	29
1) <i>Efektet e të mësuarit shërbyes te studentët.....</i>	<i>31</i>
2) <i>Ndikimi i të mësuarit shërbyes mbi kuadrin mësimor në fakultete</i>	<i>33</i>
3) <i>Dobia për klientët dhe bashkësinë.....</i>	<i>35</i>
LITERATURA E SHFRYTËZUAR PËR KAPITULLIN 1	36
ON-LINE RESURSE TJERA PËR KAPITULLIN 1	38
KAPITULLI 2 ASPEKTET PRAKTIKE TË INKORPORIMIT TË MËSUARIT SHËRBYES NË INSTITUCIONET E ARSIMIT SIPËROR.....	39
Hyrje.....	39
Reformimi i gjendjes aktuale në arsimin sipëror përmes implementimit të Planit gjithëpërfshirës së veprimit për të mësuarit shërbyes (CAPSL)	39
Themelimi i partneriteteve mes bashkësisë dhe kampit universitar në fushën e të mësuarit shërbyes.....	44

Vendosja dhe vlerësimi i qëllimeve dhe kursit, rezultateve nga të mësuarit dhe kompetencat e fituara	46
Planifikimi i udhëzimeve dhe aktiviteteve në kuadër të lëndës.....	51
Zgjedhja e teksteve dhe resurseve tjera për të mësuar	57
Dizajni i evoluimeve të lëndës dhe planet për avancimin e tij.....	57
Ndërtimi i infrastrukturës për lëndën mësimore	61
Qëndrueshmëria e lëndëve të cilat përmbajnë të mësuarit shërbyes	63
Praktikumi i formave të mësuarit shërbyes që mbajnë llogari për dallimet kulturore (të mësuarit shërbyes kulturor kompetente - Culturally Competent Service-Learning).....	65
LITERATURA E SHFRYTËZUAR PËR KAPITULLIN 2	67
ON-LINE RESURSE TJERA PËR KAPITULLIN 2	67
KAPITULLI 3 VËREJTJE PËRFUNDIMTARE DHE HAPA TË ARDHSHME TË MUNDSHME.....	69

LISTA E TERMEVE KRYESORE TË PËRDORURA

Shqip	Anglisht
Fondi për angazhim inovativ të alumnive	Alumni Engagement Innovation Fund
Të mësuarit e bazuar në përvojë me/nga bashkësia	Community-Based Learning
Teoria e të mësuarit nga përvoja (të mësuarit përmes përvojave të fituara)	Experiential Learning Theory
Nota mesatare	Grade Point Average
Këshilli institucional për revizion	Institutional Review Board
Programi për zhvillimin e kuadrit të ri mësues	Junior Faculty Development Program
Analiza e nevojave dhe përgatitja e lëndës – lëndë e cila ligjërohet në Universitetin e Evropës Juglindore, Tetovë	Needs Analysis and Course Design – course taught at the Southeast European University, Tetovo.
Organizatë joqeveritare	Non-governmental organization
Persona me handicap / pengesa / invaliditet/	Persons with disabilities
Refleksion	Reflection
Të mësuarit shërbyes	Service-learning
Departamenti i shtetit i SHBA-ve	U. S. Department of State
Zona e zhvillimit të proksimal	Zone of Proximal Development

PARATHËNIE E KRYEREDAKTORIT

E kujtoj atë pasdite të vonë në shkurt të vitit 2011 kur dr. Aida Koçi dhe unë ishim ulur në një lokal që të bisedonim për pikat kryesore të paraqitjes sonë potenciale për projektin, i cili duhej të financohet nga Fondi për angazhimin inovativ të alumnive (Alumni Engagement Innovation Fund) të programeve të ndryshme për shkëmbim, të financuara nga US Department of State. Kjo ishte hera e parë që shpallej thirrje për paraqitje të projekteve të këtij lloji dhe ne aspak nuk e dinim se me kë të konsultohemi që të fitojmë njohuri rreth procesit të aplikimit. Edhe më shumë, unë dhe nuk kisha ndonjë përvojë të madhe me paraqitje të projekteve – ky ishte aplikimi im i dytë që vijoi pas projektit të përfunduar me sukses, me të cilin u organizua Konferencë rajonale të alumnive nga Programi për zhvillim të kuadrit të ri mësimor (Junior Faculty Development Program – JFDP) me titull “Avancimi i qasjes të arsimit sipëror për personat me nevoja të veçanta”, që u mbajt nga 22 deri 24 nëntor të vitit 2010 në Shkup dhe Ohër, ndërsa u financua me grant nga JFDP.

Të jem e sigurtë, në momentin e parë aplikacioni na u duk si kafshatë e madhe. Nga njëra anë, shumë mirë e dinim çfarë rëndësie ka tema me të cilën dëshironim të aplikojmë (inicimi i aplikimit të metodologjisë të mësuarit shërbyes në institucionet e arsimit sipëror në Maqedoni dhe Kroaci), nga njëra anë, duhej të mbajmë llogari edhe për rëndësinë e madhe të bashkësive, për nevojat e të cilave dëshironim të ndihmojmë me propozimin tonë – projekti (personat me handicap, për të drejtat e të cilëve me qasje të barabartë ndaj arsimit dhe sferat tjera të jetës akoma bëhet betejë e hapur në shoqëritë tona). Megjithatë, unë besoj se pikërisht ky bashkim ishte me rëndësi të madhe kur e përpilonim versionin final të propozim-projektit tonë me titull “Sigurimi i qasjes së barabartë përmes të mësuarit shërbyes për personat me nevoja të veçanta”[†]. Nga ne, propozuesit e projektit, të cilët punojmë në institucionet sipërore arsimore dhe të cilat në të njëjtën kohë e kemi nderin të jemi alumni të njërit nga programet e financuara nga State Departament, pritej t’i identifikojmë dhe t’i përkufizojmë qartë problemet/çështjet sociale për të cilat është e domosdoshme që menjëherë dhe me shumë punë dhe entuziazëm t’u qaset, që të mund të paktën bashkëqytetarëve tanë – personave me handicap – t’u lehtësohet, nëse jo tërësisht t’u mundësohet jetë modeste, ku ata do të kenë mundësi të barabarta, si edhe qytetarët tjerë. Ajo që e bën projektin tonë të veçantë, është fakti se nuk i përmbledhin angazhimet dhe përpjekjet tona më shumë se sa *sigurimi i qasjes së barabartë dhe të drejtave të barabarta për personat me handicap*, por në mënyrë paralele dhe de facto, kjo është edhe lufta për të drejtat tona dhe për vetë ne, pasi që të gjithë ne në një periudhë të caktuar nga jeta jonë kemi qenë, jemi ose do të jemi persona me ndonjë lloj të nevojave individuale me të cilat personat me handicap ballafaqohen çdo ditë.

Energjia dhe nxitja për të shkruar në propozim-projektin i merrja nga përvojat, të cilat i fitova gjatë vizitave të mëparshme të mia të studimit në SHBA, Japoni, Gjermani dhe në disa vende të tjera evropiane. Derisa punoja dhe përkohësisht qëndroja në këto vende, fillova të vetëdijesohej dhe t’i perceptoj personat me handicap të ndryshëm – në rrugë, në institucionet arsimore, në teatër, operë, në kinema, në vetëshërbim, tregje, në ngjarje sportive – dhe fillova të shoh se si ata kënaqen në gëzimet e përditshme që i sjell jeta. Do të isha më e lumtur nëse edhe në vendin tonë do të kishte kushte të tilla për bashkëqytetarët tanë – personat me ndonjë invaliditet. Prandaj mendoj se ky projekt është vetëm një gur – themelet e rrugës drejt mençurisë dhe magjisë, që do të na ndihmojë të arrijmë deri te pjesët më të thella dhe më të sigurtat të zemrave dhe mendjes sonë dhe në këtë mënyrë t’i pranojmë personat me nevoja të veçanta.

Sa i përket publikimit, ky është një nga rezultatet e projektit AEIF, me të cilin të gjithë ne u përpoqëm të kontribuojmë në sigurimin e qasjes së barabartë për personat me nevoja të veçanta. Qëllimi ynë ishte t’u ndihmojmë kuadrit arsimor dhe administrativ, të punësuar (para së gjithash, por jo vetëm) në institucionet e larta arsimore, që të hulumtojnë mënyra dhe metoda të reja për ligjërim, përmes së cilave

[†] <http://www.equalaccess4pws.org>

në planin mësimor do të inkuadronte edhe çështje të tjera thelbësore sociale, siç është çështja e qasjes së barabartë të grupeve të caktuara të shfrytëzuesve/konsumatorëve/klientëve, të cilët në rastin tonë janë personat me invaliditet. Qëllimi ynë ishte, me këtë doracak ta tërheqim vëmendjen e opinionit drejt të mësuarit shërbyes dhe ta sqarojmë si kjo metodologji do të duhej të përdoret që të ndërtohet një sinergji multidimensionale dhe e shumëfishtë mes kuadrit mësimor në fakultetet, studentëve, institucioneve dhe bashkësisë më gjerë. Gjithashtu, qëllimi ynë ishte ta forcojmë vetëdijen se të gjithë duhet t'i bashkojmë forcat dhe përpjekjet në luftën për nevojat e përbashkëta dhe për një jetë më të mirë dhe më të rëndësishme, si dhe vetëdijen se duhet të bëjmë çmos që personave me handikap në të gjitha nivelet dhe sferat në shoqëri t'u garantohet, sigurohet, avancohen dhe forcohen të drejtat të cilat njëlloj i gëzojnë si dhe të gjithë qytetarët tjerë.

Në rend të parë, do të kisha dashur, në emër të gjithë ekipit të projektit ta shpreh falënderimin deri te **Zyra e alumneve të State Departamentit, Këshillit drejtues të AEIF, si dhe të Bordit pranë AEIF të cilët i kanë vlerësuar propozim-projektet**, për vendimin e tyre që të seleksionohet propozim-projekti ynë. Në konkurrencën e 683 projekteve prej të cilave 137 ishin zgjedhur si finalistë, projekti ynë ishte në vendin e tretë pas votimit transparent në nivel global dhe në fund ishte mes 38 projekteve të cilët fituan mbështetje financiare. Besoj se sukcesi ynë nuk do të ishte i mundur nëse nuk e kishim mbështetjen e vazhdueshme të ekipit që punoi në **Zyrën për marrëdhënie me opinion pranë Ambasadës së SHBA-ve në Republikën e Maqedonisë**. Falënderim të veçantë dëshiroj t'i shpreh z. **John Surface**, ish Atasheu për kulturë dhe arsimit pranë Ambasadës së SHBA-ve në Republikën e Maqedonisë, që e njohu rëndësinë e idesë sonë, besoi tek ne dhe me ekipin e vet na ofroi mbështetje morale dhe në logjistikë gjatë procesit të aplikimit. Ai e "shtroi rrugën" për punën e sjellshme të z. **Brian P. Bauer**, i cili pastaj u caktua për kryes të detyrës së njëjtë dhe të cilit i kemi borxh shumë për gjithë mbështetjen morale dhe në logjistikë gjatë implementimit të projektit.

Me këtë rast do të kisha dashur t'u falënderoj rrethanave të mira të cilat e sollën miken time **Milena Ristovska** nga Instituti për njohuri dhe inovacione pranë George Washington University, Washington DC (përndryshe, gjithashtu JFDP alumni), mu atëherë dhe atje kur na nevojitej më së shumti. Do t'j kisha dashur t'i falënderohem për gatishmërinë e saj të jashtëzakonshme të punojë dhe të jetë autorja kryesore e këtyre drejtimeve. Milena punoi nën mbikëqyrjen e një mikeje time, e cila gjithashtu është ko-udhëheqëse e këtij projekti nga Maqedonia – **dr. Aida Koçi**, alumni e JFDP dhe docent pranë Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë. Nuk ka dyshim se Aida është pioniere e vërtetë në fushën e implementimit të metodologjisë së të mësuarit shërbyes në Republikën e Maqedonisë. Personalisht jam e bindur se besimi i rolit me përgjegjësi i autorit dhe rregullimi i këtij doracaku të Milenës dhe Aidës ishte vendim i vërtetë dhe i drejt.

Mes anëtarëve të ekipit tonë sundon pajtim i njëzëshëm se ky publikim nuk do të kishte cilësinë e duhur, nëse nuk ishte angazhimi i ko-redaktorit të versionit anglez të këtij doracaku nga Universiteti Xhorxh Uashington (The George Washington University), **prof. Dr. Michael A. Stankosky**, Kryesues me Institutin për njohuri dhe inovacione. Atij veçanërisht i falënderohem që menjëherë iu përgjigj ftesës sonë për bashkëpunim, që në mënyrë jo vetjake dhe me kompetencë hyri në procesin e hulumtimit dhe të shkruarit, dhe më në fund, por jo edhe më pak e rëndësishme, që gjithnjë ishte i kapshëm për komunikim dhe ndihmë përtej mijëra miljeve larg dhe gjashtë zonave kohore dhe atë vetëm me një klik të tastaturës! **Prof. Stankosky**, Ju me të vërtetë shumë kontribuat për projektin tonë!

Më tej, kisha dashur t'i falënderohem bashkëpunëtores sime **dr. Ivana Biliq** nga Universiteti i Splitit, e cila i koordinoi aktivitetet që në kuadër të këtij projekti u realizuan në Kroaci dhe **dr. Jerko Markovina** nga Universiteti në Zagreb, si dhe **gjithë ekipit të angazhuar në këtë projekt, i cili përbëhet prej individësh plot me entuziazëm dhe të gatshëm ta ndjekin tempin e punës që e kërkonte realizimi i aktiviteteve në projektin tonë**.

Dhe më në fund, do të kisha dashur t'i falënderohem mikeshave dhe bashkëpunëtoresve të mia **Daniella Stojanovska – Xhingovska** nga Shoqata e studentëve dhe të rinjve me handikap, **Jagoda Risteska** dhe **Jasmina Risteska** nga Mobiliteti sfidë!, **Biljana Manevska, Vesna Stojanovska** dhe të

gjithë personave të tjerë me handikap, të cilët ishin pjesë e jetëve tona dhe i prekën zemrat tona. Ata janë “skeleti” i këtij dhe të ndonjë projekti tjetër në këtë fushë dhe e prezantojnë thelbin moral nga i cili i shterëm idetë dhe energjinë tonë.

Shpresoj se me punën tonë të gjithë ne bashkë e dëshmuam dhe e plotësuam të gjithë atë që e parapamë dhe që pritej nga ne.

**Shkup,
gusht 2012**

Kryeredaktor dhe Udhëheqës i Projektit AEIF

dr. Ana Llazarevska

docent
Fakulteti i Makinerisë – Shkup,
Universiteti “Shën Qirili dhe Metodi”,
Shkup, R. Maqedonisë

PARATHËNIE E AUTORIT

Të gjithë ata që ndonjëherë kanë marrë pjesë në prezantimet për Junior Faculty Development Program (JFDP), e kanë ndjekur trajnimin për orientim para nisjes për në qëndrimin studimor përmes këtij programi ose ndoshta ndonjëherë e kanë ndjekur prezantimin e atyre që sapo janë kthyer nga qëndrimi studimor, shumë herë kanë dëgjuar se “JFDP është një përvojë e mahnitshme pas të cilës jeta ndryshon në mënyrë drastike”. Në të vërtetë, të gjithë ne e kemi dëgjuar këtë shprehje aq shumë sa ndonjëherë na duket se këto fjalë vazhdimisht tingëllojnë dhe bëhen simbol i secilit që ka qenë në qëndrim studimi në ndonjë nga universitetet në SHBA. Aq më shumë, shumë shpesh na duket se me këtë shprehje këshillat amerikane për arsim ndërkombëtar (American Councils of International Education) na “mashtrojnë” dhe na tërheqin të gjithë ne të cilët përpiqemi në karrierën akademike të arrijmë rezultate madhore.

Dhe para se të mendoni se kjo është një nga klishetë e shumtë dhe marrëzira ndaj të cilave shpesh jemi të ekspozuar, do të kisha dashur të them se Byroja për marrëdhënie arsimore dhe kulturore (Bureau of Educational and Cultural Affairs [ECA], U.S. Department of State) dhe Këshillat amerikane për arsim ndërkombëtar pothuaj pa përjashtim dhe gjithnjë arrijnë ta plotësojnë atë që e kanë premtuar, të përmbajtur në këtë shprehje, që pak tingëllon edhe si fluturim nga gëzimi! Unë jam vetëm një nga qindra bursistët e JFDP, karriera akademike dhe jeta personale së cilës me siguri ka ndryshuar për shkak të qëndrimit tim studimor në SHBA.

Me qëndrimin tim 5 mujor në School of Business, George Washington University në vitin 2009 filloi “Odiseja” ime e vendosjes së kontakteve me profesorë nga jashtë vendit, ndjekja e mësimave dhe regjistrimi im në studimet e doktoraturës në School of Engineering and Applied Science, George Washington University – diçka që ishte më shumë nga ajo që kam shpresuar ose dëshiruar. Aq më shumë, se u bëra shoqe shumë e mirë me Rozita Petrinska – Labudoviq, Zorica Trajkova, Ana Llazarevska, Jane Bozhinovski, Aleksandar Naumoski dhe Marija Grishan (‘FAMILJA JONË’ siç shumë shpesh e quanim veten dhe emër me të cilin i shënojmë fotografitë tona në Facebook) dhe u bëra pjesë e të ashtuquajturit ‘fisi i JFDP’ që vazhdimisht shtohet dhe zmadhohet me çdo kontakt përmes Skype, Facebook dhe sy më sy që e kam me Ivana Biliq, Jerko Markovina, Velika Pejkovska – Angelkova, Nijaz Jagublu, Natasha Krivokapiq, Kreshimir Krolo, Mirta Bijukoviq – Marshiq, Meldina Kokoroviq – Jukan, Natalija Borgull, Zamzagull Kashkinbajeva, Gubad Bajramov dhe shumë të tjerë. Tani për tani, asnjë përvojë tjetër të shkëmbimit kulturor dhe shkëmbimit të përvojave nuk mund t’i bëjë ballë kësaj! Edhe sa të mos dëshiroj të përdor shprehje patetike, megjithatë ndjej nevojë të fuqishme për ju, shokët e mi nga JFDP, t’ju falënderohem që në kuptimin e vërtetë të fjalës e pasuruar jetën time dhe që gjithnjë më gëzoni me gjestet tuaja të miqësisë së vërtetë!

Në të vërtetë, edhe vetë publikimi është rezultat i takimeve me Anën, Ivanën, Velikën, Jerkon, Bojan Karanakovin, Bogdan Jovanovskin dhe të tjerë që ndodhi me “spontanitet mirë të planifikuar” gjatë punëtorisë së pestë në kuadër të projektit “Qasja e barabartë për personat me handicap përmes të mësuarit shërbyes”. Jam e bindur se nuk do të isha autore, nëse nuk e kisha besimin pa rezervë të **doc. Dr. Ana Llazarevska** në shkathtësitë e mia për hulumtim dhe të shkruarit krijues dhe pa sugjerimet konstruktive të **dr. Aida Koçi** nga Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë. Si pioniere e vërtetë në fushën e të mësuarit shërbyes në Maqedoni, Aida më ndihmoi shumë si “mentori” im në atë mënyrë që e vendosi “skeleton” e këtij doracaku dhe e lehtësoi procesin e të shkruarit kreativ vetëm pa një takimi dhe e-maileve të shumtë që i shkëmbyem çdo ditë.

Gjithashtu, do të kisha dashur ta shpreh falënderimin George Washington University, Washington DC dhe bibliotekës Gelman për qasjen deri te revistat e shumta shkencore dhe profesionale, librave, literaturës ndërkombëtare, kuadri kompetent mësimor, hulumtues dhe administrativ dhe aq më shumë që ata më mundësuan si gjatë studimeve të mia të doktoraturës, ashtu edhe gjatë përgatitjes së këtij doracaku. Në të vërtetë, ky doracak ose përmbledhje e drejtimeve për implementimin praktik të

mësuarit shërbyes është rezultat i drejtpërdrejt i bashkëpunimit trevjeçar me kuadrin profesional dhe bashkëpunëtorët nga Instituti për njohuri dhe inovacione (Institute for Knowledge and Innovation [IKI]) pranë George Washington University, **Fakulteti i bizneseve (School of Business)** dhe **Fakulteti për inxhinieri dhe shkencën aplikative (School of Engineering and Applied Science)**. Falënderim të veçantë i shpreh edhe mentorit tim **prof. Michael A. Stankosky**, Drejtor i përgjithshëm dhe Kryesues me Institutin për njohuri dhe inovacione, për atë që gjithnjë insistonte në mënyrë konsekuente të arrihen standarde të larta për rezultatet të jashtëzakonshme në punën akademike dhe për ndihmën e tij të madhe në përpilimin e këtij doracaku, si dhe **prof. Thomas Mazzuchi**, shef i Departamentit për menaxhment të inxhinierisë dhe inxhinierisë sistemore (Engineering Management and Systems Engineering) pranë Fakultetit për inxhinieri dhe shkencë aplikative, për atë që më mundësoi si studente-doktor në programin për Menaxhimin me njohuri dhe informacione (Knowledge and Information Management Doctoral Study Program) të kem qasje deri te resurset financiare dhe administrative me të cilat disponon departamenti.

Kam kënaqësi të veçantë që në përpjekjet për përgatitjen e këtij publikimi në mënyrë jo vetjake u inkuadrua edhe **Aleksandar Nikolov**, kryetar i Trupit koordinues nacional për përgjegjësi shoqërore të ndërmarrjeve (TKNPSHN) dhe autor i programeve shtetërore të Maqedonisë dhe Serbisë për nxitjen e përgjegjësive shoqërore. Me Aleksandërin bashkëpunojmë nga viti 2002 në promovimin e përgjegjësive shoqërore – që është e lidhur ngushtë me format e ndihmës të bashkësisë – kur e organizuam ngjarjen e parë pioniere të Fakultetit Ekonomik pranë Universitetit “Shën Qirili dhe Metodi” në Shkup për aktualizimin e këtij koncepti para publikut të gjerë nga bashkësia akademike, sektori afarist dhe organet shtetërore. I falënderohem edhe **Mirjana Stankoviq** nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, përndryshe mike ime shumëvjeçare dhe kolege-hulumtuese, për të gjitha idetë krijuese, angazhimet e pafundme dhe të përkushtuara gjatë përgatitjes së këtij doracaku, si dhe **Dejan Spaseski**, autor i një bllogut eminent për zhvillim personal “Arsimi joformal” (www.no.net.mk), për ndihmën e jashtëzakonshme gjatë përkthimit të doracakut nga gjuha angleze në maqedonisht. **Aleku, Miki** dhe **Dejani** janë bërthama e rrjetit tim të hulumtuesve të rinj dhe persona të angazhuar në shoqëri në Maqedoni, në kompetenca të cilëve, energji dhe konsekuencë në punë gjithnjë mund të mbështetem, bile edhe në situata kur na ndajnë mijëra mile dhe zona kohe! Ndërsa, për ndihmën e tillë, besoj do të pajtoheni, njeriu duhet gjithnjë të ndjehet i lumtur dhe falënderues!

‘DORACAKU PËR VENDOSJE EFEKTIVE DHE IMPLEMENTIMIN E TË MËSUARIT SHËRBYES NË ARSIMIN SIPËROR’ përbëhet prej tre pjesëve:

- KAPITULLI 1 – **ÇFARË NË TË VËRTETË PARAQET TË MËSUARIT SHËRBYES?**
- KAPITULLI 2 – **ASPEKTET PRAKTIKE TË PROCESIT TË INKORPORIMIT TË MËSUARIT SHËRBYES NË INSTITUCIONET E ARSIMIT SIPËROR**
- KAPITULLI 3 – **SHËNIME PËRFUNDIMTARE DHE HAPA TË MUNDSHËM TË ARDHSHËM**

Në Maqedoni tashmë ekzistojnë institucione që punojnë në promovimin e inkuadrimit të arsimit në programet për ndihmë të bashkësisë, që në vete përmbajnë elemente të mësuarit shërbyes. Paraprakisht i përmenduri TKNPSHN e promovon të mësuarit shërbyes dhe programet për ndihmë të bashkësisë që nga viti 2010. Atëherë shkollës ndërkombëtare “Nova”, TKNPSHN i dorëzoi çmim për praktikë më të mirë të përgjegjësive shoqërore në kategorinë e investimit në bashkësi, pikërisht për programin me të cilin nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme kërkojnë të kushtojnë së paku dhjetë orë në çdo vit shkollor, përmes pjesëmarrjes së tyre në një ose më shumë projekte, me të cilat i ndihmohet bashkësisë. Ky program u veçua si shembull se si institucionet arsimore mund ta demonstrojnë përgjegjësinë e tyre ndaj shoqërisë ku punojnë. Qindra nxënës morën pjesë në aktivitete, me të cilat, mes tjerash, i ndihmuan Kryqit të Kuq të Qytetit të Shkupit dhe Ambasadës së parë të fëmijëve në botë “Megjashi”, realizuan dhjetëra aksione për pastrimin e sipërfaqeve publike, mes të cilave edhe Kopshtin zoologjik në Shkup, organizuan Panair familjar dhe grumbulluan mjete për ndihmë Entit për rehabilitim të fëmijëve dhe të rinjve në Shkup, por edhe e mbështetën ndërtimin

e lagjes së parë të Habitat në Veles. Krahas dobisë për bashkësinë, mirënjohja nga TKNPSHN iu dorëzua edhe pse programi kontribuon për krijimin e personaliteteve të ndërtuara me sistem të drejt të vlerave, që në të ardhmen do të vazhdojnë me praktikën e qasjes aktive drejt identifikimit dhe zgjidhjes së problemeve në bashkësi. Shembuj të tillë të ndihmës në bashkësi në sistemin arsimor shërbyen si bazë për fillimin e bisedimeve të TKNPSHN me organet kompetente shtetërore për atë se si angazhimi qytetar dhe të mësuarit shërbyes mund të inkorporohen në të gjitha nivelet e arsimit, si në sektorin privat, ashtu edhe në atë publik. Me qëllim të vazhimit të aktiviteteve të këtilla për avokim dhe ndryshim të politikave arsimore, paraqitet nevoja që të sistematizohen më shumë shembuj dhe analiza të rasteve konkrete nga jeta reale me të cilën do të ilustron si në të vërtetë funksionon të mësuarit shërbyes, cilat janë përfitimet nga ai në kontekstin lokal, cilat janë problemet kryesore për aplikimin e tij më të madh dhe përhapjen në Maqedoni dhe cilat aktivitete do të mund ta mbështesin këtë proces. E shfrytëzoj këtë rast të paralajmëroj se planifikohet botimi i këtij publikimi, i cili do t'i përmbajë 'shembujt për aplikim të suksesshëm të mësuarit shërbyes'. Besoj se me një përmbledhje dhe analizë të tillë të rasteve 'do të mbyllet rrethi' dhe secili në Republikën e Maqedoni, ose më gjerë në Ballkan, i cili me të mësuarit shërbyes do të merret si hulumtues ose ligjërues ose ndoshta përpiqet ta vendos të mësuarit shërbyes në praktikë, do të gjejë material të shkruar cilësor, nga i cili do të shtjerrë njohuri dhe ide për aktivitete të ardhshme.

**Shkup,
gusht 2012**

Autore

Milena Ristovska

Bashkëpunëtore - hulumtuese
INSTITUTI PËR NJOHURI DHE INOVACIONE
George Washington University, Washington DC

KAPITULLI 1:

ÇFARË NË TË VËRTETË PARAQET TË MËSUARIT SHËRBYES?

Hyrje

Për shkak të ndryshimeve të shpejta dhe komplekse në sferën sociale, politike dhe ekonomike të arsimit sipëror të cilat ndodhin më shumë se çerek shekulli prapa, jemi dëshmitarë të përfaqësimit të theksuar të programeve për të mësuarit shërbyes (të mësuarit përmes kryerjes së shërbimeve në bashkësi) në arsimin sipëror. Duke parë se si një numër i madh kolegjeve dhe universiteteve me qëllim i ndërlidhin aktivitetet për angazhimin qytetar në iniciativat për sigurimin e një numri të madh të qasjeve dhe sukseseve, kuptojmë se si asnjëherë më parë, të mësuarit shërbyes vërtetohet si një nga instrumentet më të fuqishme për angazhimin qytetar dhe paraqet katalizator shumë të mirë të transformimit të arsimit sipëror, e me këtë edhe të vetë shoqërisë.

Sipas anketimit më të ri vjetor të anëtarëve të Kampus Kompakt,³ “studentët në 1198 institucione të larta arsimore, të cilat janë anëtare të Campus Compact, gjatë vitit shkollor 2008-2009, përmes programeve të organizuara nga ana e vetë institucioneve të larta arsimore, kanë kontribuar ndaj bashkësisë të veta me rreth 336 milionë orë në shërbim, me vlerë rreth 7.6 milionë USD (Kampus Kompakt, 2009). Një pjesë e madhe e këtyre orëve janë shpenzuar për zgjidhjen e nevojave urgjente në bashkësi, të cilat kanë të bëjnë me qasjen dhe suksesin, duke përfshirë edhe programet e fokusuara në arsimin fillor dhe të mesëm (ky ka qenë rast në rreth 89% të institucioneve të larta arsimore që janë përfshirë në hulumtimin), tutorë (82%), mentorim (80%), lexim dhe shkrim (78%), si dhe iniciativa të orientuara drejt rritjes së qasjes deri te sukcesi në arsimin sipëror (70%)”⁴.

Në kuptimin më të gjerë të fjalës, të mësuarit shërbyes është relativisht i ri, metodë inovative pedagogjike për mësim më efikas dhe të mësuarit të mirë bazë empirik, që i lidh të mësuarit në klasë me bashkësinë më të gjerë përmes angazhimit të studentëve në projekte të organizuara ku ata i aplikojnë shkathtësitë dhe njohuritë, mendimin kritik dhe refleksionin, dhe kjo me qëllim që të plotësohet nevojë e caktuar, e cila është identifikuar se ekziston në bashkësinë e tyre. Qëllimi i këtyre përvojave të organizuara të sistematizuara të ofrimit të shërbimit në bashkësi është të:

³ Campus Compact është koalicion nacional amerikan i pothuaj 1200 kryetarëve të kolegjeve dhe universiteteve që i përfaqësojnë rreth 6 milionë studentë dhe të cilët i janë përkushtuar plotësisht të qëllimeve qytetare të arsimit sipëror. Anëtarësia e saj përfshin institucione publike, private, që ofrojnë arsim të kualifikuar sipëror dyvjeçar dhe katërvjeçar (do të thotë, është përfshirë e gjithë paleta e institucioneve të larta arsimore) të cilat në praktikë e praktikojnë idealin e angazhimit qytetar. Metodat të cilat shfrytëzohen që të arrihet kjo përfshijnë: ndarjen e diturisë dhe resurset me bashkësinë; krijimi i iniciativave lokale për zhvillim, si dhe mbështetje programeve për kryerjen e shërbimeve në bashkësi dhe të mësuarit shërbyes në sferat siç janë: arsimi fillor dhe i mesëm, regjistrimi dhe sukcesi i studentëve në kolegji, shëndetësia, ambienti jetësor, uria/pa strehimi, shkollimi dhe shërbe për personat më të mëshuar. Campus Compact është asociacioni i vetëm nacional i lartë arsimor në SHBA, që i përkushtohet angazhimit qytetar në universitetet. Puna e tij është fokusuar në:

- 1) Promovimin e kryerjes së shërbimeve për opinionin më të gjerë dhe bashkësinë ku jetohej ose punohet, me çka zhvillohen shkathtësitë qytetare të studentëve;
- 2) Ofrimi i ndihmës së universiteteve të krijojnë partneritete funksionale në bashkësi dhe
- 3) Sigurimi i resurseve dhe trajnimit për kuadrin arsimor, i cili dëshiron ta inkorporojë angazhimin qytetar në programet mësimore në universitete.

⁴ Cress, Christin M., Cathy Burack, Dwight E. Giles, Julie Elkins, and Margaret Carness Stevens (Eds.), 2010, *A Promising Connection: Increasing College Access and Success through Civic Engagement*, Boston, MA: Campus Compact, fq. 3.

- ndihmohet në plotësimin e nevojave të vërteta të bashkësisë;
- shërbejnë si instrument për arritjen e qëllimeve shoqërore të bashkësisë, si dhe
- të avancohet ajo që mësohet në shkollë, në atë mënyrë që procesi të zgjerohet jashtë shkollës d.m.th. bashkësisë.⁵

Edhe pse njihet mjaft mirë si koncept dhe praktikë në nivel global, të mësuarit shërbyes akoma është në krijim e sipër kur bëhet fjalë për aplikimin e tij në institucionet e larta arsimore në Republikën e Maqedonisë. Hapat e parë drejt vendosjes së tij në vendin tonë datojnë që nga viti 2010, kur në Ohër u mbajt **Konferenca rajonale e alumnive të JFDP**, tema qendrore e të cilave ishte çështja se si personave me invaliditet/handikap/pengesa t'u mundësohet qasja e përgjithshme (veçanërisht në arsim) dhe si në mënyrë konsekuente t'u sigurohen edhe në vepër t'i zbatojnë të drejtat e barabarta.⁶ Diskutimet dhe analizat nga konferenca, si dhe puna individuale e secilit pjesëmarrës rezultoi me **Propozim planin e veprimit** që qartë flet për atë se një nga metodat më të mira për zgjidhjen e kësaj çështjeje komplekse është koncepti i të mësuarit shërbyes. Në të vërtetë, koncepti i të mësuarit shërbyes mundëson në mënyrë të drejtpërdrejt të inkuadrohen palët më të prekura, më të goditura, derisa ato në mënyrë paralele punojnë jo vetëm për dobi të tyre personale dhe dobinë e të afërmeve të tyre, por mundëson edhe: emancipimin e tyre, promovimin dhe inkuadrimin në shoqëri; ngritjen e vetëdijes dhe inicimin e implementimit real të aktiviteteve të cilat shpijnë drejt zbutjes së barrierave për qasjen e përgjithshme për personat me invaliditet/handikap/pengesë.⁷

Hap i rëndësishëm drejt vendosjes më të theksuar të konceptit të mësuarit shërbyes është arritur me fillimin e projektit “Qasja e barabartë për personat me invaliditet/handikap/pengesë përmes të mësuarit shërbyes”, që është financuar nga ana e Fondit për angazhimin e alumnive dhe inovacioneve të Departamentit të shtetit të SHBA-ve.⁸ Projekti ka për qëllim:

- (1) Ngritja e vetëdijes për nevojën nga raporti korrekt ndaj personave me invaliditet/handikap/pengesë, dhe
- (2) Mundësimi, avancimi dhe garancia e të drejtave të barabarta për këta persona.

Projekti realizohet nëpërmjet këtyre aktiviteteve më të rëndësishme:⁹

1. **Analiza status quo** e fokusuar në:

- Nevojat individuale të personave me invaliditet/handikap/pengesë, veçanërisht gjatë arsimit; metodologji të zbatuara/ekzistuese të cilat përdoren në universitete të zgjedhura në Maqedoni dhe Kroaci.
- (Mos)ekzistimi i programeve speciale arsimore për personat me invaliditet/handikap/pengesë.

2. Organizimi i një **varg punëtorish** të cilat përfshijnë aktorë të ndryshëm:

- Punëtoritë 1 dhe 2 (*kuadri arsimor/studentët*)
 - Identifikimi i nevojave të veçanta të personave me invaliditet/handikap/pengesë. Analiza e prapavijës psikologjike, qasja dhe raporti korrekt. Nxitja dhe promovimi i

⁵ Corporation for National and Community Service, *Learn and Serve America: Using Service as a Vehicle for Learning—A Most Valuable and Powerful Lesson*, Available from:

<http://www.nationalservice.gov/about/programs/learnandservice.asp>

⁶ <http://www.maaa.com.mk/jfdp-conference-20107>

⁷ Lazarevska, Ana and Atanasovski, 2010, *Draft Action Plan resulting from the regional JFDP Alumni Conference "Enhancing Accessibility of the Higher Education to the Disabled"*, November 22-24, 2010 in Skopje/ Ohrid, Republic of Macedonia, Skopje, Macedonia: Friedrich Ebert Stiftung. Gjendet në:

http://www.maaa.com.mk/sites/default/files/Action%20Plan_eng.pdf

⁸ Përshkrimi i shkurtër i aplikacionit të projektit gjendet në:

http://www.equalaccess4pwsds.org/sites/default/files/resources/AEIFproposal_MK_CR_finalists_narrative_new.pdf

⁹ <http://www.equalaccess4pwsds.org/project-activities>

bashkëpunimit mes studentëve me dhe/ose pa nevoja individuale. Analiza e nevojave dhe dizajni i programit mësimor.

- Punëtoritë 3 dhe 4 (*kuadri arsimor/studentët*)
 - Kuptimi dhe zbatimi i konceptit për të mësuarin shërbyes përmes zbatimit të analizave të rasteve në Maqedoni dhe Kroaci, ndërsa me qëllim që të shqyrtohen çështjet për qasjen teknike, fizike/arkitektonike, informative, mësimore dhe juridike.
 - Punëtorja 5 (të gjitha palët e prekura)
 - Adaptimi i metodologjisë ekzistuese dhe inkorporimi i prapavijës psikologjike kur në praktikë qaset drejt/punohet me persona me invaliditet/handikap/pengesë.
 - Punëtorja 6 (të gjitha palët e prekura) – **së shpejti duhet të mbahet**
 - Prezantimi i përvojave praktike dhe rezultateve nga puna në terren.
3. Zbatimi i **punës në terren** (analiza e rasteve) në Maqedoni dhe Kroaci
 4. **Fushatë për forcimin e opinionit publik – në rrjedhë.**
 5. Shtypi dhe distribuimi i **publikimeve** nga projekti – **në rrjedhë.**
 6. Vendosja e **ueb faqes** për komunikim mes të gjithë aktorëve të involvuar.

Përshkrim më i hollësishëm i rezultateve nga këto aktivitete mund t'i gjeni në ueb faqen nën kategorinë “Aktivitete dhe rezultate”.¹⁰

Sipas dr. Ana Koçi, docente në Fakultetin e gjuhëve, kulturës dhe komunikimeve, pranë Universitetit të Evropës Juglindore, Tetovë, rëndësia e projekteve rreth të mësuarit shërbyes në tërësi, e veçanërisht në kontekst të vendit tonë, nuk guxon të nënçmohet, veçanërisht nëse dihet se Maqedonia synon drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Hulumtimi i politikës së tanishme dhe çështjeve me të cilat ballafaqohen bashkësitë përmes bashkëpunimit dhe inkuadrimit të grupeve të pakicave kanë rëndësi të madhe për avancimin e bashkësisë tonë në këto kohë të globalizimit. Përmes ballafaqimit me çështje të ndryshme të rëndësishme, analiza e tyre, këshillimi dhe zhvillimi i zgjidhjeve për problemet në bashkësi, promovohet vetëdija për lidhjen mes efekteve ose pasojave personale, rajonale, nacionale dhe globale.

Dr. Koçi gjithashtu mendon se, për fat të keq, ky nuk është rast vetëm në Maqedoni. Sipas saj, në Evropën Juglindore mungojnë njohuritë solide për personat me invaliditet/handikap/pengesë, ndërsa vërehet edhe mungesa e angazhimit qytetar. Qëndrimi i saj është se duhet të punojmë në ndërtimin e agjendës së re për pjesëmarrje qytetare që të arrijmë deri te anëtarët e marginalizuar të bashkësive tona. Disa nga mënyrat që të arrihet kjo është me anë të (1) vlerësimit kritik të politikave të tanishme qeveritare dhe (2) vlerësimi i mënyrave në të cilat shkollat e mbështesin pjesëmarrjen rinore dhe sigurojnë llojllojshmëri të aktiviteteve shkencore. Gjithashtu, një sfidë e rëndësishme në rritjen e motivimit të profesorëve të marrin pjesë në aktivitete për angazhimin në bashkësi është struktura e sistemit për avancim akademik. Standardet për avancim, fitimin dhe mbajtjen e titujve nuk japin pikë për angazhimin dhe nuk mbajnë llogari për kohën dhe punën të cilat janë të nevojshme që të bëhet hulumtimi i bazuar në bashkësi në krahasim me metodat tjera të hulumtimit. Si njësi matëse për punën akademike shpesh përdoret numri i përgjithshëm i publikimeve. Për promovimin e të mësuarit shërbyes më e rëndësishme është që institucionet të fillojnë t'i shpërblejnë këto përpjekje gjatë vlerësimit për avancimet, fitimin dhe mbajtjen e titujve me qëllim që të përmirësohet imazhi publik i institucioneve arsimore, të sigurohen mundësitë e barabarta, të tregohet respekt ndaj studentëve të ndryshëm dhe të punohet bashkë me bashkësinë që të zgjidhen problemet shoqërore.

¹⁰ <http://www.equalaccess4pwsds.org/activity-list>

Qasje për përcaktimin e të mësuarit shërbyes

Me kërkimin themelor dhe analizën e literaturës relevante dhe studime në fushën e të mësuarit shërbyes vërtetohet se ekzistojnë më shumë qasje të ndryshme drejt përcaktimit të tij:

- “Të mësuarit shërbyes paraqet filozofi dhe metodikë e punës mësimore që në programin mësimor e integron kryerjen e shërbimeve të rëndësishme për bashkësinë me qëllim që të përmirësohet “themeli” akademik, në atë mënyrë që nxënësve t’u ndihmohet të arrijnë rezultate, të cilat priten se do të arrihen pas procesit të mësuarit”.¹¹
- “Të mësuarit shërbyes është strategji bashkëpunuese për mësim dhe të mësuar, qëllimi i të cilit është të promovohet zhvillimi akademik, rritja personale dhe angazhimi qytetar. Studentët kryejnë shërbim të rëndësishëm në bashkësi, me çka ata do ekspozohen në përvojat lidhur me materialin mësimor prej ku ata mësojnë. Përmes të menduarit të orientuar, studentët – individualisht dhe në grupe – në mënyrë kritike i kontrollojnë përvojat e tyre dhe i artikulojnë rezultatet specifike nga të mësuarit. Në këtë mënyrë avancohet kualiteti i të mësuarit të tyre dhe të shërbimit që e ofrojnë.”¹²
- “Të mësuarit shërbyes paraqet strategji për mbajtjen e mësimit dhe të mësuarit që i ndërlidh kryerjen e shërbimeve të rëndësishme në kuadër të bashkësisë, nga njëra anë, dhe mësimin dhe refleksionet, nga ana tjetër, me qëllim që të pasurohet të mësuarit, të mësohen individët çfarë do të thotë përgjegjësia qytetare dhe të forcohen bashkësitë. Sipas natyrës së vet, të mësuarit shërbyes është të mësuarit të strukturuar, që kryerjen e shërbimeve për bashkësinë e kombinon me përgatitjen akademike dhe reflektim. Të mësuarit shërbyes të studentëve në kolegje dhe universitete u mundëson gjatë arsimit të tyre ta mësojnë “kontekstin për bashkësinë”, njëkohësisht duke mundësuar ta lidhin programin e tyre akademik me rolet e tyre si qytetarë.”¹³
- Ligji për të mësuarit shërbyes nga viti 1990 e përcakton të mësuarit shërbyes si metodë e të mësuarit, me të cilin studentët u shërbejnë bashkësive të tyre, e për këtë fitojnë nota (kredi për provimet e dhëna) në atë mënyrë që studentët gjatë kohës i shfrytëzojnë dhe i përsosin shkathtësitë që të “mendojnë për shërbimin që ia ofrojnë bashkësisë në mënyrën, përmes së cilit do të fitojnë mirëkuptim plotësues të përmbajtjes së mësimit, kuptimin më të gjerë për disiplinën shkencore dhe rritjen e përgjegjësisë qytetare”.¹⁴
- “Të mësuarit shërbyes është pedagogji e cila vazhdimisht evoluon dhe e cila në dinamikën e të mësuarit empirik të përvojës), në mënyrën e vlerësimit dhe në strukturën e programeve mësimore akademike e inkuadron punën vullnetare të studentëve. Në formën e vet të thjeshtë, të mësuarit shërbyes nënkupton punë vullnetare në bashkësi për çka studentët marrin nota, gjegjësisht kredi për provimet e dhëna.”¹⁵
- “Të mësuarit shërbyes përcaktohet si përvojë arsimore që sjell kredi dhe është e bazuar në mësimin në kuadër të cilave studentët: (a) marrin pjesë në kryerjen e organizuar të shërbimeve me çka plotësohen nevojat e identifikuar të bashkësisë, dhe (b) mendojnë për shërbimin ku do

¹¹ George Washington University Service-Learning Advisory Board, 2007, *Report on Service-Learning*, Washington, DC: The George Washington University, fq. 4.

¹² Ash, SL, PH Clayton, and M. Atkinson, 2005, 'Integrating Reflection and Assessment to Capture and Improve Student Learning', *Michigan Journal of Community Service Learning*, Vol. 11, Issue 2, fq. 49–59, fq. 51 e cituar sipas Peters, Kimberly A., 2011, 'Including Service Learning in the Undergraduate Communication Sciences and Disorders Curriculum: Benefits, Challenges, and Strategies for Success', *American Journal of Audiology*, Vol. 20, fq. 181–196, fq. 181.

¹³ Seifer, S. D. and Connors K., Eds., 2007, *Community Campus Partnerships for Health. Faculty Toolkit for Service Learning in Higher Education*. Scotts Valley, CA: National Service-Learning Clearinghouse, fq. 5. E marrë nga http://www.uri.edu/acadsupp_services/slearn/documents/HEtoolkit.pdf më 2 qershor 2012.

¹⁴ The National and Community Service Act of 1990 [As amended through December 17, 1999, P.L. 106-170], Retrieved on June 26, 2012 from: http://www.californiavolunteers.org/documents/About_Us/ncsa1990.pdf

¹⁵ Mooney, Linda and Bob Edwards, 2001, 'Experiential Learning in Sociology: Service Learning and Other Community-Based Learning Initiatives', *Teaching Sociology*, Vol. 29, No. 2, fq. 181-194, fq. 181.

të fitohet kuptim më i thellë për përmbajtjen e mësimit, kuptimin më të gjerë për disiplinën dhe rritjen e ndjenjës më të madhe për veprat personale dhe përgjegjësinë qytetare.”¹⁶

- Sipas Ligjit për trustet për bashkësitë nacionale dhe shërbim në bashkësi nga viti 1993: “ Të mësuarit shërbyes paraqet metodë me të cilën studentët mësojnë dhe zhvillohen përmes pjesëmarrjes aktive në shërbim të konceptuar me kujdes dhe të organizuar, e cila zbatohet në kuadër të bashkësisë dhe i plotëson nevojat e atyre bashkësive. Kjo është e koordinuar me proceset arsimore të cilat zhvillohen në nivel të arsimit fillor dhe të mesëm, në institucionet e arsimit sipëror ose me programet për shërbim në bashkësi dhe vetë bashkësinë. Të mësuarit shërbyes ndihmon të zhvillohet ndjenja e përgjegjësisë qytetare. Kjo është e integruar në përmirësimin e programeve studimore, i përmirëson vetë programet ose komponentët arsimor të programit në shërbim të bashkësisë ku janë regjistruar pjesëmarrësit. Të mësuarit shërbyes ose pjesëmarrësit u mundëson edhe kohë të strukturuar që të mendojnë për përvojat nga shërbimi.”¹⁷

Karakteristikat kryesore ose dimensionet e të mësuarit shërbyes

Definicionet paraprakisht të shtruara për të mësuarit shërbyes mund të sistematizohen në disa “kategori” të cilat do t’i paraqisnin qasjet e ndryshme ndaj tij. Nga numri i madh i definicioneve dhe qasjeve duket se gjatë përpjekjeve që të përshkruhet çfarë paraqet në të vërtetë të mësuarit shërbyes ekziston mungesë e konsensusit, që flet për natyrën multi-dimensionale dhe komplekse të këtij koncepti.

Autorë të shumtë që kanë punuar në identifikimin e elementëve kyç sipas të cilëve të mësuarit shërbyes dallohet nga praktikat tjera të mësuarit të bazuar në bashkësi dhe të hulumtimit të kualitetit që e bëjnë efikas. Më poshtë do të prezantojmë një pjesë prej tyre – Kornizën e Vajgerit për të mësuarit efektiv shërbyes (Weigert, 1998).¹⁸

- Në projektet ku realizohet të mësuarit shërbyes, studentët bëjnë shërbim të rëndësishëm, japin shërbim të rëndësishëm, i cili është i dobishëm dhe që ndihmon dhe jep kontribut;
- Shërbimin të cilin e japin studentët plotëson ndonjë nevojë aktuale ose urgjente që të arrihet ndonjë qëllim në kontekstin e bashkësisë;
- Nevojat të cilat duhet të plotësohen, janë qartë të identifikuar dhe të përcaktuara nga ana e anëtarëve të bashkësisë dhe atë përmes procesit i cili në rastin ideal përfshinë bashkëpunimin mes kuadrit mësimor dhe bashkësisë të cilës i ndihmohet;
- Studentët japin shërbime të cilat dalin nga qëllimet e procesit mësimor;
- Vetë dhënia e ndihmës, gjegjësisht kryerja e shërbimeve për bashkësinë është e integruar në mësim me ndihmën e detyrës (ose detyrave), e cila nga studentët kërkon ndonjë formë të menduarit për shërbimin (refleksion) përmes prizmit të qëllimeve të mësimit; dhe
- Detyrat të cilat janë të “rrënjësura” në procesin e dhënies së shërbimeve, duhet në mënyrë adekuate të vlerësohet (d.m.th. ato duhet të vlerësohen në bazë të asaj që është mësuar, e jo në

¹⁶ Bringle, R. G. and Hatcher, J. A., 2009, *Innovative Practices in Service Learning and Curricular Engagement* in Sandmann, L., A. Jaeger, and C. Thornton (Eds.), 2009, *New Directions in Community Engagement* (fq.37–46), San Francisco, CA: Jossey-Bass. fq. 38 as cited in Bringle, Robert and Julie A. Hatcher, *International Learning* in Bringle, Robert, Julie A. Hatcher and Steven G. Jones (Eds.), 2011, *International Service Learning. Conceptual Frameworks and Research. Vol. 1: IUPUI Series on Service Learning Research*, Sterling, Virginia: Stylus Publishing LLC, fq. 5.

¹⁷ Corporation for National and Community Service, 2002, *About Learn and Serve: Service-Learning*, Retrieved July 15, 2003 from www.learnandserve.org/about/service_learning.html cituar sipas Taylor, Pamela A. and Christine Ballengee-Morris, 2004, 'Service-Learning: A Language of "We"', *Art Education*, Vol. 57, No. 5, Community, Collaboration, and Culture (Sep., 2004), fq. 6 – 12, fq. 6.

¹⁸ Weigert, Kathleen Maas, 1998, 'Academic Service Learning: Its Meaning and Relevance', *New Directions for Teaching and Learning*, No. 73 (Spring 1998), fq. 3-10, fq. 6, 7.

bazë të asaj se çfarë roli i është dhënë bashkësisë) dhe bashkësia duhet të luajë rol aktiv në vlerësim (vlerësimi i studentëve).

Në vazhdim në mënyrë të hollësishme do t'i shqyrtojmë **aspektet ose dimensionet më të rëndësishme të mësuarit shërbyes** që dalin nga analiza e definicioneve paraprakisht të cituara.

1) Nga të mësuarit empirik deri te programet për ndihmë bashkësisë

Përpjekjet e deritanishme për përmirësimin e arsimit sipëror në SHBA dhe në ekonomitë tjera në botë nxitën “inflacion” të analizave dhe studimeve të fokusuar në përmirësimin e procesit të mësuarit në kuadër të sistemit arsimor. Hulumtimi në këtë fushë lëviz në disa drejtime. Ju a prezantojmë ato, që sipas mendimit tonë, janë ngushtë të lidhura dhe janë më relevante për të mësuarit shërbyes.

a) Të mësuarit empirik (të mësuarit përmes përvojave)

Rrënjët e formalizmit të mësuarit shërbyes si metodologji për mësimin dhe të mësuarit/pedagogjia mund të gjendet në punën e Kolb dhe teorinë për të mësuarit empirik (Experiential Learning Theory [ELT]). Kjo teori si mjaft e rëndësishme për procesin e të mësuarit dhe zhvillimin të njeriu e thekson rëndësinë e përvojës dhe propozon model holistik të procesit të mësuarit dhe zhvillimi i individëve. Teoria bazohet në këto premise:

- “Të mësuarit më së miri mund të kuptohet si proces, e jo si rezultat nga ai. Që të përmirësohet të mësuarit në arsimin sipëror duhet të jetë në inkuadrimin e studentëve në procesin përmes të cilit të mësuarit e tyre më së shumti përparon, e ky është procesi që përfshinë informatat kthyes për efikasitetin e përpjekjes që ata e investojnë kur mësojnë.
- Çdo proces i të mësuarit paraqet të mësuarit e *serishëm*. Të mësuarit më së miri ndihmohet nëse ekziston proces nëpër të cilin qartë artikulohe bindjet dhe idetë e studentëve për temë të caktuar, pas çka qëndrimet dhe idetë e njëjta mund të ri hulumtohen, kontrollohen dhe të integrohen në ide të reja, më të rafinuara.
- Të mësuarit kërkon të zgjidhen konfliktet të cilat ekzistojnë mes modeleve mjaft të kundërta të aftësisimit ndaj botës. Konflikti, dallimet dhe mos pajtimet janë lëvizës të procesit të mësuarit. Pjesëmarrësit në procesin e të mësuarit janë thirrur të lëvizin para-prapa mes mënyrave të kundërta të menduarit dhe veprimit, si dhe mes ndjenjave dhe mënyrave të kundërta të menduarit.
- Të mësuarit paraqet proces holistik të aftësisimit ndaj botës. Ky nuk është rezultat vetëm i njohjes, por e inkuadron edhe funksionimin integral të personalitetit të plotë – të menduarit, të ndjerit, pranimin dhe sjelljen.
- Të mësuarit del nga shkëmbimet sinergjike mes personalitetit dhe rrethimit. Thënë ndryshe, në frymën e veprës së Piaget, të mësuarit përmes proceseve dialektike të baraspeshës së asimilimit të përvojave të reja në konceptet ekzistuese dhe përmes përshtatjes së koncepteve ekzistuese ndaj përvojave të reja.
- Të mësuarit është proces i krijimit të diturisë. Teoria e të mësuarit empirik propozon një teori konstruktive të mësuarit sipas të cilit dituria sociale krijohet dhe krijon sërish në diturinë personale të atij që mëson. Kjo është në kundërshtim me modelin e “transferimit në të cilin bazohet një pjesë e madhe e praktikës ekzistuese arsimore ku paraprakisht idetë ekzistuese dhe mjaft fikse i transferohen atij që mësoj.”¹⁹

Sipas Doracakut për të mësuarit shërbyes i dedikuar për kuadrin mësimor pranë Universitetit Xhorxh Uashington (*The George Washington University Service-Learning Faculty Handbook*), të mësuarit shërbyes është një formë e të mësuarit empirik nga aspekti i asaj që:

¹⁹ Premisat janë marrë në formë origjinale ashtu siç janë dhënë në Kolb, Alice Y., and David A. Kolb, 2005, ‘Learning Styles and Learning Spaces: Enhancing Experiential Learning in Higher Education’, *Academy of Management Learning and Education*, Vol. 4, No. 2, fq. 193 – 212, fq. 194.

- Në mënyrë të vazhdueshme siguron shërbime, me të cilat plotësohen nevojat e përgjithshme të bashkësisë dhe të agjencive;
- Studentët fitojnë përvoja autentike;
- Zgjerohen qëndrimet/pikëpamjet/perspektivat e përgjithshme dhe ngrihet vetëdija për diversifikimin, dhe
- Përmbajtja e mësimin aplikohet në situata nga jeta reale.²⁰

Sipas burimit të njëjtë, ndaj të mësuarit shërbyes mund të shihet njëlloj si edhe ndaj të mësuarit të bazuar mbi problem konkret. Në të vërtetë, të mësuarit shërbyes:

- 1) U siguron ekspertizë të specializuar ose njohuri agjencive;
- 2) E orientuar ndaj plotësimit të nevojave specifike ose ndaj zgjidhjes së problemeve që vihen re;
- 3) Rezulton me prodhim specifik, si për shembull, broshurë, internet faqe, doracak etj., gjegjësisht me rezultate qartë të përcaktuara, të prekshme dhe e fundit, por jo edhe më pak e rëndësishme,
- 4) Kërkon të investohet përpjekje e strukturuar që projekti ose faza e projektit të përfundojë në kohë dhe në mënyrë ekonomike.²¹

Në çdo rast, të mësuarit shërbyes i përfshinë të gjithë partnerët dhe jep shërbime që mund të jenë të drejtpërdrejta dhe/ose indirekte, varësisht nga qëllimet e mësimin dhe qëllimet e identifikuar nga ana e partnerëve në bashkësi.

b) Programi për ndihmë bashkësisë

Të mësuarit shërbyes kërkon që të plotësohen **nevojat e identifikuar të bashkësisë, përfitimet ekonomike, operative dhe sociale**. Bashkësitë lokale përparojnë ashtu që ekziston “mjet” me të cilin në mënyrë efikase dhe efektive zgjidhen çështjet dhe problemet lidhur me nevojat dhe problemet, të cilat paraprakisht nuk janë plotësuar dhe nuk janë zgjidhur. Ky mjet ndonjëherë vepron bile edhe në nivel të politikës publike. Përndryshe, kur flasim për bashkësinë, duhet të përmendim se bashkësia definohet si një mënyrë gjithëpërfshirëse/inkluzive dhe me termin bashkësi janë përfshirë një numër relativisht i madh (që rritet) i partnerëve dhe klientëve.²²

Procesi i vlerësimit të nevojave të bashkësisë ka rëndësi të madhe për dizajnimin e programeve efektive për ndihmë bashkësisë. Qëllimi i këtij procesi është të identifikohen mjetet me të cilat disponon bashkësia dhe të vërtetohen problemet potenciale, me të cilat ajo ballafaqohet. Në rast ideal, vlerësimi i nevojave bëhet në bashkëpunimin me organizata lokale, grupe për avokim dhe/ose njësi tjera universitare. Procesi fillon me planifikimin dhe organizimin, e përcjellë me grumbullimin e të dhënave, rezymenë e tyre dhe diseminacionin e rezultateve nga vlerësimi i nevojave dhe përfundon me shpërndarjen e rezultateve përmes forumeve publike, qëllimi i të cilës është të fillojë procesi i planifikimit të aksioneve dhe aktiviteteve konkrete.²³

²⁰ Benton-Short, Lisa (Ed.), 2012, *Service-Learning Faculty Handbook*, Center for Civic Engagement and Public Service, The George Washington University, fq. 5, 6. Mund të gjendet në: <http://www.gwu.edu/staticfile/GW/CCE&PS/Document/Service-Learning%20Faculty%20Handbook%20January%202012%20Edition.pdf>.

²¹ Ibid, fq. 5, 6.

²² Heckert, Teresa M., 2010, ‘Alternative Service Learning Approaches: Two Techniques That Accommodate Faculty Schedules’, *Teaching of Psychology*, Vol. 37, fq. 32–35, fq. 32.

²³ Sharma, Aparna, Mindy Lanum, and Yolanda Suarez-Balcazar, 2000, *A Community Needs Assessment Guide: A Brief Guide on How to Conduct a Needs Assessment*, Chicago, IL: Center for Urban Research and Learning and the Department of Psychology, Loyola University Chicago, fq. 1.

Dr. Koçi thekson se bashkësia thjesht ka milionë nevoja – disa janë të mëdha, disa janë të vogla, e për disa bashkësia as nuk e di se ekzistojnë! Nga ana tjetër, ajo gjithashtu e thekson ekzistimin e miteve të zakonshme për atë çfarë paraqet “nevojë”:

1. Miti i zakonshëm është se secili duhet të dijë për problemin, që ai të llogaritet si nevojë. Qëndrimi i këtillë është i gabuar, sepse shumica prej nevojave më të rëndësishme të bashkësisë janë punë të cilat shumica e njerëzve nuk i dinë.
2. Miti i dytë i zakonshëm është se me ballafaqimin me nevojë do të thotë t’u ndihmohet atyre pjesëve të popullatës që janë në pozitë të palakueshme sociale ose materiale. Në të vërtetë, edhe pse këto grupe në shoqëri kanë nevojë dhe shpesh janë shfrytëzues të ndihmës që ofrohet përmes projekteve të shumta, megjithatë nuk ekziston rregull e cila thotë se projektet duhet t’u shërbejnë vetëm atyre. Bashkësia i përfshinë TË GJITHË anëtarët e saj, të pasur ose të varfër, të dobët ose të fuqishëm. Një shembull për projekt, me të cilin do të plotësohej nevoja e bashkësisë është rasti kur një firmë /kompanie të suksesshme do t’i ofrohej që të ndërtojë internet faqe të saj. Me këtë do të ndihmohej që firma/kompania të bëhet edhe më e suksesshme, ndërsa zhvillimi i këtillë për kthim do t’i ndihmojë gjithë bashkësisë.
3. Miti i tretë i zakonshëm është se nevojë është diçka që bashkësia e kërkon. Qëndrimi i këtillë u tregua si mjaft i gabuar, pasi që si anëtar i bashkësisë suaj, me siguri edhe ju keni shumë ide për projekte prej të cilave do të kishte dobi bashkësia ku jetoni. Vetëm pse të tjerët nuk dinë për projektin tuaj ose pse bashkësia nuk ka kërkuar ta realizoni, kjo NUK DO TË THOTË se ideja nuk është e mirë.
4. Më në fund, ekziston mit se me qëllim që të plotësohet nevoja me të cilën ballafaqohet bashkësia, projekti duhet të jetë diçka shumë e madhe dhe diçka për realizimin e të cilit do të nevojitet të ndahet shumë kohë dhe mund. Ekzistojnë shumë shembuj të cilët kanë treguar se që t’i përgjigjesh kësaj, gjegjësisht të plotësohet ndonjë nevojë e bashkësisë duhet të bëhet diçka shumë e vogël dhe e lehtë. Në të vërtetë, projektet me të cilat përpiqet të zgjidhen problemet e mëdha shoqërore, zakonisht janë ato që kanë më shumë raste të mos kenë sukses, derisa projektet e orientuara të zgjidhin problem të vogël pothuaj gjithnjë kanë sukses.

Problem tjetër i madh që duhet të merret parasysh është rasti i konceptimit dhe zbatimit të projekteve për të mësuarit shërbyes në izolim relativ. Kur flasim për konceptimin dhe zbatimin e këtyre projekteve në izolim në të vërtetë mendojmë për faktin se edhe krahas asaj që ligjëruesit dhe kuadri mësimor punojnë drejtpërdrejt me organizata nga bashkësia lokale, që të sigurojnë mundësi për punë vullnetare të studentëve ose për pjesëmarrje në projekte për të mësuarit shërbyes; që të fitojnë më shumë ide lidhur me programin mësimor, lidhur me sigurimin e resurseve etj., megjithatë ekziston siguri e madhe që gjatë kësaj të mos arrihet ndonjë komponent e rëndësishme e të mësuarit shërbyes. Shkaku për këtë mund të jetë në atë se aktivitetet e orientuara drejt bashkësisë “zakonisht, në mënyrë primare janë të orientuar drejt ndërtimit të ‘etikës së shërbimit’ te studentë individualë. Përfitimet për bashkësinë shpeshherë kanë rëndësi dytësore dhe shpesh lidhja me organizatën nga bashkësia qëndron përmes studentëve gjatë një ose dy semestrave. Krahas kësaj, edhe pse aktiviteti për mbështetje të bashkësisë mund të rezultojë me “prodhim” që është në dobi për bashkësinë – siç është buletini, shkrimi ose broshura – shpeshherë ndodh që mos të ekzistojnë strategji të përbashkëta për evoluimin, të cilat janë të kontraktuara mes organizatës dhe arsimtarit dhe jo gjithnjë ekziston regjistrim për avancimin lidhur me çështjen për të cilën organizata punon ta zgjidh, e kjo me vete tërheq edhe dyfishimin e aktiviteteve në semestrat tjerë. Kufizim tjetër në praktikat rrjedhëse është se kur aktivitetet e bazuara në bashkësi ndërmerren në izolim relativ, ekziston tendencë që fokusi të vihet vetëm në një çështje, me çka mund të kufizohen mundësitë që studentët, arsimtarët dhe organizatat nga bashkësia lokale në tërësi, ti kuptojnë problemet në kuadër të një konteksti më të gjerë sistemor.”²⁴

²⁴ Brown, Danika Margo, 2003, *Outreach and Containment: The Rhetoric and Practice of Higher Education's Community-based Outreach Programs and Possible Alternatives*, Doctoral Dissertation, Graduate College of the University of Arizona, fq. 141, 142. E marrë nga biblioteka Gelman Library, ProQuest Dissertations & Theses më 15 korrik 2012.

Shembull për programin i cili ka efekte afatgjate për bashkësinë: Në tezën e magistraturës ‘Hulumtimi i ndikimeve të programeve universitare për ndihmë bashkësisë mbi vetë bashkësinë përmes prizmit të mësuarit shërbyes dhe angazhimi në bashkësi’ M. Susan Erickson e paraqet studimin e vet për ndikimet mbi bashkësinë e programit PLaCE (Rregullimi në partneritet i peizazhit dhe bashkësisë) pranë Kolegjit për dizajn të Universitetit shtetëror në shtetin Ajova. Siç është theksuar në fragmentin, hulumtimi përbëhet në anketimin e palëve të prekura nga bashkësia ku janë zhvilluar aktivitetet për angazhim qytetar. Rezultatet nga hulumtimi treguan se bashkësia ka marrë më shumë përfitime të ndryshme nga inkuadrimi i studentëve dhe të universitetit në programin PLaCE. Mes përfitimeve më të rëndësishme janë: avancimi i pamjes fizike në bashkësi, zgjerimi i kapacitetit të bashkësisë, rritja e legjitimitetit të projekteve të cilat realizohen dhe nxitja e dialogut, aktivitetet dhe kapaciteti krijues në nivel lokal.²⁵

2) Integrimi i të mësuarit shërbyes në procesin e realizimit të mësimit dhe në përmbajtjet mësimore nga lëndët

Të mësuarit shërbyes në të njëjtën kohë mund të shihet si ndaj: filozofisë, metodologjisë për mësimit dhe të mësuar, strategjia për mbajtjen e mësimit dhe të mësuarit, pedagogjia dhe përvoja praktike arsimore. Megjithatë, pa marrë parasysh se cili term përdoret që të përshkruhet thelbi i tij, të mësuarit shërbyes gjithnjë paraqet **përvojë të menduar, të organizuar dhe strukturore të ofrimit të shërbimit bashkësisë, e cila është e integruar në programet mësimore ku janë regjistruar studentët.** Qëllimi i vendosjes së të mësuarit shërbyes nuk është të zëvendësohet programi tradicional, por t’u jepet mundësi studentëve ta shfrytëzojnë diturinë e tyre në një kontekst të menduar. Arsimitarët/ligjëruesit zakonisht u japin studentëve detyrë që duhet ta kryejnë dhe, si edhe për çdo lëndë, këto detyra për të mësuarit shërbyes duhet të kryhen në mënyrë të kënaqshme për studentin që të marrë nota të mira. Gjatë projekteve, kuadri mësimor dhe studentët punojnë bashkë duke shkëmbyer përvoja dhe duke mësuar për veten, për tjerët dhe për pjesën tjetër të botës.

a) Qëllimet e të mësuarit shërbyes

Kur bëhet fjalë për dizajnimin e projektit ose lëndës që e inkuadron të mësuarit shërbyes me rëndësi të veçantë është që me kujdes të vërtetohen qëllimet dhe detyrat të cilat duhet të arrihen me procesin e të mësuarit. Kuadri mësimor dhe përfaqësuesit tjerë të institucioneve të larta sipërore duhet të jenë të vetëdijshëm se ekzistojnë dy kategori të qëllimeve në këtë rast: ***qëllimet për procesin e të mësuarit dhe qëllimet e ofrimit të shërbimeve për bashkësinë.*** Që të dyja nga këto grupe medoemos duhet:

- 1) ta reflektojnë atë që studentët duhet ta bëjnë që të fitojnë kompetencë/shkathtësi të caktuar dhe
- 2) paraprakisht t’i informojmë nxënësit çfarë shkathtësi ndihmëse, njohuri dhe qëndrime do të mësojnë gjatë lëndës/projektit.

Në shumicën e rasteve të ofrimit të shërbimeve në bashkësi qëllimet e të mësuarit dhe ofrimit të shërbimeve janë të kombinuara.²⁶ “Më tej, edhe të dy kategoritë e qëllimeve duhet të kenë progres nga veprimet të cilat janë qartë të matshme dhe mund të vërtetohen (gjegjësisht të cekën, të identifikojnë dhe të definojnë) ndaj veprimeve të cilat janë më të ndërlikuara dhe kërkojnë analizë, aplikim dhe sintezë të materialit të ri. Në nivelin më të lartë të ndërlikimit, nga studentët duhet të kërkohet të kritikojnë, polemizojnë dhe të formojnë rekomandime në bazë të interpretimit të tyre në ndonjë

²⁵ Erickson, M. Susan, 2010, *Investigating Community Impacts of a University Outreach Program through the Lens of Service Learning and Community Engagement*, Master thesis, Ames, Iowa: Iowa State University. E marrë nga biblioteka Gelman, ProQuest Dissertations & Theses më 15 korrik 2012.

²⁶ Hauer, Julie, and Timothy Quill, 2011, ‘Educational Needs Assessment, Development of Learning Objectives, and Choosing a Teaching Approach’, *Journal of Palliative Medicine*, Vol. 14, No. 4, fq. 503 – 507, fq. 44.

material të ri. Gjithashtu, shumë e rëndësishme është t'u jepet prioritet qëllimeve të ndryshme për të mësuar dhe për kryerjen e shërbimeve në bazë të asaj se cilat qëllime do të ishin më të dobishme për programin nga aspekti i qëndrueshmërisë. Prej këtu do të caktohen qëllimet, ato duhet në mënyrë eksplicite të ndahen me partnerët nga bashkësia dhe me studentët përmes planit mësimor sipas të cilit mësojnë studentët dhe përmes aktiviteteve përmes të cilit realizohet mësimi".²⁷

Parker-Gwin dhe Mabry (1998)²⁸ rekomandojnë qasje pak më ndryshme ndaj përshkrimit të qëllimeve dhe programeve përmes shërbimit në bashkësi:

- Promovimi i rezultateve pozitive të iniciativës qytetare, gjegjësisht promovimi i qëndrimeve pozitive ndaj vullnetarizmit dhe aktivitetit qytetar dhe forcimit të ndjenjës për përgjegjësinë qytetare të studentët, vetëdija qytetare dhe motivimi për vullnetarizëm. Qëllimet e pothuaj çdo lënde mësimore mund të zgjerohen që të inkuadrohet edhe arsimit qytetar.
- Promovimi i rezultateve akademike, gjegjësisht përmirësimi i të mësuarit akademik përmes integritit të shërbimit ndaj bashkësisë dhe përmbajtjes së lëndëve të cilat mësohen (zhvillimi i shkathtësive për analizë dhe zgjidhja e problemeve, si dhe aftësi për të menduarit kritik). Studentëve u jepet rast që t'i përdorin/aplikojnë njohuritë e veta në situata reale. Sipas prof. Koçi, pas diplomimit, studentët shumë rrallë do të hasin në situatë ku njohuritë e tyre teorike në mënyrë të saktë do t'i përgjigjet situatës me të cilën ballafaqohen. Do të thotë, me qëllim që me të vërtetë të stimulohet interaksioni mes njohurisë praktike të studentit dhe "botës reale", projekti për të mësuarit shërbyes duhet t'i nxitë studentët që t'i aplikojnë njohuritë e tyre në mënyra të reja dhe paraprakisht të panjohura.

Qasja holistike që e ofron të mësuarit shërbyes, u mundëson studentëve nga grupe të ndryshme t'i identifikojnë, pranojnë dhe t'i kuptojnë dallimet e tyre të ndërsjella dhe në këtë mënyrë të bashkëpunojnë për zgjidhjen e çështjeve, të cilat kanë të bëjnë me bashkësinë ku jetojnë. Me këtë, ata ballafaqohen me çështjet e hapura mes veti, gjegjësisht ballafaqohen me jo tolerancën e cila ekziston në bazë të dallimeve etnike, religjioze dhe/ose nacionale. Krahas kësaj, ata negociojnë dhe krijojnë strategji për tejkalimin e këtyre dallimeve dhe për afrim, si dhe për avancimin e pranimin të ndërsjellë dhe tolerancë. Kujdesi për vetëdijen, inkuadrimit, përgjegjësia qytetare dhe vlerat janë thellë të rrënjësura në të mësuarit shërbyes. Përmes kyçjes së komponentit në të mësuarit shërbyes në programet mësimore për studimet pas diplomimit për trajnim të kuadrit mësimor me qëllim që studentët në mënyrë të drejtpërdrejtë të ekspozohen në, gjegjësisht nga afër të njohohen me personat me handicap/invaliditet/pengesë, sigurohet struktura për ndryshimin e vetëdijes, qëndrimet dhe vlerat përmes kontaktit të drejtpërdrejtë. Për shembull, gjetjet për pjesëmarrjen e studentëve në projekt për të mësuarit shërbyes si pjesë nga angazhimi i studentëve për *Analizë të nevojave dhe dizajni i lëndës (NACD)* që implementohet në Universitetin e Evropës Juglindore, Tetovë²⁹ flasin për ndikimin pozitiv të mësuarit shërbyes mbi qëndrimet mes studentëve të cilët punojnë në mjedise multietnike, në më shumë rajone ose punojnë me njerëz me handicap/invaliditet/pengesë. Prej këtu, rekomandohet dhe llogaritet si e mirëseardhur vazhdimi i kësaj praktike pozitive edhe në të ardhmen si hyrje për integrimin më të mirë dhe pranimin mes të rinjve.

²⁷ Benton-Short, Lisa (Ed.), 2012, *Service-Learning Faculty Handbook*, cit., fq. 24.

²⁸ Parker-Gwin, Rachel and J. Beth Mabry, 1998, 'Service Learning as Pedagogy and Civic Education: Comparing Outcomes for Three Models', *Teaching Sociology*, Vol. 26, No. 4, fq. 276 – 291, fq. 277.

²⁹ NACD lënda është dizajnuar nga psikologu francez prof. Sandra Bruno, e cila me Aida Koçi e ligjëronte të njëjtën në vitin 2006. Kjo lëndë ofrohet në studimet deri në diplomim dhe pas diplomimit në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë.

Shembull: Studentët të cilët janë paraqitur për ndjekjen e mësimit për lëndën *Këshillime për zhvillimin e karrierës* bashkë me fëmijët që kanë përjetuar kancer, kanë realizuar një varg të punëtorive për zhvillimin e karrierës. Qëllimi ishte të:

- Aplikohen teori të ndryshme për zhvillimin e karrierës dhe modele mbi popullatën e klientëve (individë të cilët kanë përjetuar kancer në fëmijëri);
- Njoftohen me rezultatet më të reja nga puna në terren në fushën e tranzicionit dhe ndikimi mbi grupet në bashkësi;
- Kuptojë më shumë për modelet themelore, metodat dhe parimet e zhvillimit të programit;
- Aplikohet njohuri për planifikimin e programit dhe për ofrimin e shërbimeve për zhvillimin e karrierës në kontekst të përvojave specifike me të mësuarit shërbyes;
- “Kuptojnë dhe zbatojnë procesin e vendimmarrjes dhe modeleve teorike për programet për zhvillimin e karrierës;
- Harmonizohen resurset të cilat janë të kapshme për zhvillimin e karrierës me nivelet specifike zhvillimore dhe nevoja e studentëve dhe klientëve, veçanërisht të atyre të cilëve u shërben përmes projekteve në kuadër të mësimit;
- Kuptojë ndikimin e shoqërisë multikulturore mbi qasjen drejt këshillimit dhe vendosjes lidhur me zhvillimin e karrierës.”³⁰

b) Qasjet drejt dizajnit të lëndës mësimore për të mësuarit shërbyes

Sipas prof. Koçi, ekzistojnë dy mënyra themelore që të dizajnohet lëndë mësimore për të mësuarit shërbyes. Ato mund të quhen ‘dizajn i bazuar në nevojë’ dhe ‘dizajn i bazuar në programin mësimor’.

Te ‘dizajni i bazuar në nevojë’, filluam me identifikimin e nevojave të bashkësisë dhe vazhduam me inkuadrimin e diçka relevante në programin mësimor. Koncepti i nevojës mund të sqarohet përmes perspektivave të ndryshme:

- Nevoja si dëshirë ose preferencë;
- Nevoja si mungesë nga diçka ose si problem – kjo pikëpamje nënkupton se ekziston situatë ku nuk është arritur niveli minimal i kënaqshëm (që mund të jetë ose objektive ose përcaktim i çfarëdoshëm);
- Nevoja si jaz mes rezultateve të tanishme dhe atyre që priteshin ose si dallim mes gjendjes së tanishme dhe situatës ideale.³¹

Zakonisht, procesi i dizajnit të planit mësimor ose lëndës mësimore në bazë të kësaj qasjeje fillon me “brainstorming” për problemet e ndryshme të cilat ekzistojnë në bashkësi të caktuar. Thelbi te dizajni i lëndës mësimore me të mësuarit shërbyes është bazuar në nevojën që të fillohet me nevojat e bashkësisë dhe të punohet drejt përbërjes së programit mësimor sipas të cilës ligjërohet. Vlerësimi i nevojave të programit mësimor është proces dinamik, pluralist dhe fleksibël, i cili bazohet në mbindërtimin e vazhdueshëm. Njëkohësisht, ky është proces pro aktiv dhe reaktiv. Vlerësimi bazohet në parimin e fokusimit të ndryshëm mbi tre faktorët kryesor – ai i cili mëson, shoqëria dhe lënda e interesit – dhe stabiliteti i prodhimit të saj dallohet në nivele të ndryshme të vendosjes.³² Disa pjesë nga programi mësimor duhet të ndryshojnë pak që t’u përgjigjet kërkesave të bashkësisë.

Te “dizajni i bazuar në programin mësimor” drejtimi është i kundërt. Prej këtu, filluam me të menduarit rreth programit mësimor ashtu siç është dhe punojmë drejt gjetjes së mënyrave përmes të

³⁰ Benton-Short, Lisa (Ed.), 2012, *Service-Learning Faculty Handbook*, cit., fq. 25.


³¹ Kourosh, Fath Vajargah, 1999, *Needs-Based Curriculum Approach (Toward a New Conception of National Curriculum)*, Paper presented at ACSA Conference, Sept. 29, 1999, Perth, Australia, fq. 2

³² Ibid, fq. 6 – 8.

cilave kjo njohuri specifike mund të jetë në dobi për bashkësinë. Të dy metodat janë vepruese gjatë dizajnit të projekteve të mësuarit shërbyes. Sipas dr. Koçit, ‘dizajni i bazuar në nevojë’ shpesh shfaqet si metodë më e mirë në rastet kur ligjërohet lëndë akademike, e cila ka shumë përdorime praktike (e drejta, inxhinieria, fizika, matematika, gjuhë të përhapura të huaja, gazetaria etj.), derisa ‘dizajni i bazuar në programin mësues’ do të ishte më i dobishëm nëse ligjërohet lëndë akademike që nuk ka shumë ndryshime tradicionale dhe praktike (latine, filozofia, letërsia e shekullit 16, arkitektura e Egjiptit të vjetër etj.).


Mund të përdoret edhe qasja e tretë për dizajnimin dhe vlerësimin e lëndëve dhe programeve mësimore – ‘qasje e fokusuar në të mësuarit’. E njëjta me sukses përdoret në institucionet e profileve të ndryshme: private dhe publike, të mëdha dhe të vogla, si me buxhete të ndryshme. Kjo qasje përdor model/pasqyrë formale për atë si të shkohet nga konceptet drejt aktualizimit, nga teoria drejt praktikës dhe përpiqet të mundësojë ndryshime të dukshme dhe afatgjate në gjendjen e tanishme të arsimit sipëror në botë. “Modeli ndjek renditjen specifike që fillon me vlerësimin e nevojës dhe deklarata për qëllimet lidhur me procesin e të mësuarit (lëviz nga e përgjithshme drejt specifikes), që është e përcjellë me dizajnin, zbatimin, vlerësimin dhe revidimin e lëndës ose programin mësues (Fotografia 1.2.).

Fotografia 1 **Renditja themelore e dizajnit**³³



Kjo renditje siguron rrjetëzim të qëllimeve, procesit mësues dhe vlerësimit. Të ballafaquar me kërkesën e jashtme që ta vlerësojnë kualitetin e programeve të tyre akademike, departamentet, shkollat, kolegjet dhe universitetet kuptojnë se pa dallim ku do të fillojnë në proces, do të duhet të kthehen drejt deklaratës së nevojës para se të mund të zhvillojnë deklaratë të qëllimeve lidhur me procesin e mësimit mbi të cilat duhet të bazohet vlerësimi.”³⁴

Fotografia 2 **Renditja e vlerësimit**³⁵



Sipas kësaj qasjeje, ekzistojnë parakushte kyçe për revidimin e programit mësues me qëllim të inkuorporimit të mësuarit shërbyes:

- Bazë solide e talentit mësues në të gjitha fushat akademike adekuate;
- Mbështetje nga departamentet/katedrat kyçe të prezantuara nga pjesëtarët e kuadrit mësues të fakulteteve të cilat gëzojnë respekt nga kolegët e tyre dhe
- Stabiliteti institucional.

³³ Ibid, fq. 10.


³⁴ Diamond, Robert M., 2008, *Designing and Assessing Courses and Curricula: A Practical Guide*, Third edition, San Francisco, CA: Jossey-Bass: John Wiley & Sons, Inc., fq. 10.

³⁵ Ibid, fq. 10.

Ekzistojnë faktorët e shumtë (të jashtëm dhe të brendshëm) të cilët duhet të merren parasysh gjatë vendimmarrjes që të ndërmerren projekte për ri dizajnimin e programit ose lëndës të caktuar mësimore, si tregues për suksesin potencial për projektet e tilla.³⁶

Fotografia 3 paraqet version gjithëpërfshirës të modelit të dizajnit të programit dhe lëndës mësimore që është fokusuar në procesin e të mësuarit.

Fotografia 3. *Modeli për procesin e dizajnit të programit mësimor ose lëndës mësimore të fokusuar në procesin e të mësuarit*³⁷



Në fund të kësaj pjese, do të kishim dashur t'i kushtojmë vëmendje faktit se të mësuarit shërbyes mund të shfrytëzohet për çdo lëndë të mundshme. Nëse lënda është aq e pa aplikueshme në realitet për nxënësit asnjëherë nuk mund t'i shfrytëzojnë njohuritë e veta jashtë klasës, atëherë pse ta ligjërojnë atë lëndë? Më poshtë janë dhënë disa nga shembujt e të mësuarit shërbyes në shkollimin artistik:³⁸

³⁶ Ibid, fq. 67 – 69.

³⁷ Ibid, fq. 61

³⁸ E përshatur nga Taylor, Pamela A. and Christine Ballengee-Morris, 2004, 'Service-Learning: A Language of "We"', cit., fq. 8.

<i>Shembuj të mësuarit shërbyes në shkollimin artistik</i>		
Arsimi fillor	Arsimi i mesëm	Arsimi sipëror
* Vendosja e partneritetit me Shtëpinë e pleqve që e vizitojnë studentë dhe do të tregojnë rrëfime me banorët, e pastaj do t'i rrëfejnë ato rrëfime përmes artit. Lidhje akademike mund të bëhen përmes studimit të artistëve të ndryshëm dhe/ose përmes studimit të artefakteve kulturore (Perks dhe Thomson, 1998).		
* Përgatitja dhe dërgimi i letrave dhe kartolinave deri te pacientët nga spitali lokal për studimin e artit ilustrues dhe/ose artit që merret me probleme shëndetësore, siç është mbulesa SIDA ³⁹ .	* Studentë në arsimin e mesëm dhe/ose sipëror mund gjatë ose pas orëve të japin orë të artit për fëmijët e shkollave fillore. Përmes vizitave në shkolla dhe biseda me fëmijët, studentët formulojnë 'leksione të cilat i kanë mësuar', dhe të cilat janë relevante për bashkësinë dhe grupet e moshuara të fëmijëve të cilëve u jepet mësimi.	
* Puna me organizatat lokale për ambientin jetësor ose për bashkësinë që të hiqen mbeturinat nga fusha e bashkësisë pas studimit të veprave të artistëve të caktuar ose rregullimit të ambientit për rajon të caktuar të lirë në afërsi të shkollës.		
* Thurja e qilimave dhe/ose veprave tjera artistike për kuzhinën lokale popullore në kombinim me studimin e autorëve të caktuar.	* Bashkëpunimi me bibliotekën lokale që të krijohen instalime dhe/ose reklama për mbështetje të programit të tyre për lexim gjatë verës dhe studimi i artistëve të cilët merren me letërsi. * Dhe/ose puna në qendrën për arsimim ose në shkollë fillore si mentorë për lexim duke shfrytëzuar fotografi të krijuara nga studentë si vegla për fjalë të caktuara.	
* Pikturimi i freskës e cila do të vendoset në vend publik me çka do të promovohet ose mbështetet organizatë e caktuar jofitimprurëse, ngjarje e bashkësisë dhe/ose program për ndihmë bashkësisë.	* Puna me "Habitat for Humanity" pas ose si pjesë e studimit të arkitekturës dhe/ose të veprave të artistëve të caktuar modern të cilët merren me strehimin (Lacy, 1995)	* Puna në muze si ciceron, si edukatorë të muzeut dhe koordinatorë të veprimtarisë arsimore. Aktivitetet janë dizajnuar rreth ekspozitave aktuale ose koleksioneve të përhershme.
* Puna me personelin për ruajtjen e objekteve publike, përmes takimeve me secilin prej tyre dhe ndihma në kryerjen e një pjese të detyrave pasi që paraprakisht janë studiuar arte të caktuara që luhen (Lacy, 1995).	* Dizajni i ueb faqes për organizatat lokale jofitimprurëse pas studimit të arteve të dizajnit dhe përpunimit të posterëve (ArtsLynx, 2003).	
* Mbështetja e projektit "Enë të zbrazëta" ⁴⁰ (Taylor, 2002).		
* Këto ide janë prezantuar si inspirim për bisedime dhe duhet të përshtaten sipas nevojave të palëve të involvuara.		

Prof. Koçi përmendi se në fillim inkuadrimi i të mësuarit shërbyes në programin mësimor mund të duket si punë e madhe plotësuese. Gjatë projektit tuaj të parë, me siguri do jetë kështu. Megjithatë kjo nuk është ashtu pse të mësuarit shërbyes është e vështirë për arsimtarët. Kjo është ashtu sepse inkuadrimi i metodologjisë në kuadër të një mjedisi arsimor gjithnjë kërkon investim fillestar në kohë dhe energji. Megjithatë, gjithashtu duhet të kuptohet se të mësuarit shërbyes, kur do të vendoset në programin mësimor, ka potencial t'i lehtësojë punët për arsimtarin. Shkaku është shumë i thjeshtë: me të mësuarit shërbyes, studentët mësojnë përmes praktikës, ndërsa me teknikat ligjëruese tradicionale ata mësojnë përmes dëgjimit.

³⁹ The Aids Quilt.

⁴⁰ The Empty Bowls project.

c) **Modele të lëndëve mësimore për të mësuarit shërbyes në programin mësimor**

Në shkrimin e tyre “Të mësuarit shërbyes si pedagogji dhe arsim qytetar – krahasim i rezultateve nga tre modele”, Parker-Gwin dhe Mabry (1998) paraqesin tre lloje të lëndëve mësimore për të mësuarit shërbyes në programet mësimore të Universitetit Virxhinia Tek:

- **Të mësuarit shërbyes opsional** – studentët kanë mundësi të fitojnë një pjesë të kredive të parapara përmes vullnetarizmit në organizata të ndryshme në bashkësi. Hartohen qëllimet afatshkurta dhe afatgjata për bashkësinë lokale dhe nga studentët kërkohet që rregullisht të mendojnë për përvojat lidhur me shërbimin përmes shkrimit të punëve seminarike ose prezantim para studentëve tjerë. Në këtë mënyrë shërbimi është i lidhur me përmbajtjen e lëndës mësimore.
- **Të mësuarit shërbyes i obligueshëm** – nga të gjithë studentët kërkohet që të shërbejnë në bashkësi dhe ata mendojnë, gjegjësisht i shprehin refleksionet e tyre për përvojat e tyre gjatë semestrit. Këto mendime shprehen në ditar përmes të cilit shërbimi lidhet me temat e lëndës së tyre mësimore. Studentët gjithashtu shkruajnë punim final ku e inkadrojnë punën e tyre në terren dhe mbajnë prezantime para gjithë klasës në fund të semestrit.

Në këto modele studentët zgjedhin mes lokacioneve/organizatave të ndryshme në bashkësi të cilat identifikohen nga ana e ligjëruesve në bazë të përmbajtjes së lëndës mësimore.

- **Grupi për konsultime** – e gjithë klasa është e angazhuar në realizimin e ndonjë projekti dhe atë në një lokacion. Studentët punojnë në ekipe që ta kryejnë atë projekt. Prej tyre nuk kërkohet të mendojnë për atë se si e kryejnë/japin shërbimin e tyre, por nga të gjithë kërkohet të japin raport përfundimtar për projektin.⁴¹

Në bazë të punimit të Rice “Ndërtimi i partneriteteve reciproke mes bashkësisë dhe universiteteve”⁴², dr. Barbara Jacoby, bashkëpunëtore për lidhshmëri dhe të mësuarit shërbyes në Universitetin në Merilend, Kolehxi Park,⁴³ propozon listë tjetër të modeleve të mësuarit shërbyes në programin mësimor:

1. Lënda mësimore ku të mësuarit shërbyes nuk është i obliguar;
2. Lënda mësimore me të mësuarit shërbyes;
3. Të mësuarit shërbyes përmes punës në terren;
4. Hulumtimi i bazuar në bashkësi;
5. Projekt përfundimtar për të mësuarit shërbyes para diplomimit;
6. Seminare ku dekani fton diskutues dhe pjesëmarrës në debate nga vetë bashkësia dhe programet mësimore për njoftim të studentëve në vitin e parë;
7. Të mësuarit shërbyes përmes punës praktike ose studimit të pavarur;
8. Të mësuarit shërbyes ndërkombëtar;
9. Renditja për përcjellje të lëndëve mësimore sipas avancimit të tyre;
10. Lënda me të mësuarit shërbyes të integruar ose opsion për fitimin e kredive plotësuese pas përfundimit të lëndës me komponentë të mësuarit shërbyes;
11. Departamenti universitar ose program që është në interaksion me bashkësinë;

⁴¹ Parker-Gwin, Rachel and J. Beth Mabry, 1998, ‘Service Learning as Pedagogy and Civic Education: Comparing Outcomes for Three Models’, cit., fq. 278, 289.

⁴² Rice, Kathleen, 2008, *A GUIDE TO RECIPROCAL COMMUNITY-CAMPUS PARTNERSHIPS*, Proceedings from Portland State University’s Partnership Forum, March 6-8, 2008 (A Unique Collaborative Study of Partnerships from the Perspectives of both Community Partners and Higher Education Partners), Portland University. E shkarkuar më 10 korrik 2012 nga:

http://depts.washington.edu/ccph/pdf_files/Guide_corrected_041808.pdf

⁴³ For more on Prof. Jacoby’s work visit: <http://www.magnapubs.com/bio/124/>.

12. Universitet që është në interaksion me bashkësinë.

Prof. Jacoby, gjithashtu, jep përshkrim dhe shembuj konkret të strukturës që mund ta kenë këto lëndë mësimore. Në tabelën në vijim janë dhënë përshkrime dhe shembuj të llojeve të ndryshme të mësuarit shërbyes ashtu siç janë prezantuar në formë origjinale në *Doracakun për kuadrin mësimor për të mësuarit shërbyes* të Universitetit Xhorxh Uashington (Tabela 2.).

Tabela 2 *Tipa të shërbimit me përvojë (service experience)*⁴⁴

Lloje të shërbimit me përvojë	Përshkrimi	Shembuj
<i>Projekte grupore</i>	Studentët punojnë bashkërisht në një ose më shumë grupe. Ky shërbim mund t'i jepet një ose më shumë organizatave si projekt me rezultat të kapshëm ose si aktivitet i strukturuar.	Studentët të cilët e ndjekin lëndën mësimore nga marketingu, anketojnë së paku një agjenci për marketing dhe mësojnë 'vlera plotësuese' për agjencinë përmes vizitave që i bëjnë. Në bazë të përvojës së tyre, studentët dizajnojnë edhe material për marketing (broshurë, afishe) të dedikuara për agjencinë.
<i>Vendosja individuale në organizatë</i>	Nga të gjithë studentët kërkohet që në mënyrë individuale ta plotësojnë komponentin shërbyes për kryerjen e lëndës mësimore. Studentët punojnë në lokacione nga lista e lokacioneve të ofruara për të mësuarit shërbyes dhe i plotësojnë qëllimet të cilat janë paraparë nga organizatat dhe ligjëruesi dhe/ose studenti. Detyrat janë dizajnuar që ta lehtësojnë të mësuarit e shkathtësive ose lëndëve.	Studentët të cilët e ndjekin mësimin nga lëndë ku studiohet fenomeni i vdekjes, shërbejnë në institucione për mbrojtje shëndetësore, qendrat për mbajtjen në jetë, spitale për të sëmurët e rëndë dhe në vende tjera. Në orët përmenden përvojat e ndryshme përmes të menduarit dhe diskutimit.
<i>Hulumtim i bazuar në bashkësi</i>	Studentët mësojnë metodologji për hulumtim, derisa shërbejnë si përfaqësues të bashkësisë. Institucionet në bashkësi luajnë rol të rëndësishëm në identifikimin e çështjeve të cilat duhet të hulumtohen. Studentët pastaj i hulumtojnë këto çështje që të fitojnë kuptim më të mirë, njëkohësisht duke siguruar të dhëna në rrjedhë për institucionet në bashkësi.	Gjatë semestrit studentët në lëndët mësimore nga biologjia periodikisht e studiojnë nivelin e ndotjes së lumit Anakostia. Studentët punojnë me partnerë nga bashkësia, siç është Agjencia e rrjedhës së lumit Anakostia, të grumbullojnë të dhëna dhe ti përmbledhin rezultatet gjatë mësimin. Raporti që do të përgatitet u shpërndahet Shoqatës që më mirë ta orientojë punën e vet.
<i>Studimi i pavarur</i>	Një ose më shumë studentë janë inkuadruar në të mësuarit shërbyes lidhur me një disiplinë ose temë. Studentët rregullisht takohen me anëtar të kuadrin mësimor në fakultet që të bisedojnë dhe të mendojnë për përvojën.	Pjesa më e madhe e kohës në këtë model nuk kalohet në mësim, por në shërbim. Zakonisht për studentët të inkuadruar në studimin e pavarur përmes të mësuarit shërbyes të kalojnë 100 orë në shërbim. Në fund studentët shkruajnë punim hulumtues.

⁴⁴ Benton-Short, Lisa (Ed.), 2012, *Service-Learning Faculty Handbook*, cit., fq. 23.

d) Implementimi i të mësuarit shërbyes në kuadër të procesit mësimor

Procesi i zbatimit ose integritit të mësuarit shërbyes mund të përshkruhet përmes fazave në vijim:⁴⁵

- **Bashkëpunimi**, kryesisht **planifikimi**, caktimi i qëllimeve dhe teknikave administrative të cilat përfshijnë koordinim të ngushtë me organizatën nga bashkësia dhe të punësuarit e saj (**implementimi**). Organizimi i cilitdo projekt për të mësuarit shërbyes në të vërtetë ka të bëjë me bashkëpunimin, planifikimin dhe implementimin. Këto procese janë të rëndësishme për shkak të ndikimit të tyre të madh mbi (a) efektivitetin e të mësuarit shërbyes dhe (b) përfitimet për studentët dhe bashkësitë nga këto ‘intervenime’. Janë të rëndësishme dhe pasiqë ndihmojnë të eliminohen problemet potenciale lidhur me vendimmarrjen në kushte të informatave të pamjaftueshme të kapshme. Në të vërtetë, gjatë kësaj faze zhvillohen këto aktivitete:
 - Pasqyrë thelbësore e literaturës nga fusha e të mësuarit shërbyes në përpjekje që të locohen modelet efektive dhe të matshme të mësuarit shërbyes;
 - Kërkimi dhe zgjedhja e organizatës e cila do të jetë nikoqire e projektit për të mësuarit shërbyes;
 - Komunikimi dhe koordinimi me menaxherin dhe personelin e organizatës me qëllim të:
 - sqarimit të qëllimeve të vetme dhe të përbashkëta;
 - konceptimi dhe kontraktimi i marrëveshjes për të mësuarit shërbyes;
 - planifikimi i njoftimit të studentëve në program dhe
 - dizajnimi i instrumenteve administrative të cilat do t’i përdor personeli i organizatës gjatë caktimit, mbikëqyrjes dhe vlerësimit të studentëve.
 - Fillimi i projektit për të mësuarit shërbyes në mënyrë që:
 - mos ta ngarkojë personelin dhe sistemin e logjistikës të organizatës;
 - mundëson pranimin e një fluksi të madh të studentëve-punëtorëve në organizatën nikoqire dhe
 - shprehet si i sigurt dhe garanton se të gjithë studentët e inkuadruar në projektin për të mësuarit shërbyes janë caktuar, mbikëqyrur dhe vlerësuar në mënyrë të njëjtë.
- Pjesëmarrja e **studentëve** në procesin e **vendosjes formale të programit** dhe pasqyrë e strukturës së organizatës nga bashkësia, qëllimet dhe kushtet e shërbimit. Kjo mund të bëhet në dy mënyra të veçanta:
 - Projekti për të mësuarit shërbyes, qëllimet e tija, pritet nga arsimtarët, teknikat për evolucion dhe rregullat për vlerësim janë cekur në përshkrimin e lëndës dhe janë sqaruar gjatë njoftimit me lëndën mësimore.
 - Gjatë mësimin në kampin universitar organizohet takim informativ për prezantimin dhe njoftimin me programin me qëllim që të sigurohet vizitë maksimale.

Gjatë njoftimit me programin, studentët njoftohen me historinë e organizatës nikoqire, misionin e saj, kuadri që punon në atë organizatë dhe popullatës së cilës i shërben. Ata, gjithashtu, mund ta shqyrtojnë marrëveshjen për të mësuarit shërbyes, të shtrojnë pyetje të ndryshme, si dhe ta shqyrtojnë dhe ta vlerësojnë projektin për të mësuarit shërbyes në bazë të përshtypjeve dhe pikëpamjeve të tyre fillestare. Informatat e tilla nga studentët janë me rëndësi të veçantë, sepse pritet që programi për njoftim të mund të shërbejë që mes studentëve shumë herët të krijohet ndjenja e bashkësisë.

⁴⁵ Hollis, Shirley A., 2002, ‘Capturing the Experience: Transforming Community Service into Service Learning’, *Teaching Sociology*, Vol. 30, No. 2 (Apr., 2002), fq. 200 – 213, fq. 201, 202, 204 – 208.

- **Marrja parasysh e interesave të studentëve** gjatë caktimit të detyrave të punës;
- **Pjesëmarrja e studentëve** në detyra pune të rëndësishme dhe të dobishme për shoqërinë;
- Inkuadrimi në **detyra** të leximit dhe hulumtimit të **fokusuar** që janë të lidhura në mënyrë direkt me kushtet (rrethanat) me të cilat studentët ballafaqohen gjatë shërbimit të tyre. Gjatë kësaj faze studentët duhet të fitojnë mirëkuptim themelor për kushtet ekonomike, sociale dhe kulturore në bashkësi para se të fillojnë me të mësuarit e tyre shërbyes. Në shumicën e rasteve, ligjëratat të fokusuar, diskutime dhe detyra në terren lidhur me këto kushte/çështje tregohen si të dobishme dhe efektive në drejtimin e vëmendjes së studentëve në mënyrë më direkt ndaj çështjeve lidhur me të mësuarit e tyre shërbyes.

Të gjitha këto aktivitete më shumë janë të orientuara drejt ngritjes së vetëdijes dhe informimit të nxënësve/opinionit. Pjesë tjetër e rëndësishme nga mësimi përgatitor është hulumtimi që kryesisht bazohet në shfrytëzimin e literaturës, internetin dhe burimet tjera për shkak të njoftimit të studentëve me problemet ose çështjet themelore ose urgjente të bashkësisë. Këto detyra janë ngushtë të harmonizuara me parimet në literaturën themelore të propozuar për lëndën mësimore dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë janë të lidhura me kushtet me të cilat studentët me siguri ballafaqohen dhe me të cilat do të përpiqen të përballohen. Pas përfundimit të detyrave hulumtuese, nga studentët kërkohet t'i shkruajnë gjetjet e tyre dhe mendimet dhe t'i dorëzojnë për vlerësim dhe komente.

- Përfshirja e ditarëve për **të menduarit kritik** me qëllim që të nxiten studentët të fokusohen në kushtet sociale dhe t'i përdorin parimet sociologjike që t'i formojnë observimet e tyre. Në ditar, periodikisht, shënohen observimet dhe mendimet, me qëllim që rregullisht të evidentohen përvojat nga shërbimi dhe rëndësia e tyre. Ata, gjithashtu, u ndihmojnë studentëve ta vëzhgojnë veten dhe të hulumtojnë për veten. Ditarët nuk janë vetëm përshkrime të observimeve të plotësuara me material nga librat për mësim. Në vend të kësaj, ata kërkojnë të menduar kritik dhe e nxitin të mësuarit, transformimin e përvojës, hulumtimin e sistemit të bindjes, dhe ristrukturimi i rëndësisë së disa bindjeve dhe ndjenjave në suaza të kontekstit më të gjerë shoqëror. Rezultati përfundimtar nga gjithë kjo duhet të formohen tërësisht pikëpamjet nga inkuadrimi në projekt për të mësuarit shërbyes.
- **Diskutimet dhe mendimet** e fokusuar gjatë mësimit – paraqesin instrument të fuqishëm për studentët që të shkëmbejnë ide, observime dhe pikëpamje, si dhe të komunikojnë dhe të 'intervenojnë' kur u nevojitet ndihmë në realizimin e qëllimeve të projektit. Krahas kësaj, qasja holistike që e ofron projekti për të mësuarit shërbyes, u mundëson studentëve nga grupet e ndryshme t'i identifikojnë, pranojnë dhe t'i kuptojnë dallimet e tyre dhe në këtë mënyrë të punojnë dhe të bashkëpunojnë dhe bashkarish t'i zgjidhin çështjet, të cilat kanë të bëjnë me bashkësinë ku jetojnë. Me këtë, ata ballafaqohen me çështje të hapura mes tyre, gjegjësisht me jo tolerancën në bazë etnike, religjioze dhe/ose nacionale. Krahas kësaj, ata negociojnë dhe krijojnë strategji për tejkalimin e këtyre dallimeve, për afrimin dhe avancimin e pranimin të ndërsjellë de tolerancës. Kujdesi për vetëdijen, inkuadrimi, përgjegjësia qytetare dhe vlerat kanë thellë të rrënjësura në mësimin përmes shërbimit në bashkësi. Gjatë diskutimeve të hapura studentët i ballafaqojnë etnocentrizmat, stereotipa dhe paragjykimet e tyre. Gjatë kësaj, bashkarish ballafaqohen me frustrimet të ndryshme, frika, mirëkuptime të reja të zbuluara, mosuksese të shoqërisë etj. Kjo vetëm flet se inkorporimi i komponentëve të mësuarit shërbyes në programin mësimor siguron platformë për ndryshimin e vetëdijes, frikës dhe vlerave përmes kontaktit të drejtpërdrejtë.
- **Vetë evoluimi reflektiv** që i nxitë studentët t'i sintetizojnë njohuritë e tyre, të mendojnë për atë se si aftësitë e tyre për vëzhgim janë zhvilluar gjatë projektit dhe të zhvillojnë përfundime të reja dhe mirë të informuara për përvojat dhe observimet e tyre;

- **Evoluimi dhe inkuadrimi i informatave kthyes** nga kuadri mësimor në fakultete, bashkësia të cilës i shërbehet dhe organizata nga bashkësia-nikoqire.

Prof. Aida Koçi ofron qasje relativisht të thjeshtë drejt realizimit të projektit për të mësuarit shërbyes me përshkrimin e katër elementeve themelore në gjithë procesin. Këto janë:

1. **Përgatitja në klasë** – Së pari, profesori duhet të caktojë se cili tip i njohurive specifike do t’u nevojitet studentëve me qëllim që të realizohet vetë projekti ose gjatë mëimit dhe pastaj, ato njohuri specifike qartë t’i përfshijë në përshkrim dhe udhëzimet për lëndën adekuate. Për shembull, nëse jeni profesor i gjuhëve dhe përgatitni projekt që përfshin përkthim, para projektit do t’i shqyrtoni teknikat e përkthimit me nxënësit tuaj.
2. **Aktiviteti** – aktiviteti është shërbimi që duhet të realizohet.
3. **Autputi** – kjo është ajo që studentët do ta krijojnë përmes aktivitetit. Në disa raste aktiviteti dhe autputi janë identik. Për shembull, nëse studentët e gjuhëve të huaja përkthejnë material për organizatë joqeveritare, përkthimi është edhe aktivitet edhe autput. Në raste të tjera aktiviteti dhe autputi janë të ndryshëm. Për shembull, nëse studentët e inxhinierisë u ndihmojnë pronarëve lokal të shtëpive ta vlerësojnë integritetin strukturor të kulmeve të tyre, atëherë *aktiviteti* janë konsultimet me pronarët e shtëpive, ndërsa *autputi* është diçka tjetër – planet për forcimin e ndërtimit, për shembull. *Autputi* u nevojitet profesorit, si edukator, që të mund t’i vlerësojë studentët.
4. **Të menduarit (refleksioni)** – shumë njerëz praktikë të mësuarin shërbyes mendojnë se efektiviteti i projekteve rritet kur nga studentët më pas kërkohet të mendojnë për atë që e kanë mësuar. Ky të menduar mund të ketë disa forma – për shembull, shkrimi në ditar ose diskutimi në klasë.

e) Roli i kuadrit mësimor në projektin e të mësuarit shërbyes

Nuk është e zakonshme që opinionimi më i gjerë ta llogarisë rolin e profesorit në të mësuarit shërbyes si të thjeshtë dhe relativisht të lehtë. Në të vërtetë, në projektet për të mësuarit shërbyes shpeshherë roli i profesorëve është sjellë deri në katër detyra të thjeshta ose përgjegjësi thelbësore. Për shembull, Aida Koçi i emëron këto katër që vijojnë:

1. **Identifikimi i idesë së projektit** – Së pari, profesori duhet të vendos cila është mënyra më e mirë për realizimin e të mësuarit shërbyes në kuadër të mëimit që ai/ajo e realizon. Pastaj, profesori duhet të vendos cilat ide janë të përshtatshme për programin mësimor, për studentët dhe për atë vetë.
2. **Përgatitja në klasë** – Profesorët do të duhet t’i mësojnë studentët me shkathtësi dhe t’ua përcjellin njohuritë, të cilat do t’u nevojiten që të mund të kontribuojnë në mënyrë efektive për realizimin e projektit.
3. **Ndarja e obligimeve të punës** – Pasiqë profesori ka vendosur cili projekt do të realizohet, ai/ajo do të duhet të vendos studentët çfarë duhet të bëjnë që ta realizojnë të njëjtin. Si do ta bëjë këtë profesori varet nga aftësitë e tija/saja personale, vendosja e klasave dhe kuadrit mësimor, si dhe nga shkathtësitë që i posedojnë studentët.
4. **Evoluimi** – Siç bëjnë edhe me çdo detyrë tjetër, edhe këtu profesorët do të duhet ta evoluojnë atë që e kanë punuar. Studentët të cilët do ta përfundojnë punën mirë, duhet të shpërblehen, ndërsa studentët të cilët do të shfaqen në dritë të dobët ose të cilët nuk do të marrin pjesë, duhet të marrin nota të dobëta për detyrën.

Mendojmë se roli i profesorëve/kuadrit mësimor është shumë i madh. Gjatë cilitdo projekt të mësuarit shërbyes, i gjithë kuadri mësimor vazhdimisht duhet t’i shqyrtojë rolet e veta si hulumtues, edukatorë dhe nëpunës sipas zonës së zhvillimit proksimal me të cilën ballafaqohen.

Koncepti i ‘zonës së zhvillimit proksimal’ (ZZHP) është vendosur nga shkencëtari rus Lev Vygotsky i cili e ka përcaktuar zonën si “distanca mes nivelit të zhvillimit të tanishëm të përcaktuar me zgjidhjen e pavarur të problemeve, pa instruksione të dhëna dhe niveli i zhvillimit potencial të përcaktuar me zgjidhjen e problemeve me udhëheqje nga më të moshuarit ose në bashkëpunim me moshatarë më të avancuar.”⁴⁶ Për Vygotsky, të mësuarit është proces social i cili nuk ndodh nga vetja, por përmes bashkëpunimit me tjerët. Në zonën e zhvillimit proksimal gjendet tjetri, i cili e tërheq atë që mëson në hulumtim të rendit më të lartë të diturisë. Tjetri është individ i cili është profesional në disiplinë të caktuar, mund të jetë arsimtar ose kolegë i cili e ka rolin e udhëheqësit nëpër ZZHP të atij që mëson derisa nuk është zotëruar njohuria e re dhe ai që mëson nuk bëhet mësues i vetvetes. Përmes kalimit mbi ‘zonë’ individ i lëviz nga njohuria e vjetër, e zotëruar drejt njohurisë së re të zotëruar.

Aspekti tjetër i rëndësishëm i ZZHP në mënyrë figurative quhet ‘vendosja e skelës’, ndërsa në thelb ka të bëjë me procesin e të mësuarit, i cili është dizajnuar me qëllim që të nxitet të mësuarit thelbësor. ‘Vendosja e skeletit’ është aksion nga ana e ‘udhëheqësit’ që të sigurohet se ai që mëson në mënyrë të drejt mund të lëvizë nëpër ZZHP. Pasiqë të vendoset problemi para studentëve, arsimtari duhet të jetë i sigurt se janë dhënë udhëzime të mjaftueshme në fillim të detyrës, që studentët të kuptojnë në cilin drejtim duhet të vazhdojnë. Arsimtari duhet të jetë shumë i vetëdijshëm për atë që ndodh me studentët, që ata të mund të fillojnë dhe pastaj, duhet t’u lejojë studentëve në mënyrë të pavarur ta përfundojnë zgjidhjen e problemit. Gjatë mësimit në klasë, arsimtari duhet të jetë i sigurt se është vendosur ‘konstrukcion mbështetës’ i mjaftueshëm që të sigurohet rritja e suksesshme e njohurive. Me shfrytëzimin e ZZHP klasa nuk është më e fokusuar rreth arsimtarit, por rreth studentëve. Studentët i ndihmojnë njëri tjetrit që të lëvizin nëpër ZZHP e tyre përmes të mësuarit bashkëpunues dhe bashkëpunues dhe mësimit reciprok.⁴⁷

“Roli adekuat i konceptuar i kuadrit mësimor në fakultete të të mësuarit shërbyes... paraqet fushë kyçe në të cilën hulumtimi në mënyrë potenciale mund të kontribuojë për përpjekje më efektive (v.j.) për të mësuarit shërbyes. ...Përmes fokusimit të rritur mbi rolin e kuadrit mësimor në fakultete dhe mjeteve me të cilat pjesëmarrja e tyre në aktivitete për të mësuarit shërbyes në mënyrë më të fuqishme do të institucionalizohet, mund të fillojë me të menduarit për ndarjen e saktë të punës dhe resurseve të nevojshme për tejkalimin e dobësisë institucionale të këtyre përpjekjeve.”⁴⁸

Duke u përqendruar në shkrimet dhe studimet paraprake shkencore, dr. Ellen Cushman nga Universiteti shtetëror në Miçigen flet për rolin kryesor të profesorëve për qëndrueshmërinë e të mësuarit shërbyes. Në të vërtetë, ajo i kushton vëmendje vështirësive me të cilat ballafaqohen profesorët kur përpiqen ta arsyetojnë punën e tyre intelektuale, pedagogjike dhe punën në shërbim të bashkësisë para kolegëve dhe administratës, pasiqë “kategoritë për evolucion të kuadrit mësimor në fakultete në shumicën e institucioneve nuk aplikohen mirë në hulumtimin që implementohet në lokacionet për të mësuarit shërbyes, veçanërisht pasiqë kategoritë e hulumtimit, të mësuarit dhe shërbimi në mënyrë tradicionale vlerësohen në mënyrë hierarkike, maten ndryshe dhe përjashtohen mes veti... Programet për të mësuarit shërbyes që kanë qenë të qëndrueshme, kanë përfshirë reciprocitet dhe kanë ndërmarrë rrezik, të cilat më së miri mund të arrihen kur hulumtuesi e sheh lokacionin si vend për të mësuar, hulumtim dhe shërbim – si vend për hulumtim të përbashkët – me

⁴⁶ Vygotsky, L.S., 1978, *Mind in Society*, Cambridge, MA: Harvard University Press, fq. 86 as cited in Wells, G., 2001, *Action, Talk, and Text: Learning and Teaching through Inquiry*, New York, NY: Teachers College Press, Columbia University, fq. 52.

⁴⁷ Lipscomb, Lindsay, Janet Swanson, and Anne West, 2004, *Scaffolding* in Orey, Michael (Ed.), 2004, *Emerging Perspectives on Learning, Teaching, and Technology*, Association for Educational Communications and Technology. Shkarkuar më 8 korrik 2012 nga: <http://projects.coe.uga.edu/epltt/index.php?title=Scaffolding>; http://projects.coe.uga.edu/epltt/index.php?title=Main_Page.

⁴⁸ Underwood, Charles, Mara Welsh, Mary Gauvain, and Sharon Duffy, 2000, ‘Learning at the Edges: Challenges to the Sustainability of Service Learning in Higher Education’, *Language and Learning across the Disciplines*, Vol. 4, Issue 3, fq. 7 – 27, fq. 23 as cited in Cushman, Ellen, 2002, ‘Sustainable Service Learning Programs’, *College Composition and Communication*, Vol. 54, No. 1, fq. 40-65, fq. 42. Last retrieved from JSTOR database, Gelman library on June 17, 2012.

studentët dhe partnerët nga bashkësia. Profesori i cili është angazhuar në të mësuarit shërbyes duhet të kuptojë se këto organizata funksionojnë, gjithashtu duhet ta njohin edhe studentët, që të mund të ndërmerren rreziqe dhe të fillojnë të ‘tërheqin jashtë nga diskursi e tyre të veta dhe kornizat e konceptuara’. Megjithatë, ky ri pozicionim i profesorit në të mësuarit shërbyes kërkon ‘përkushtim të lidhjes’ që është definuar përmes projekteve dhe hulumtimeve aktuale, në vend të implementojë ‘projekt i cili zgjat një semestër’, realizimi i të cilit u besohet studentëve. Roli i profesorit si hulumtues duhet të identifikohet fuqishëm dhe të artikulohet me kujdes kur nisë me të mësuarit shërbyes. Kur profesori do të hyjë në të mësuarit shërbyes si hulumtues dhe arsimtar, programi mund të ketë siguri të madhe për sukses në plotësimin e nevojave të studentëve dhe për legjitimitimin personal si hulumtim serioz.”⁴⁹

f) Nxitja themelore për studentët të bëhen pjesë nga detyrat dhe projektet për të mësuarit shërbyes

Profesoresha Pamela G. Taylor (2002) ofron tekst interesant për ndikimin që programet për të mësuarit shërbyes e kanë mbi studentët. Me fjalë të tjera, ajo bën përpjekje që të përmbledhen shkaqet pse studentët në arsimin sipëror janë nxitur të marrin pjesë në programet për të mësuarit shërbyes. Edhe pse pikëpamjet e saja kryesisht janë të bazuara mbi përvojën e saj nga Shkolla për art Lamar Dod, pranë Universitetit Xhorxhia dhe Universitetin Redford, Virxhinia (d.m.th. përvojë nga të mësuarit shërbyes në fushën e artit post-modern dhe pedagogji), mendojmë se qëndrimet e saja janë valide dhe aplikative pothuaj në çdo mjedis akademik pa marrë parasysh disiplinat specifike akademike të cilat studiohen atje. Lista e përfitimeve potenciale ose ‘motivimeve’ për studentët që të inkuadrohen në të mësuarit shërbyes përfshinë:

- Nevoja të transformohen si individë;
- Shpresë se do të plotësohet ndonjë nevojë e bashkësisë;
- Dëshirë që të fitohet mirënjohje për përpjekjet personale;
- Ndjenjë se dituria është fuqi dhe se fuqia është në duart e tyre (d.m.th. në duart e popullatës më të gjerë të studentëve);
- Aspiratë që të ‘ndryshojnë gjërat për të mirë’ përmes intervenimit të krijuar dhe të implementuar të përbashkët, etj.⁵⁰

Si përfundim në këtë pjesë nga publikimi mund të thuhet se përfitimet nga inkuadrimi në të mësuarit janë të ndryshme, si për studentët, ashtu edhe për arsimtarët. Studentëve u ofrohet përvojë dhe praktikë arsimore me ndikim të madh (Kuh, 2008)⁵¹. Studentët mësojnë si ta aplikojnë dhe ta përshtatin njohurinë e fituar në klasë; ndërsa ajo që mësohet është e gjerë dhe e avancuar, del nga klasa dhe shkon në bashkësi.⁵² Edukatorët fitojnë rast ta zbatojnë strategjinë për të mësuarit aktiv, i cili u ofron pasuri të mundësive për hulumtim të mësimit dhe të mësuarit (Eyler, Giles, Stenson, u Gray, 2001).⁵³

⁴⁹ Cushman, Ellen, 2002, ‘Sustainable Service Learning Programs’, cit., fq. 42, 43.

⁵⁰ Taylor, Pamela G., 2002, ‘Service-Learning as Postmodern Art and Pedagogy’, *Studies in Art Education*, Vol. 43, No. 2, fq. 124 – 140, fq. 134 – 137.

⁵¹ Kuh, G. D., 2008, *High-impact Educational Practices: What They Are, Who Has Access to Them, and Why They Matter*, Washington, DC: Association of American Colleges and Universities as cited in Bringle, Robert and Julie A. Hatcher, *International Learning* in Bringle, Robert, Julie A. Hatcher and Steven G. Jones (Eds.), 2011, *International Service Learning: Conceptual Frameworks and Research. Vol. 1: IUPUI Series on Service Learning Research*, cit., fq. 5.

⁵² Pritchard, Florence Fay and George I. Whitehead, 2004, *Serve and Learn*, Mahwah, New Jersey: Lawrence Erlbaum Associates Publishers, fq. 2 as cited in Levkov, Nikola and Stuart Umpleby, 2009, ‘How Service Learning is Conducted in a School of Business’, *CEA Journal of Economics*, Vol. 4, Issue 2, fq. 25 – 34, fq. 26.

⁵³ Eyler, J. S., Giles, D. E., Jr., Stenson, C. M., and Gray, C. J., 2001, *At a Glance: What We Know about the Effects of Service-Learning on College Students, Faculty, Institutions and Communities, 1993–2000* (3rd Ed.), Nashville, TN: Vanderbilt University as cited in Bringle, Robert and Julie A. Hatcher, *International Learning* in Bringle, Robert, Julie A. Hatcher and Steven G. Jones (Eds.), 2011, *International Service Learning: Conceptual Frameworks and Research. Vol. 1: IUPUI Series on Service Learning Research*, cit., fq. 5.

Gjatë inkuadrimit në projektin e të mësuarit shërbyes, në të vërtetë, të dy palët fitojnë dhe zhvillojnë kompetenca të dobishme jetësore dhe mundësi mes të cilave më të rëndësishmet janë dimensionet e të menduarit kritik të kategorizuara në dy tema kryesore:

- *Zhvillimi i perspektivës profesionale për vete*: elemente, aftësi dhe veçori të menduarit; kujdes për të tjerët dhe shkathtësi komunikimi.
- *Zhvillimi i perspektivës për bashkësinë*: promovimi i mirëqenies dhe vetëdija për ekzistimin e dallimeve të ndërsjella.⁵⁴

Më tej, angazhimi në projekte të mësuarit shërbyes u ndihmon të gjithë palëve të inkuadruar ta ndërtojnë karakterin personal, të zhvillojnë ndjenjë të fuqishme të etikës dhe përgjegjësisë shoqërore, si dhe përkushtim të mendjes.

Sipas Sedlak dhe të tjerë, “Të mësuarit shërbyes, megjithatë, i vë në baraspeshë përfitimet nga të mësuarit shërbyes, si dhe përfitimet nga të mësuarit për studentin. Kjo baraspeshë e veçon të mësuarit shërbyes nga llojet tjera të programeve për shërbim.”⁵⁵ Rezultatet parashikuese të mësuarit shërbyes janë: (a) procesi i zhvillimit profesional të studentëve dhe ligjëruesve dhe (b) aftësi të kontribuohet drejt mirëqenies të bashkësisë dhe shoqërisë.

3) Dallimet mes të mësuarit shërbyes dhe llojeve tjera të mësuarit të bazuar në bashkësi

Pasiqë debati për definicionin e të mësuarit shërbyes vazhdon më tej dhe ka shumë çështje të hapura lidhur me specifikat e tija kryesore, mendojmë se është e rëndësishme t’i kushtohet vëmendje disa tipave të ndryshëm të mësuarit të bazuar në bashkësi deh dallimet e tyre, ndërsa në disa raste edhe karakteristika që përputhen. Nxitja për sqarimin në këtë pjesë nga publikimi del nga dukuria e shpeshtuar kur njerëzit e barazojnë të mësuarit shërbyes me vullnetarizmin, vetëm pse edhe te njëra edhe te tjetra jepen shërbime në bashkësi.

Shumë autorë bëjnë dallim mes të mësuarit shërbyes, vullnetarizmit, ndihmë bashkësisë dhe praktikumit (Furco, 1996; Sigmon, 1994). Furco (1996)⁵⁶ njihet mirë për sqarimin e tij të paletës së gjerë të programeve që bazohen në karakteristikat që vijojnë:

1. **Qëllimi primar;**
2. **Fokusi;**
3. **Shfrytëzues të projektuar (target);** dhe
4. **Shkalla e vënies së theksit në shërbimet dhe/ose të mësuarit.**

Më poshtë, vijon sqarimi i këtyre karakteristikave të mësuarit shërbyes:⁵⁷

⁵⁴ Sedlak, Carol A., Margaret O. Doheny, Nancy Panthofer, and Ella Anaya, 2003, ‘Critical Thinking in Student’s Service-Learning Experiences’, *College Teaching*, Vol. 51, No. 3, fq. 99-103, fq. 99 – 101.

⁵⁵ Ibid, fq. 99.

⁵⁶ Furco, Andrew, 1996, ‘Service Learning: A Balanced Approach to Experiential Education’, *Expanding Boundaries: Serving and Learning*, Vol. 1, Issue 1, Washington DC: Corporation for National Service, fq. 2 – 6. Versions of this article have been published subsequently in: Furco, Andrew, 2011, ‘Service-Learning: A Balanced Approach to Experiential Education’, *The International Journal for Global and Development Education Research*, Issue Zero (Oct. 2011), fq. 71 – 76; Furco, Andrew, *Service Learning: A Balanced Approach to Experiential Education* in Introduction to Service-Learning Toolkit, fq. 9 – 13, Downloaded from: http://www.urmia.org/library/docs/regional/2008_northeast/Service_Learning_Balanced_Approach.pdf.

⁵⁷ Benton-Short, Lisa (Ed.), 2012, *Service-Learning Faculty Handbook*, cit., fq. 8, 9.

1. **Të mësuarit shërbyes është e lidhur formalisht me qëllimet arsimore të lëndës mësimore të cilën e kanë zgjedhur studentët.** Kur janë vullnetarë ose në praktikë, studentët mësojnë shumë, por rezultati i atij rasti konkret në shërbim, në bashkësi, nuk është i drejtuar drejt shkathtësive ose përvojës që do ta fitojnë, gjegjësisht shërbimi nuk është në mënyrë eksplicite i lidhur me qëllimet specifike të lëndës mësimore. “Nga aspekti i asaj se si janë definuar qëllimet dhe si është strukturuar programi mësimor, te të mësuarit shërbyes ekziston strukturë më e madhe e bashkëpunimit. Shkalla deri te dinamika e bashkësisë e ofron strukturën e lëndës mësimore dhe organizatat në bashkësi që të funksionojnë si partnerë integral, bën dallim të qartë nga format tjera të mësuarit me përvojë, siç janë praktikumi ose studimet në terren. Me fjalë të tjera, vlera e të mësuarit shërbyes ndoshta nuk është aq e njëanshme si te vullnetarizmi, e as të mësuarit shërbyes nuk duhet të fokusohet në zhvillimin individual ose teknik, siç është rasti te praktikumi ose studimi në terren.”⁵⁸
2. **Fokusi në të mësuarit shërbyes qëndron në zgjidhjen e nevojave të vërteta të identifikuara të bashkësisë.** Më tej, të mësuarit shërbyes, gjithashtu, mund të fokusohet në zhvillimin e sektorit civil dhe kontributit drejt ndryshimeve të vërteta dhe të përershme shoqërore. Prej këtu, shërbimi i angazhon studentët në aktivitete të rëndësishme, sfiduese dhe relevante.
3. Për dallim nga vullnetarizmi, shërbimi në bashkësi, praktikumi ose përvoja në terren, **të mësuarit shërbyes është njëloj e dobishme, si për ofruesin, ashtu edhe për pranuesin e shërbimit.** Njëkohësisht, të mësuarit shërbyes është mjaft i integruar në programin mësimor të një lënde. Studentët punojnë si në detyra formale, ashtu edhe jo formale. Kuadri mësimor i fakulteteve dhe partnerët nga bashkësia i vlerësojnë studentët në bazë të kualitetit dhe asaj kryesores në të mësuarit shërbyes.
4. Me rëndësi të veçantë për efektivitetin e të mësuarit shërbyes është integrimi i tij në planin mësimor dhe të menduarit për lëndën mësimore. **Studentët me qëllim mendojnë për veten, për shërbimin që e bëjnë dhe për mënyrën në të cilën komunikojnë ata gjatë shërbimit. Ata gjithashtu, me qëllim e hulumtojnë të mësuarit shërbyes, si nga pikëpamja e teorisë, ashtu edhe nga pikëpamja e ofrimit të shërbimit në bashkësi dhe e aplikojnë atë që e kanë mësuar në klasë.**

Sipas Furco, secili nga tipat e lartpërmendur të programit (të mësuarit shërbyes, vullnetarizmi, shërbimi në bashkësi, dhe praktikumi) në mënyrë dinamike zënë pjesë të caktuar në paletë. Kjo do të thotë se ekziston mobilitet në kuadër të çdo lloji të caktuar të programit dhe si përgjatë spektrit të programeve varësisht nga **fokusi i dedikuar** (fokuset) dhe **shfrytëzuesi** (shfrytëzuesit). Me kalimin e kohës, disa nga këto programe mund të ‘lëvizin’ përgjatë spektrit, si dhe ta ndryshojnë raportin mes theksit personal të shërbimit dhe të mësuarit.

Edhe autorë të tjerë janë përpjekur të bëjnë dallim mes llojeve të ndryshme të mësuarit me përvojë ose të mësuarit të bazuar në bashkësi. Këtu radhiten Moony dhe Edwards (2001) të cilët ofrojnë përshkrim më konciz të kriterëve të Marrulo (1998) për kufizimin e tre opsioneve për të mësuar të bazuar në bashkësi të pranishme në Universitetin Xhirxhtaun: kredi për të mësuarit shërbyes, grup projektsh dhe të mësuarit shërbyes intensiv. Kriteret janë:

- Variacione në shërbimin që ofrohet;
- Shkalla e integritetit të aktiviteteve jashtëshkollore në lëndën mësimore dhe
- Nuri i kredive mësimore të fituara me pjesëmarrje.⁵⁹

⁵⁸ Ibid, fq. 9.

⁵⁹ Marrulo, Sam, 1998, ‘Bringin Home Diversity: A Service-Learning Approach to Teaching Race and Ethnic Relations’, *Teaching Sociology*, Vol. 26, fq. 259-275, fq. 264 as cited in Mooney, Linda and Bob Edwards, 2001, ‘Experiential Learning in Sociology: Service Learning and Other Community-Based Learning Initiatives’, cit., fq. 184.

Mooney dhe Edwards shkojnë hap më tutje dhe propozojnë kategorizim më gjithëpërfshirës të iniciativave të ndryshme për të mësuarit në bashkësi (Community-Based Learning [CBL]) dhe komponentët e tyre themelore. Edhe pse kryesisht kategorizimi i këtyre është propozuar për integrimin e iniciativave për të mësuarit të bazuar në bashkësi në mësim nga lënda e Sociologjisë të studimeve deri në diplomim, kjo tipologji lehtë mund të shërbejë si model heuristik, i cili i lehtëson proceset e të menduarit, konceptimin dhe debatin lidhur me atë se cilat elemente dhe aspekte në të vërtetë janë përfshirë në formimin e tyre dhe integrimin e plotë në cilëndo program tjetër mësimor për studime deri në diplomim. Kështu, në formë origjinale, është dhënë hierarkia të cilën ata e propozojnë.⁶⁰

Forma e të mësuarit të bazuar në bashkësi	Aktivitete jashtë shkollore	Vullnetarizmi	Shërbim plotësues	Praktikumi	Të mësuarit shërbyes	Avokimi për të mësuarit shërbyes
Aksion social						X
Të menduarit e strukturuar					X	X
Aplikimi/ fitimi i shkathësive				X	X	X
Kreditë mësimore			X	X	X	X
Shërbimet e dhëna		X	X	X	X	X
Në bashkësi	X	X	X	X	X	X

Lexuesit të cilët janë të interesuar të kuptojnë dika më shumë për aktivizmin, vullnetarizmin dhe të mësuarit shërbyes mund të gjejnë material interesant për lexim në veprat e autorëve Bickford dhe Reynolds (2002).⁶¹

Bazat filozofike dhe pedagogjike të mësuarit shërbyes

Edhe pse termi ‘të mësuarit social’ për herë të parë është krijuar në vitet ’60 të shekullit të kaluar⁶², ndërsa pedagogjia e të mësuarit shërbyes u bë e njohur në SHBA në fillim të viteve 1990, fillimi i të mësuarit shërbyes si pedagogjia dhe praktika mund të përcillen deri në fillim të shekullit njëzet. Disa autorë⁶³ si mjaft të rëndësishme i theksojnë veprat e: filozofëve arsimor John Dewey dhe George Herbert Meade, një nga themeluesit e pragmatizmit amerikan, pastaj, lidhshmëria e tyre me Jane

⁶⁰ Mooney, Linda and Bob Edwards, 2001, ‘Experiential Learning in Sociology: Service Learning and Other Community-Based Learning Initiatives’, cit., fq. 184.

⁶¹ Bickford, Donna M. and Nedra Reynolds, 2002, ‘Activism and Service-Learning: Reframing Volunteerism as Acts of Dissent’, *Pedagogy: Critical Approaches to Teaching Literature, Language, Composition, and Culture*, Vol. 2, No. 2, fq. 229 – 252.

⁶² ‘Të mësuarit shërbyes si shprehje për herë të parë u paraqit nga fundi i viteve ’60 të shekullit të kaluar, në botimet e Këshillit rajonal arsimor jugor, autorë të cilit ishin Robert Sigmon dhe William Ramsay. Në vitin Byroja për mundësi ekonomike e ka themeluar Programin nacional për vullnetarizëm studentor, qllë më vonë u bë Qendra nacionale për të mësuarit shërbyes. Në vitin 1971 ky program dhe dy të tjera – Korpusi paqesor dhe VISTA – u bashkuan dhe e formuan agjencinë federale ACTION’, sipas citatit të Kessinger, Thomas A., *Service Learning* in Hunt, Thomas C., James C. Carper, Thomas J. Lasley II, and C. Daniel Raisch (Eds.), 2010, *Encyclopedia of Educational Reform and Dissent*, Thousand Oaks, CA: SAGE, fq. 814-16, fq. 814, Retrieved from SAGE Reference Online Web, Gelman Library, The George Washington University, Washington DC, on June 20, 2012.

⁶³ Hironimus-Wendt and Lovell-Troy, 1999; Giles and Eyler, 1994; Hatcher, 1997; Saltmarsh, 1996 as cited in Hatcher and Erasmus, 2008; Levkov and Umpleby, 2009; Kessinger, 2012.

Addams dhe Hull House, të njohur për nga përkushtimi i tyre ndaj arsimit pragmatik dhe ndryshimit social, si dhe për punën e C. Wright Mills, studiues i pasionuar i veprave të Dewey dhe Max Weber. Nga të gjithë këta, duket se Dewey dhe Mills janë autorë më të theksuar, qëndrimet e të cilëve për arsimin kanë pasur ndikim themelues mbi lëvizjen për të mësuarit shërbyes.

Gurëthemeli i qasjes së Dewey ndaj pedagogjisë është filozofia e përvojës. Kjo qasje është thellë e inkorporuar në filozofinë sociale dhe e lidh teorinë dhe praktikën, gjegjësisht shkollën dhe bashkësinë. Sipas autorit, të mësuarit është aktiv, e jo përvojë pasive që ndodh përmes interaksionit mes atij që mëson dhe rrethimeve të ndryshme. Ata që mësojnë dhe të cilët janë në pika të ndryshme të zhvillimit intelektual, shoqëror dhe moral, kanë rol aktiv mjaft të rëndësishëm të marrin pjesë në këtë interaksion, në mënyrë krijuese të mendojnë dhe pastaj të mendojnë për aktivitetin në të cilin kanë marrë pjesë. Nga ana tjetër, përgjegjësia e arsimtarit është: ta nxitë interesimin te studentët për të mësuar dhe ta zgjojnë kërkshërinë e tyre; të krijojnë situata ku do të mësohet; t'i vërë 'në test' përvojat potenciale të studentëve; t'i zgjedh ato përvoja të cilat kanë raste më të mëdha të kontribuojnë për procesin e të mësuarit, t'i vlerësojë rezultatet dhe më në fund, të vlerësojë cilat qëndrime janë të volitshme për ritje dhe zhvillim të vazhdueshëm.⁶⁴

Gjithashtu, Dewey, "ka menduar se qëllimi për efektivitetin e bashkësisë kërkon që t'i kushtohet vëmendje faktit se autoriteti duhet të jetë në lidhje me të bërit diçka të dobishme dhe të realitetit se punët të cilat janë të domosdoshme të bëhen, janë punë që përfshijnë lidhshmërinë e dikujt me të tjerët. Më tej, efikasiteti social e përfshinë gjithë atë që e bënë përvoja e një personi më të rëndësishme për të tjerët, si dhe ajo që i mundëson atij të kontribuojë më shumë për përvojat e bashkëkohësve."⁶⁵ Ai në mënyrë të qartë e definon rolin e arsimit në një demokraci dhe sfidën e tij të "gjejë baraspeshë mes tensioneve të qëllimeve sociale dhe zhvillimit individual". Për atë, "sfida është të sigurohet se arsimit kontribuon drejt inteligjencisë sociale, i cili do të sjellë përmirësime në shoqëri, si dhe drejt zhvillimit të individëve të cilët mund të pihen deri në potencialit e tyre të plotë (v.j. maksimal) në mënyra që do të jenë të dobishme për shoqërinë."⁶⁶

Duke pasur parasysh atë se, nevoja nga integrimi i njohurive liberale dhe të dobishme, tashmë është shpallur dhe e definuar si aksion me të cilin shoqëria/mjedisi mund të transformohet, shumë autorë mendojnë se kjo filozofi arsimore është 'pragmatike' në kuptim se bën thirrje për aksion, ku ai që mëson do të mendojë në mënyrë kritike dhe do të zgjidh probleme. Kjo, më në fund, do të sjellë deri te përmirësimi i kushteve sociale.⁶⁷

C. Wright Mills, bashkëkohës i problemeve sociale të imponuara nga industrializimi, nga ngritja e strukturave burokratike, si dhe nga rënia e asociacioneve të vërteta vullnetare, ka menduar se të gjitha shkencat shoqërore duhet të përpiqen të krijojnë një botë më njerëzore, më të shëndoshë dhe më të lirë. Një nga mënyrat për arritjen e një bote të tillë është arsimit ose më mirë thënë, reformat arsimore progresive dhe krijimi i përvojës ideale akademike. Mjedisi ideal arsimor i Mills bazohet në vlerat siç janë e vërteta, mendja dhe liria. Ai duhet të udhëhiqet nga aktivistë-shkencëtarë të cilët do t'i (1) "armatosin studentët me dituri, shkathtësi dhe sensibilitet, të cilat janë të nevojshme për përmirësimin

⁶⁴ Hironimus-Wendt, Robert J. and Larry Lovell-Troy, 1999, 'Grounding Service Learning in Social Theory', *Teaching Sociology*, Vol. 27, No. 4, fq. 360 – 372, fq. 364; Taylor, Pamela G., 2002, 'Service-Learning as Postmodern Art and Pedagogy', *Studies in Art Education*, Vol. 43, No. 2, fq. 124 – 140, fq. 127, 128.

⁶⁵ Kessinger, Thomas A., *Service Learning* in Hunt, Thomas C., James C. Carper, Thomas J. Lasley II, and C. Daniel Raisch (Eds.), 2010, *Encyclopedia of Educational Reform and Dissent*, cit., fq. 814, Retrieved from SAGE Reference Online Web on June 20, 2012.

⁶⁶ Hatcher, Julie A., Mabel A. Erasmus, 2008, 'Service-Learning in the United States and South Africa: A Comparative Analysis Informed by John Dewey and Julius Nyerere', *Michigan Journal of Community Service Learning*, Fall 2008, fq.49-61, fq. 51.

⁶⁷ Hatcher, Julie A., Mabel A. Erasmus, 2008, 'Service-Learning in the United States and South Africa: A Comparative Analysis Informed by John Dewey and Julius Nyerere', cit., fq. 52.

e rrethanave të atyre që vuajnë nga kushtet të cilat vetë nuk i kuptojnë dhe prej këtu, nuk janë në gjendje as t'i ndryshojnë”, dhe në të njëjtën kohë, (2) do ta lehtësojë aftësimin e studentëve.⁶⁸

Të përmbledhim, Dewey dhe Mills formuluan filozofi sociale dhe arsimore sipas të cilave arsimit është konceptuar si përvojë aktive, që i ndërlidh shkollën dhe bashkësinë përmes procesit të ndërlidhur që përfshinë edhe të menduarit e thellë për vetë përvojën dhe inkorporimin e ideve arsimore në kontekstin social. Me shpresë për zgjidhjen e çështjeve sociale, qëllimi i fundit i këtij arsimit ose transformimi të modeleve sociale dhe arsimore është vendosja e bashkësive më humane.

Kritikët e veprës së Dewey dhe Mills pohojnë se ata nuk shkojnë shumë larg nga sqarimi i modelit të ri arsimor dhe se asnjëri prej tyre nuk jep pikëpamje ose propozime për atë se si në të vërtetë të transformohet sistemi arsimor dhe të realizohen reformat e shoqërisë dhe bashkësisë. Kritikët mendojnë se punë të ngjashme dhe për punën e shkencëtarëve tjerë, të cilët edhe pse e mbindërtojnë punën e Dewey dhe Mills dhe pranojnë se përvoja arsimore është me rëndësi qendrore për reformat sociale, megjithatë “harrojnë për premtimin për të mësuarit nga përvoja”. Mes tyre ata emërojnë, disa, siç janë Martha Nussbaum dhe Frank Hearn.⁶⁹

Kolbi prezanton edhe një autor, i cili dha kontribut të rëndësishëm drejt teorisë dhe praktikës nga sfera e të mësuarit shërbyes. Ai është i njohur për ciklet prej katër fazave të mësuarit nga përvoja (ose proces i zhvillimit konjuktiv që zhvillohet në katër faza) i cili përbëhet prej: përvojës konkrete, vëzhgimi i mendimit, konceptualizmi abstrakt dhe eksperimentimi konkret. Teoria e tij për të mësuarit nga përvoja (ELT) që daton nga vitet '80 të shekullit të kaluar kryesisht bazohet në veprat e Lewin (1948), Dewey (1934; 1929) dhe Piaget (1964; 1970). Karakteristikë e përbashkët e teorisë të gjithë autorëve është pikëpamja e tyre e të mësuarit si proces ku konceptet dalin nga përvoja dhe vazhdimisht ndryshojnë me atë. Sipas ELT, “të mësuarit është proces gjithëpërfshirës i aftësimin të njeriut në botë” (Kolb 1984 fq.31). Në këtë kuptim, të mësuarit paraqet proces aktiv, vetë i orientuar dhe i përvetshëm që mund të aplikohet në jetën e përditshme. Kjo ndodh në të gjitha llojet e rrethimit dhe i përfshinë të gjitha fazat e jetës. Të mësuarit përfshinë funksionimin e integruar të menduarit, ndjenjës, perceptimit dhe sjelljes, si dhe komunikimi mes personit dhe mjedisit.”⁷⁰

Taylor (2002) flet rreth idesë së Paulo Freire për arsimin e ko-qëllimshëm (co-intentional) si burim i rëndësishëm i inspirimit për teorinë për të mësuarit shërbyes. Freire mendon se suksesi dhe rëndësia e programeve për të mësuarit shërbyes varen nga inkuadrimi i përkushtuar, si të kuadrin arsimor, ashtu edhe të studentëve. Arsimtari dhe studenti ose nxënësi i cili i ‘shërben’ bashkësisë dhe partnerit nga bashkësia janë bashkë-nxënës dhe bashkëpunëtorë. Ata punojnë bashkë drejt realizimit të qëllimeve të përbashkëta për arritjen e drejtësisë sociale dhe transformimit personal, dhe me këtë, ata formojnë lidhje të fuqishme të reciprocitetit. Ekziston shkëmbim i vazhdueshëm dhe i rëndësishëm mes të gjitha palëve të përfshira dhe të gjithë mësojnë t'i respektojnë vlerat e të gjithë të tjerëve, nevojat dhe pritjet e tyre.⁷¹

Dhe, në fund, në këtë pjesë të publikimit kushtuar bazave filozofike dhe pedagogjike të mësuarit shërbyes do të kishim dashur ta prezantojmë modelin e Ernest Boyer (1990) pse komentimin e arsimimit. Boyer është i njohur rreth asaj se i ka nxitur “institucionet arsimore sipërore ta vërtetojnë të kuptuarit e punës akademike që ekziston vite të tëra dhe ta zgjerojnë që të përfshijë, krahas arsimimit të bazuar në zbulim dhe arsimimit të bazuar në integrim, aplikim dhe mësim.”⁷² Autorët Buchanan,

⁶⁸ Hironimus-Wendt, Robert J. and Larry Lovell-Troy, 1999, ‘Grounding Service Learning in Social Theory’, *cit.*, fq. 365

⁶⁹ Ibid, fq. 366.

⁷⁰ Jia, Yunyan, 2004, *Students' Learning Styles and Their Correlation with Academic Performance in Architectural Design Studio*, Dissertation, The HKU Scholars Hub, The University of Hong Kong, fq. 6, Retrieved on June 23, 2012 from <http://hdl.handle.net/10722/31928>.

⁷¹ Taylor, Pamela G., 2002, ‘Service-Learning as Postmodern Art and Pedagogy’, *Studies in Art Education*, Vol. 43, No. 2, fq. 124 – 140, fq. 128.

⁷² Buchanan, Alice M., Shelia C. Baldwin, and Mary E. Rudisill, 2002, ‘Service Learning as Scholarship in Teacher Education’, *Educational Researcher*, Vol. 31, No. 8, fq. 30 – 36, fq. 30.

Baldwin dhe Rudisill (2002) diskutojnë se si këto forma të arsimit kanë të bëjnë me misionin dhe praktikën e evoluimit të institucioneve arsimore sipërore dhe i ndërlidhin me ndikimin që përvojnë e të mësuarit shërbyes i kanë mbi promovimin e etikës të shërbimit dhe përgjegjësisë shoqërore.

Histori e shkurtër e të mësuarit shërbyes në SHBA

Krijimi formal i programeve shërbyese ka filluar në vitet e tridhjeta të shekullit të kaluar. Në gjysmën e dytë të viteve të gjashtëdhjeta dhe shtatëdhjeta të shekullit të kaluar të mësuarit shërbyes u vendos në një numër të madh të kampeve universitare në SHBA. Duke filluar nga mesi i viteve të tetëdhjeta nga shekulli i kaluar të mësuarit shërbyes fiton popullarizim më të madh, që e përjeton kulmin e tij me formimin e Campus Compact ose të Projektit për shërbime publike dhe komunale (Project for Public and Community Service). Në vitet e nëntëdhjeta nga shekulli i kaluar liderët nacional dhe lokal fillojnë me promovimin e shërbimeve vullnetare në SHBA. E gjithë kjo në vijë me zhvillimin e të mësuarit shërbyes dhe me ndryshimet të cilat ndodhin në kontekstin social, politik dhe ekonomik të arsimit sipëror në SHBA. Në vitin 1990 Xhorxh Bush e ka nënshkruar National Community Service Act, ndërsa në vitin 1994 Kryetari Klinton ka propozuar miratimin e ligjit me të cilin do të zgjeroheshin mundësitë për shërbim në bashkësi dhe fitimin e shpërblimeve për arsim. Ky është fillimi i AmeriCorps, më mirë të njohur si National Corporation for National Service.

Në shtojcë është historiku i zhvillimit të mësuarit shërbyes të përgatitur nga ana National Service-Learning Clearinghouse.⁷³

Tabela 4 *Historia e zhvillimit të mësuarit shërbyes në SHBA*

1903 —	Lëvizja për arsim korporativ në Universitetin në Sinsinati
Rreth	William James dhe John Dewey i prezantojnë bazat intelektuale të mësuarit shërbyes
1905 —	
1910 —	Filozofi amerikan William James shkruan për shërbimin jo – militarist nacional në esenë e tij “The Moral Equivalent of War”
Rreth	Disa shkolla folklorike në Appalachia bëhen kolegje dyvjeçar dhe katërvjeçar, të cilët
1915 —	në programin e tyre mësimor e ndërlidhin konceptin e punës, shërbimit dhe mësimin
1933-	Përmes Civilian Conservation Corps (CCC), të themeluar nga ana e Franklin D.
1942 —	Roosevelt, milionë të rinj kalojnë në shërbim prej 6 deri 18 muaj, me qëllim që t’i restaurojnë parqet nacionale, ta revitalizojnë ekonominë nacionale dhe me qëllim që t’i ushqejnë familjet e tyre dhe veten
1935 —	U themelua Work Projects Administration (puna publike për njerëzit që kërkojnë punë)
1944 —	GI Bill e lidh shërbimin me të mësuarit përmes ofertës, amerikanëve për mundësitë për arsim nëse shërbejnë në vendin e tyre
1960s —	Zhvillohen tre programe të cilat i përfshijnë amerikanët më të moshuar në shërbim të kombit: Retired and Senior Volunteer Program (RSVP), Foster Grandparent Program, dhe Senior Companion Program
1961 —	Kryetari Kenedi i themelon Peace Corps, përmes legjislacionit të miratuar nga ana e Kongresit më 22 shtator, 1961
1964 —	Kryetari Lindon Xhonsn i themelon VISTA (Volunteers in Service to America), National Teacher Corps, Job Corps, dhe University Year of Action, si pjesë e “War on Poverty”. VISTA u mundëson amerikanëve të shërbejnë me orar të plotë me qëllim që t’u ndihmojnë mijëra familjeve me të ardhura të ulëta
1965 —	Krijohen programet për punë-të mësuar në kolegjet amerikane
1966 —	Përmes financimit federal themelohen Urban Corps
1966-	Shprehja “të mësuarit shërbyes” përdoret që të përshkruhet projekti i financuar nga
1967 —	TVA në East Tennessee with Oak Ridge Associated Universities, i cili i lidh studentët dhe kuadrin akademik me organizata qëllimi kryesor i të cilëve është zhvillimi
1968 —	Konferenca për shërbim nacional të organizuar nga ana e Sekretariatit për shërbim

⁷³ http://www.servicelearning.org/what_is_service-learning/history

- nacional në Uashington
- 1969 — Konferenca për të mësuarit shërbyes mbahet në Atlantë (sponsorë janë Southern Regional Education Board, U.S. Dept. HEW, City of Atlanta, Atlanta Urban Corps, Peace Corps, dhe VISTA)
- 1970 — Youth Conservation Corps përfshinë 38,000 njerëz të moshës prej 14 deri 18 vjet të cilët marrin pjesë në programet verore për ambient jetësor
- 1971 — Mbahet konferenca për të rinjtë të organizuar nga Shtëpia e Bardhë ku bëhet thirrje për lidhjen e shërbimit me të mësuarit. Gjithashtu themelohet Qendra Nacionale për praktikë në fushën e shërbimit publik, si dhe Shoqata për të ashtuquajturin Field Experience Education (këto dy institucione bashkohen në vitin 1978 në një Shoqatë nacionale për praktikë dhe arsimim nga përvoja)
- Rreth
1971 — Formohet Programi vullnetar studentor nacional (në vitin 1979 bëhet Qendra nacionale për të mësuarit shërbyes). Kjo Qendër e boton Synergist, gazetë e cila e promovon lidhjen e shërbimit me të mësuarit
- 1976 — Guvernatori i Kalifornisë Xheri Braun e themelon California Conservation Corps, institucioni i parë rinor jo federal në nivel shtetëror
- 1978 — Young Adult Conservation Corps krijon degë të saja në çdo shtet me 22,500 anëtarë të moshës prej 16 deri 23
- 1979 — “Three Principles of Service-Learning” botohet në Synergist
- 1980 — Përpjekjet nacionale janë fokusuar në të ashtuquajturin nivel grassroot dhe përshijnë iniciativa si Campus Outreach Opportunity League (1984) dhe Campus Compact (1985), përmes të cilëve vjen deri te mobilizimi i programeve shërbyese në arsimin sipëror. Vjen deri te krijimi i National Association of Service and Conservation Corps (1985), që ndihmon në krijimin e organizatave rinore në nivel shtetëror dhe lokal; Krijohet National Youth Leadership Council (1982), që ndihmon në përgatitjen e liderëve për të ardhmen; dhe krijohet Youth Service America (1985), përmes së cilës një numër i madh i të rinjve vihen në shërbim
- 1981 — Themelohet Qendra nacionale për të mësuarit shërbyes të adoleshentëve të hershëm
- 1989 — Si rezultat i bashkëpunimit mes më shumë se shtatëdhjetë organizatave janë shkruar Wingspread Principles of Good Practice in Service-Learning
- 1989-
1990 — Kryetari Bush e krijon Zyrën për shërbim nacional në Shtëpinë e Bardhë dhe Points of Light Foundation që ta nxisë vullnetarizmin
- 1990 — Kongresi e miraton, ndërsa kryetari Bush e nënshkruan National and Community Service Act of 1990. Ky ligj bën autorizimin e dhënies së granteve shkollave, me qëllim që të jepet mbështetje për të mësuarit shërbyes, si dhe për dhënien e granteve demonstrative për programet shërbyese nacionale për organizatat rinore, organizatave jofitimprurëse, kolegjeve dhe universiteteve. Themelohet Learn and Serve America (e njohur si Serve-America). Ky ligj gjithashtu e parasheh themelimi e National Service-Learning Clearinghouse
- 1992 — Këshilli shtetëror për arsim i Merilendit e miraton ligjin për shërbim të obliguar, i cili hyn në fuqi në vitin 1993, ndërsa aplikohet nga të gjithë ata që kanë diplomuar nga viti 1997
- 1993 — Asociacioni për supervizion dhe zhvillim të programeve mësimore e thekson rëndësinë e lidhjes mes të mësuarit dhe shërbimit
- Shtator
1993 — Kryetari Klinton e nënshkruan National and Community Service Trust Act of 1993, me çka i formon AmeriCorps dhe Corporation for National Service. Ky ligj i bashkon këto institucione në një agjenci të pavarur federale: Senior Corps, AmeriCorps, VISTA dhe Learn and Serve America
- 1994 — Kongresi e miraton King Holiday and Service Act of 1994, me të cilin e autorizon Korporatën për shërbim nacional ta organizojë ditën e Martin Luther King Day, si ditë të shërbimit. Vitin e njëjtë vjen deri te formimi i Stanford Service-Learning Institute. Gjithashtu, projekti që vijon fillon me realizim: Ford Foundation/United Negro College Fund Community Service Partnership Project (a 10-college program linking direct service and learning)
- 1995 — Rrjeti për të mësuarit shërbyes bëhet i kapshëm në internet përmes University of Colorado Peace Studies Center
- Prill
1997 — Samiti i kryetarëve për të ardhmen e Amerikës (Presidents' Summit for America's Future) me të cilin kryeson gjenerali Colin Powell, i bashkon kryetarin Klinton,

- bashkë me ish kryetarët Bush, Ford, Karter dhe znj. Regan, që të gjithë këta të angazhohen për zgjerimin e rolit të AmeriCorps dhe programeve tjera shërbyese, të cilat janë fokusuar në nevojat e rinisë amerikane
- 1997 — Botohet Fourth of July Declaration on the Civic Responsibility of Higher Education. Gjithashtu, botohet Wingspread Declaration Renewing the Civic Mission of the American University
- 2001 — Organizohet konferenca e parë për hulumtim në sferën e të mësuarit shërbyes. Gjithashtu organizohet Wingspread conference on student civic engagement
- 2002 — Vjen deri te formimi i USA Freedom Corps, si këshillë koordinuese dhe zyra e Shtëpisë së Bardhë me qëllim të nxitjes së amerikanëve t'i përgjigjen thirrjes së Kryetarit Bush të ndihmojnë me pjesëmarrje sa më të madhe në shërbim
- 2003 — Kryetari Bush e krijon President's Council on Service and Civic Participation, me qëllim që ta nxisë vullnetarizmin në SHBA. Ky Këshill e formon President's Volunteer Service Award me qëllim që t'i shpërblejë amerikanët të cilët angazhohen për vullnetarizëm

Efekte nga të mësuarit shërbyes

Gjatë dy dekadave të kaluara, teoria dhe praktika në fushën e të mësuarit shërbyes vërehet vrull i madh i hulumtimeve dhe dëshmi empirike për përfitimin nga të mësuarit shërbyes dhe nga integrimi i tij në planet mësimore. Mes studimeve më shpesh të cituara për ndikimin e të mësuarit shërbyes mbi studentët, kuadrin mësimor të fakulteteve, institucionet arsimore sipërore dhe bashkësinë theksohen ato të: Astin, Sax dhe Avalos (1999), Batchelder dhe Root (1994), Eyler, Giles dhe Braxton (1997), Eyler dhe Giles (1999), Hesser (1995), Rhoads (1997), Sax, Astin dhe Astin (1996)⁷⁴, Howard dhe King (1993), Kendrick (1996)⁷⁵, Eyler, Giles, Stenson dhe Gray (2001), Astin, Vogelgesang, Ikeda dhe Yee (2000), Brzozowski, Homenda dhe Roy (2012) etj. Me ndihmën e këtyre studimeve, me sukses sqarohet pjesa më e madhe e 'mekanizmit' për arritjen e shërbimit efikas drejt bashkësisë gjatë studimeve deri në diplomim. Por, edhe më tej mbeten të hapura shumë çështje lidhur me atë cilat forma konkrete, gjegjësisht cilat qasje drejt të mësuarit shërbyes janë më efektive.

Në këtë pjesë të publikimit do t'i prezantojmë gjetjet nga disa studime të ndryshme: 1) kush është marrë me efektet krahasuese nga të mësuarit shërbyes dhe nga shërbimi drejt bashkësisë mbi zhvillimin konjuktiv dhe afektiv të studentëve, kuadrin mësimor, institucioneve të arsimit sipëror dhe në përgjithësi, bashkësitë dhe 2) qëllimi i të cilit ka qenë të fitojnë njohuri më të mira për atë se si mund të avancohet bashkësia përmes ofrimit të shërbimeve. Shpresojmë se pasiqë në këtë mënyrë do t'u ofrohen dëshmi të mjaftueshme për vlerën arsimore të mësuarit shërbyes, arsimtarët dhe profesorët jo vetëm që do të kuptojnë në cilën mënyrë zhvillohet të mësuarit shërbyes, por edhe do të bëhen luftëtarë të denjë për integrimin e tij në planet mësimore.

Në të vërtetë, ajo që vijon, kryesisht bazohet edhe në masë të caktuar paraqet 1) version të shkurtuar të gjetjeve që e kanë zbatuar Astin, Vogelgesang, Ikeda dhe Yee në vitin 2000⁷⁶ dhe 2) pasqyrë mirë e

⁷⁴ Cituar sipas Vogelgesang, Lori J. and Alexander W. Astin, 2000, 'Comparing the Effects of Community Service and Service-Learning', *Michigan Journal of Community Service Learning*, Vol. 7, Issue Fall 2000, fq. 25 – 34, fq. 25.

⁷⁵ Cituar sipas:

1) Seider, Scott C., Samantha A. Rabinowicz, and Susan C. Gillmor, 2011, 'The Impact of Philosophy and Theology Service-Learning Experiences upon the Public Service Motivation of Participating College Students', *The Journal of Higher Education*, Vol. 82, No. 5, fq. 597 – 628, fq. 600. Gjetet në: http://people.bu.edu/seider/Consolidated%20papers/Public%20Service%20Motivation%20Paper%20Final%20Proofs_Seider%20et%20al.pdf;

2) Strage, Amy, 2004, 'Long-term Academic Benefits of Service-Learning: When and Where Do They Manifest Themselves', *College Student Journal*, Vol. 38, Issue 2. E shkarkuar më 2 qershor 2012 në HTML formatin nga baza e të dhënave Academic Search Complete pranë bibliotekës Gelman Library.

⁷⁶ Astin, Alexander W., Lori J. Vogelgesang, Elaine K. Ikeda, and Jennifer A. Yee, 2000, *How Service Learning Affects Students*, Los Angeles, CA: Higher Education Research Institute, University of California, Los Angeles.

sistematizuar të më shumë studimeve të zbatuara në të kaluarën të bërë nga Eyler, Giles, Stenson dhe Gray (e botuar më 2001).⁷⁷ Para se të kalojmë në përmbledhjen e rezultateve më të rëndësishme nga këto studime, do të kishim dashur të kushtojmë vëmendje një modeli mirë të njohur konceptual për ndikimin e të mësuarit shërbyes mbi përfitimet akademike dhe sociale, autorë të cilët janë Furco, Jones-White, Huesman Jr., dhe Gorny (2010).⁷⁸ Modeli është rezultat i një studimi me të cilin përpiket të kuptohet roli i involvimit të studentëve në të mësuarit shërbyes dhe ko-relacioni i tij me përfitimet e dëshiruara akademike dhe sociale në suaza të kornizës teorike 'Input- Rrethimi-Autput' që e ka zhvilluar Astin (1984). Ashtu si në një rast kanë thënë edhe vetë autorët e këtij modeli, qëllimi primar i hulumtimit ka qenë "të jepet përgjigje në pyetjen si në të vërtetë të mësuarit shërbyes ndikon mbi sjelljen pro-sociale ku marrin pjesë interaksionet e ndryshme, bisedat kritike, zgjidhja e problemeve dhe analiza kritike, si dhe të jepet përgjigje për atë se si këto përvoja dhe forma të lehtësimit janë lidhur me rezultatet e dëshiruara nga procesi arsimor, siç janë për shembull, fitimi i shkathtësive të reja akademike të kompetencave nga fusha e kulturës."⁷⁹

Duke u fokusuar, para së gjithash, në efektet e të mësuarit shërbyes te studentët, Astin, Vogelgesang, Ikeda dhe Yee (2000) kanë realizuar "studim kuantitativ longitudinal në ekzemplar nacional të përbërë prej studentëve të kolegjeve dhe universiteteve të ndryshme dhe studim kualitativ të studentëve dhe kuadrit mësimor universitar, të cilët kanë qenë të përfshirë në të mësuarit shërbyes si segment nga këto institucione... Ndikimi i të mësuarit shërbyes dhe shërbimi në bashkësi është vlerësuar nga aspekti i 11 variabileve të ndryshe të varura: rezultatet akademike (tre variabile), vlerat (dy variabile), vetë-efikasiteti, lidhshipi (tre variabile), planet për zhvillim të karrierës dhe planet e studentëve në vit të parë që të vazhdojnë me studimet."⁸⁰

Nga ana tjetër, hulumtimi i të mësuarit shërbyes në arsimin sipëror që në vitin 2001 e kanë zbatuar Eyler, Giles, Stenson dhe Gray, nuk paraqet hulumtim origjinal në kuptimin e vërtetë të fjalës. Kjo, në të vërtetë paraqet përmbledhje të rezultateve dhe gjetjeve nga më shumë studime të ndryshme, ku janë përmbajtur edhe njësitë bibliografike dhe kanë të bëjnë me periudhën 1993 – 2000. Sipas autorëve, "qëllimi është të jepet pasqyrë e qartë e arritjeve praktike dhe literaturës në këtë fushë".⁸¹

Rezymeja përfundimtare gjendet në: <http://heri.ucla.edu/pdfs/rhowas.pdf>. Shkarkuar më 16 qershor 2012 nga biblioteka Gelman.

⁷⁷ Eyler, Janet, Dwight E. Giles, Jr., Christine M. Stenson, and Charlene J. Gray, 2001, *At a Glance: What We Know about the Effects of Service-Learning on College Students, Faculty, Institutions and Communities, 1993 – 2000*, Third Edition, Vanderbilt University. Gjendet në:

<http://www.compact.org/wp-content/uploads/resources/downloads/aag.pdf>.

⁷⁸ Furco, Andrew, Daniel Jones-White, Ronald Huesman, Jr., and Laura Gorny, 2010, *Developing a Model of the Influence of Service-Learning on Academic and Social Gains with the SERU Survey*, University of Minnesota, E shkarkuar nga: http://www.oir.umn.edu/static/papers/SERU_2012/SERU_Brief_MINNESOTA_Spring12.pdf më 4 korrik 2012.

⁷⁹ Ibid, fq. 5.

⁸⁰ Astin, Alexander W., Lori J. Vogelgesang, Elaine K. Ikeda, and Jennifer A. Yee, 2000, *How Service Learning Affects Students*, cit., fq. i.

⁸¹ Eyler, Janet, Dwight E. Giles, Jr., Christine M. Stenson, and Charlene J. Gray, 2001, *At a Glance: What We Know about the Effects of Service-Learning on College Students, Faculty, Institutions and Communities, 1993 – 2000*, Third Edition, cit., fq. Cover page.

1) Efektet e të mësuarit shërbyes te studentët

Mënyrat në të cilat të mësuarit shërbyes ndikon mbi studentët mund të karakterizohet si ndikim pozitiv mbi:⁸²

1. Rezultatet personale nga të mësuarit shërbyes

- Zhvillimi personal i studentëve (ndërtimi i ndjenjës për efikasitet personal, identitet personal, rritje shpirtërore dhe zhvillim moral);
- Zhvillimi i ndërsjellë i studentëve;
- Aftësi, të bashkëpunohet mirë me të tjerët, lidhshipi dhe aftësitë komunikuese etj.

2. Rezultatet sociale nga të mësuarit shërbyes

- Mënjanimi i stereotipave dhe nxitja e mirëkuptimit kulturor dhe racor;
- Subversioni (përpjekje që të transformohet rregullimi i vendosur shoqëror dhe strukturat e tija të fuqisë, autoritetit dhe hierarkisë), mbështetje qëllimeve të lëndëve për uljen e të menduarit stereotip dhe nxitja e mirëkuptimit kulturor dhe racor;
- Ndjenja për përgjegjësi shoqërore dhe kualiteti i qytetarëve të mirë;
- Përkushtim që t'i shërbehet bashkësisë;
- Involvimi në shërbimin e bashkësisë pas përfundimit të studimeve etj.

3. Rezultatet nga procesi i të mësuarit

- Rezultatet nga studimet që i arrijnë studentët;
- Aftësi e studentëve që ta aplikojnë atë që e kanë mësuar në botën reale;
- Rezultate akademike siç janë: kompleksja shfaqur gjatë mirëkuptimit, analiza e problemeve, të menduarit kritik dhe zhvillimi konjektiv etj.

4. Zhvillimi i karrierës

5. Raportet me institucionin

- Raporte të forcuara me kuadrin mësimor të fakultetit në krahasim me studentët tjerë të cilët janë të përfshirë në të mësuarit shërbyes;
- Shkalla e kënaqësisë së studentëve nga vetë kolegji (fakultet);
- Raste më të mëdha që të diplomohet etj.

Eyler, Giles, Stenson dhe Gray (2001) gjithashtu japin edhe pasqyrë të studentëve të cilët në masë të caktuar ose tërësisht në kundërshtim me disa studime, tregojnë se në përgjithësi, shërbimi ndaj bashkësisë ose më konkretisht, të mësuarit shërbyes kanë ndikim të dykuptimtë (të paqartë, të përzier – edhe pozitive dhe negative) mbi:

- Procesi i të mësuarit i matur përmes vlerësimeve për lëndët ose përqindja nga studimet dhe
- Zhvillimi konjektiv dhe moral i studentëve.⁸³

Më tej, akoma, në fushën e ndikimit të mësuarit shërbyes mbi studentët, këta autorë tregojnë dëshmi të padyshimta për ndikimin e karakteristikave të programeve të caktuara për të mësuarit shërbyes mbi studentët. Bëhet fjalë për karakteristikat që vijojnë:

- Cilësia e vendit të punës ku studenti do të caktohet që të kryejë shërbim në bashkësi;
- Të menduarit;
- Aplikimi i shërbimit mbi përmbajtjet mësimore të cilat studiohen;

⁸² Sipas ibid, fq. 1 – 5.

⁸³ Ibid, fq. 3, 4.

- Kohëzgjatja dhe intensiteti i shërbimit;
- Ekspozimi i diversifikimit;
- Zëri në bashkësi dhe
- Mbrehje kthyes.⁸⁴

Berman (2006) propozon një klasifikim pak më ndryshe të dobive ndaj studentëve i tërheqin nga të mësuarit shërbyes. Ua prezantojmë klasifikimin në formë në të cilën është cituar në shkrimin e Levkov dhe Umpleby nga viti 2009.⁸⁵ Do të thotë, studentët tërheqin dobi nga të mësuarit shërbyes, të cilat shihen në arritjet në fushat që vijojnë:

1. Të mësuarit të përmbajtjeve të reja

- Të mësuarit në kontekst të dhënë;
- Të mësuarit e avancuar (më të gjerë dhe më të thellë);
- Të mësuarit sipas të cilit njohuria e re zgjat, gjegjësisht mbahet më gjatë;
- Transferimi i të mësuarit në situata të reja.

2. Zhvillimi personal

- Perceptime për veten si ofrues të shërbimit/kryes i shërbimit;
- Gatishmëria e madhe që të ndërmerren rreziqe;
- Hapje ndaj personave dhe përvojave të reja;
- Aftësi lideri, komunikuese dhe aftësi për punë në ekip;
- Ekspozim dhe pranimi i grupeve të ndryshme shoqërore;
- Zhvillimi vetë-kontrollit;
- Shkallë më e lartë e eupatisë – më pak qëndrim dënues ndaj të tjerëve.

3. Shkathtësi konjunktive

- Të kuptuarit më të thellë për konceptet;
- Transferimi i avancuar i të mësuarit;
- Shprehja e lirë e mendimeve pranë grupeve në punë ('stuhi e ideve');
- Zgjdhja e problemeve.

4. Lidhja me dhe në kuadër të bashkësisë

- Vetëdija për problemet me të cilat ballafaqohet bashkësia;
- Vetëdija për organizatën të cilës i ofrohet shërbim në bashkësi;
- Përgjegjësi më e madhe qytetare.

5. Shkathtësi të cilat në përgjithësi janë të domosdoshme në jetë

- Njohuri për atë se kur do të kërkohet ndihmë;
- Njohuri kur duhet të ofrohet ndihmë;
- Njohuri ku duhet të kërkohet dhe të gjendet ndihmë;
- Përfundimi i punës që tashmë e keni filluar;
- Përcjellja e rregullave dhe udhëzimeve;
- Rritja e sigurisë personale, siguria;
- Vetë evoluimi;
- Aftësi që me durim të pritët të fitohet/arrihet ajo që me të vërtetë dëshirohet;
- Komunikim i qartë dhe i saktë.

⁸⁴ Ibid, fq. 6, 7.

⁸⁵ Sipas Berman, Sally, 2006, *Service-Learning – A Guide to Planning, Implementing, and Assessing Student Projects*, Corwin Press, fq. xxviii cituar në Levkov, Nikola and Stuart Umpleby, 2009, 'How Service Learning is Conducted in a School of Business', cit., fq. 32, 33.

Pas përfundimit të studimit kuantitativ linguistik, Astin, Vogelgesang, Ikeda dhe Yee (2000) kanë ardhur deri te përfundimi se pjesëmarrja në shërbim të bashkësisë ka efekte të rëndësishme pozitive mbi masat që vijnë të rezultateve të arritura:

- **Rezultatet akademike (rezultate nga studimi)**
 - Mesatarja;
 - Shkathësitë për të shkruar;
 - Aftësi për të menduarit kritik.
- **Vlerat**
 - Përkushtim për aktivizëm;
 - Përkushtim që të promovohet mirëkuptimi i ndër racor.
- **Efikasiteti personal**
- **Lidershipi**
 - Aktivitete të liderit;
 - Aftësi të liderit lidhur me vetveten;
 - Shkathësi për vendosjen dhe mbajtjen e marrëdhënieve ndër njerëzore.
- **Zgjedhja e profesionit me të cilin i shërbehet bashkësisë**
- **Planet që t'i shërbehet bashkësisë dhe pas përfundimit të studimeve**

Pjesa kualitative nga studimi i Astin, Vogelgesang, Ikeda dhe Yee “merret me analizë të thellë të rasteve të mësuarit shërbyes, të cilat janë realizuar në tre kampe të ndryshme. Në secilën prej tre lokacioneve janë zbatuar intervista individuale ose grupe me kuadrin mësimor dhe studentët.” Rezultatet nga studimi flasin për atë se, mes tjerash, “të mësuarit shërbyes është efektiv për shkak se mundëson që të arrihen tipat që vijnë të rezultateve: pjesëmarrje e rritur për efikasitet personal, vetëdije e ngritur për vlerat personale dhe angazhim i rritur në mësim. Gjetjet kualitative tregojnë se edhe kuadri mësimor dhe studentët zhvillojnë një ndjenjë të fuqishme të theksuar për përgjegjësinë qytetare dhe efektivitetin personal përmes pjesëmarrjes në të mësuarit shërbyes.”⁸⁶

2) Ndikimi i të mësuarit shërbyes mbi kuadrin mësimor në fakultete

Kur të mësuarit shërbyes formalisht është inkorporuar edhe në lëndët që mësohen në fakultet, atëherë gjithashtu ofron mundësi dhe është i dobishëm edhe për kuadrin mësimor, mes tjerave si më të rëndësishme theksohen:

- Përvoja nga ‘kultivimi’ dhe nxitja e studentëve që t’i ndajnë përvojat e tyre përmes të shkruarit profesional dhe prezantimeve të bazuara në planet mësimore dhe/ose programit mësimor që i plotëson kriteret/ kërkesat e këshillave institucionale për kontroll dhe vlerësim të hulumtimeve;⁸⁷

⁸⁶ Astin, Alexander W., Lori J. Vogelgesang, Elaine K. Ikeda, and Jennifer A. Yee, 2000, *How Service Learning Affects Students*, cit., fq. ii, iv.

⁸⁷ Këshilli institucional për kontroll dhe vlerësim të hulumtimeve (Intitutional Review Boars [IRB]) ose i njohur edhe si Komitet i pavarur për etikë, paraqet komitetin, i cili është caktuar formalisht që t’i miratojë, përcjellë dhe kontrollojë/shqyrtojë hulumtimet bio-mjekësore dhe hulumtimet që kanë të bëjnë me sjelljen ku janë përfshirë qeniet njerëzore. Shumë shpesh, yk këshill bën analiza të rreziqeve dhe përfitimeve në përpjekje të caktojë nëse me të vërtetë duhet të zbatohet hulumtimi ose jo. Ai është përgjegjës për përcjellje kritike dhe mbikëqyrje mbi hulumtimet dhe kontrollimet të cilat bëhen mbi qeniet njerëzore nga pikëpamja shkencore, etike dhe rregulluese. Përveç kësaj, këshilli institucional për kontroll duhet ta miratojë hulumtimin e propozuar ku janë përfshirë

- Kënaqësi nga kualiteti i procesit të mësuarit te studentët, të cilin e konstatojnë vetë profesorët në fakultete;
- Zhvillimi i qasjes së re, promovuese drejt mbajtjes së mësimit, i cili ka të bëjë me interaksionin më të madh të studentëve me materialin që mësohet;
- Ndenja se jeni pjesë nga krijimi i trajektoreve të reja të kuptimit shkencor dhe pedagogjik dhe veprimtarisë botuese;
- Përkushtim më i fuqishëm i punës hulumtuese që e vërtetojnë edhe vetë anëtarët e kuadrit mësues në fakultete;
- Ndjenja se ‘pllakëzohet’ një shteg i ri zhvillimor për marrëdhëniet mes organizatës dhe kuadrit mësues në fakultet;
- Marrja e mirënjohjes për kontributet që janë bërë në funksion të rritjes së studentëve të regjistruar dhe studentëve të cilët vazhdojnë me studimet pas përfundimit të vitit të parë akademik, për çka kanë ndjerë entuziazëm të madh dhe janë më të angazhuar në punën rreth lëndëve mësimore;
- Zhvillimi i marrëdhënieve të reja profesionale me partnerët nga bashkësia më e gjerë – mundësi për lidhjen dhe rrjetëzimin me kolegë nga disiplina të ndryshme mes procesit hulumtues, praktikave dhe profesioneve;
- Forcimi i lidhjes mes procesit hulumtues dhe arsimor;
- Mundësi që të angazhohen në mënyrë më aktive dhe të posedohet me njohuri, të jenë kompetent lidhur me çështjet e bashkësisë;
- Ndjenja e kënaqësisë dhe përfitimeve nga angazhimi në një lloj të ri të raporteve mentorike, të cilat janë shoqëruar me entuziazëm nga të dy palët;
- Fitimi ose avancimi i ekspertizës, njohuria për dukuritë në rrjedhë dhe relevante, ndodhive dhe aftësive komunikuese;
- Ndryshim i thellë i modeleve mentale të atyre që i edukojnë studentët ose të perceptimeve lidhur me vetë procesin e të mësuarit, si dhe për rolin e tyre si persona të cilët ofrojnë njohuri dhe mundësojnë proces të mësuarit në raste kur mësimi, gjegjësisht ligjëratat nuk janë modeli primar i ndarjes së mendimeve dhe qëndrimeve etj.⁸⁸

Sipas Eyler, Giles, Stenson dhe Gray (2001), qëndrimi që mbisundon te profesorët, të cilët e aplikojnë të mësuarit shërbyes, është se janë të kënaqur nga kualiteti i procesit të mësuarit te studentët dhe nga përkushtimi i tyre për hulumtim. Në kushte kur vërejmë trend rritës të integritit të mësuarit shërbyes në lëndët mësimore, konstatohet vetëdije e përgjithshme e përhapur mes kuadrit mësues se pengesat më të mëdha në procesin e propozimit të formave të mësuarit shërbyes në procesin arsimor, si dhe vetë formimi i partneritetit për aplikim të mësuarit shërbyes në institucione të caktuar arsimor, kufizohen në:

- Mungesë të resurseve dhe mungesë e shpërblimeve për kuadrin mësues si nxitje që të inkuadrohen në projekte të mësuarit shërbyes;⁸⁹
- Mos pasja e vullnetit ose përkushtim të ulët për ndërmarrjen e rreziqeve dhe të mësuarit të vazhdueshëm;

subjektet njerëzore para hulumtimit dhe para se të fillojë i njëjti. Në SHBA këshilla më të njohur institucionale për kontroll dhe vlerësim të hulumtimeve janë ato pranë Food and Drug Administration (FDA) dhe Department of Health and Human Services (më konkretisht, Office for Human Research Protections).

⁸⁸ Brzozowski, Bonnie, Nicholas Homenda, and Loriene Roy, 2012, ‘The Value of Service Learning Projects in Preparing LIS Students for Public Services Careers in Public Libraries’, *The Reference Librarian*, Vol. 53, fq. 24 – 40, fq. 35, 36, e marrë nga biblioteka Gelman Library më 16 qershor, 2012; Community Service-Learning Center, University of Minnesota, *Benefits of Service-Learning*, e shkarkuar më 4 korrik 2012 nga: <http://www.servicelearning.umn.edu/info/benefits.html>; Eyler, Janet, Dwight E. Giles, Jr., Christine M. Stenson, and Charlene J. Gray, 2001, *At a Glance: What We Know about the Effects of Service-Learning on College Students, Faculty, Institutions and Communities, 1993 – 2000*, Third Edition, cit, fq. 8.

⁸⁹ Eyler, Janet, Dwight E. Giles, Jr., Christine M. Stenson, and Charlene J. Gray, 2001, *At a Glance: What We Know about the Effects of Service-Learning on College Students, Faculty, Institutions and Communities, 1993 – 2000*, Third Edition, cit, fq. 8.

- Domosdoshmëri nga përkushtim i procesit të planifikimit shumë kohë më parë;
- Domosdoshmëri nga përkushtimi i negociatave me kompetentët në institucionet në bashkësi ku kryhet shërbimi dhe përgjegjësit dhe kompetentët në vetë bashkësinë.⁹⁰

3) Dobia për klientët dhe bashkësinë

Këtë pjesë të publikimit e përfundojmë me ‘listën e dobive për klientët dhe bashkësinë’ që e ofron Qendra për të mësuarit shërbyes të bashkësisë pranë Universitetit në Minesotë:

- Caktimi i resurseve plotësuese njerëzore të nevojshme për arritjen e misionit dhe qëllimeve të organizatës;
- ‘Dhënia’ e energjisë së re, entuziazmit dhe pikëpamjeve/perspektivave të reja në organizatë;
- Rritja e numrit të vullnetarëve në organizatë pasi studentët e inkuadruar në mësuarit shërbyes i kanë ndarë përvojat e tyre me miqtë dhe moshatarët;
- Vetëdija e ngritur publike dhe roli aktiv i organizatës në arsim dhe ndryshimi i perceptimeve të studentëve lidhur me çështjet kyçe dhe/ose problemet me të cilat ballafaqohet bashkësia;
- Afrimi deri te të rinjtë si pjesë e rëndësishme e kapitalit ‘social’ dhe në kuptimin më të gjerë ‘të padukshëm, jo material’ të cilësdo organizatë.
- Ndjenja se jeni pjesë e arsimimit të studentëve/rinisë për çështje që e tangojnë bashkësinë;
- Përgatitja e studentëve të tanishëm të bëhen liderë të ardhshëm qytetar, mes tjerash, korrigjim potencial i perceptimeve, dyshimeve të tyre të gabuara, dhe përmes nxitjes së etikës në shërbim dhe involvimit qytetar;
- Rrjetëzimi me kolegë nga organizatat dhe agjencitë tjera – potencial për partneritete plotësuese mes organizatës dhe kuadrit mësimor në universitete;
- Mundësi për identifikimin e qasjes deri te resurset tjera për universitetin etj.⁹¹

⁹⁰ Brzozowski, Bonnie, Nicholas Homenda, and Loriene Roy, 2012, ‘The Value of Service Learning Projects in Preparing LIS Students for Public Services Careers in Public Libraries’, cit., fq. 35.

⁹¹ Community Service-Learning Center, University of Minnesota, *Benefits of Service-Learning*, cit. Достапно на: <http://www.servicelearning.umn.edu/info/benefits.html>. Превземено на 4 јули 2012.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR PËR KAPITULLIN 1

- Astin**, Alexander W., Lori J. Vogelgesang, Elaine K. Ikeda, and Jennifer A. Yee, 2000, *How Service Learning Affects Students*, Los Angeles, CA: Higher Education Research Institute, University of California, Los Angeles, Retrieved from Gelman Library on June 16, 2012. Executive summary available on: <http://heri.ucla.edu/pdfs/rhowas.pdf>.
- Benton-Short**, Lisa (Ed.), 2012, *Service-Learning Faculty Handbook*, Center for Civic Engagement and Public Service, The George Washington University, fq. 9, Downloadable from: <http://www.gwu.edu/staticfile/GW/CCE&PS/Document/Service-Learning%20Faculty%20Handbook%20January%202012%20Edition.pdf>.
- Bickford**, Donna M. and Nedra Reynolds, 2002, 'Activism and Service-Learning: Reframing Volunteerism as Acts of Dissent', *Pedagogy: Critical Approaches to Teaching Literature, Language, Composition, and Culture*, Vol. 2, No. 2, fq. 229 – 252.
- Brown**, Danika Margo, 2003, *Outreach and Containment: The Rhetoric and Practice of Higher Education's Community-based Outreach Programs and Possible Alternatives*, Doctoral Dissertation, Graduate College of the University of Arizona, fq. 141, 142, Last retrieved from Gelman Library, ProQuest Dissertations & Theses on July 15, 2012.
- Brzozowski**, Bonnie, Nicholas Homenda, and Loriene Roy, 2012, 'The Value of Service Learning Projects in Preparing LIS Students for Public Services Careers in Public Libraries', *The Reference Librarian*, Vol. 53, fq. 24 – 40, Retrieved from Gelman Library on June 16, 2012.
- Buchanan**, Alice M., Shelia C. Baldwin, and Mary E. Rudisill, 2002, 'Service Learning as Scholarship in Teacher Education', *Educational Researcher*, Vol. 31, No. 8, fq. 30 – 36.
- Cavafy**, Constantine P., *Ithaca*, Translation from Greek to English retrieved on July 8, 2012 from: <http://www.poemhunter.com/poem/ithaca/>
- Community Service-Learning Center**, University of Minnesota, *Benefits of Service-Learning*, <http://www.servicelearning.umn.edu/info/benefits.html>. Retrieved on July 4, 2012.
- Corporation for National and Community Service**, *Learn and Serve America: Using Service as a Vehicle for Learning—A Most Valuable and Powerful Lesson*, Retrieved on June 10, 2012 from: <http://www.nationalservice.gov/about/programs/learnandserve.asp>
- Cress**, Christin M., Cathy Burack, Dwight E. Giles, Julie Elkins, and Margaret Carness Stevens (Eds.), 2010, *A Promising Connection: Increasing College Access and Success through Civic Engagement*, Boston, MA: Campus Compact.
- Cushman**, Ellen, 2002, 'Sustainable Service Learning Programs', *College Composition and Communication*, Vol. 54, No. 1, fq. 40-65. Last retrieved from JSTOR database, Gelman library on June 17, 2012.
- Diamond**, Robert M., 2008, *Designing and Assessing Courses and Curricula: A Practical Guide*, Third edition, San Francisco, CA: Jossey-Bass: John Wiley & Sons, Inc.
- Erickson**, M. Susan, 2010, *Investigating Community Impacts of a University Outreach Program through the Lens of Service Learning and Community Engagement*, Master thesis, Ames, Iowa: Iowa State University. Last retrieved from Gelman Library, ProQuest Dissertations & Theses on July 15, 2012.
- Eyler**, Janet, Dwight E. Giles, Jr., Christine M. Stenson, and Charlene J. Gray, 2001, *At a Glance: What We Know about the Effects of Service-Learning on College Students, Faculty, Institutions and Communities, 1993 – 2000*, Third Edition, Vanderbilt University, Funded by the Corporation for National Service, Learn and Serve America, National Service Learning Clearinghouse, Retrieved on June 16, 2012 from: <http://www.compact.org/wp-content/uploads/resources/downloads/aag.pdf>.
- Furco**, Andrew, 1996, 'Service Learning: A Balanced Approach to Experiential Education', *Expanding Boundaries: Serving and Learning*, Vol. 1, Issue 1, Washington DC: Corporation for National Service, fq. 2 – 6.
- Furco**, Andrew, 2011, 'Service-Learning: A Balanced Approach to Experiential Education', *The International Journal for Global and Development Education Research*, Issue Zero (Oct. 2011), fq. 71 – 76.
- Furco**, Andrew, *Service Learning: A Balanced Approach to Experiential Education in Introduction to Service-Learning Toolkit*, fq. 9 – 13, Retrieved on July 17, 2012 from: http://www.urmia.org/library/docs/regional/2008_northeast/Service_Learning_Balanced_Approach.pdf.
- Furco**, Andrew, Daniel Jones-White, Ronald Huesman, Jr., and Laura Gorny, 2010, *Developing a Model of the Influence of Service-Learning on Academic and Social Gains with the SERU Survey*, University of

Minnesota, Retrieved on July 4, 2012 from:

http://www.oir.umn.edu/static/papers/SERU_2012/SERU_Brief_MINNESOTA_Spring12.pdf.

George Washington University Service-Learning Advisory Board, 2007, *Report on Service-Learning*, Washington, DC: The George Washington University.

Hand, Sean (Ed.), 1989, *The Levinas Reader*, Oxford, UK: Blackwell.

Hatcher, Julie A., Mabel A. Erasmus, 2008, 'Service-Learning in the United States and South Africa: A Comparative Analysis Informed by John Dewey and Julius Nyerere', *Michigan Journal of Community Service Learning*, Issue Fall 2008, fq.49-61.

Hauer, Julie, and Timothy Quill, 2011, 'Educational Needs Assessment, Development of Learning Objectives, and Choosing a Teaching Approach', *Journal of Palliative Medicine*, Vol. 14, No. 4, fq. 503 – 507.

Heckert, Teresa M., 2010, 'Alternative Service Learning Approaches: Two Techniques That Accommodate Faculty Schedules', *Teaching of Psychology*, Vol. 37, fq. 32–35.

Hironimus-Wendt, Robert J. and Larry Lovell-Troy, 1999, 'Grounding Service Learning in Social Theory', *Teaching Sociology*, Vol. 27, No. 4, fq. 360 – 372.

Hollis, Shirley A., 2002, 'Capturing the Experience: Transforming Community Service into Service Learning', *Teaching Sociology*, Vol. 30, No. 2 (Apr., 2002), fq. 200 – 213.

Hunt, Thomas C., James C. Carper, Thomas J. Lasley II, and C. Daniel Raisch (Eds.), 2010, *Encyclopedia of Educational Reform and Dissent*, Thousand Oaks, CA: SAGE, Retrieved from SAGE Reference Online Web, Gelman Library, The George Washington University, Washington DC, on June 20, 2012.

Jia, Yunyan, 2004, *Students' Learning Styles and Their Correlation with Academic Performance in Architectural Design Studio*, Dissertation, The HKU Scholars Hub, The University of Hong Kong, fq. 6, Retrieved on June 23, 2012 from: <http://hdl.handle.net/10722/31928>.

Kolb, Alice Y., and David A. Kolb, 2005, 'Learning Styles and Learning Spaces: Enhancing Experiential Learning in Higher Education', *Academy of Management Learning and Education*, Vol. 4, No. 2, fq. 193 – 212.

Kouros, Fath Vajargah, 1999, *Needs-Based Curriculum Approach (Toward a New Conception of National Curriculum)*, Paper presented at ACSA Conference, Sept. 29, 1999, Perth, Australia.

Lazarevska, Ana and Atanasko Atanasovski, 2010, *Draft Action Plan resulting from the regional JFDP Alumni Conference "Enhancing Accessibility of the Higher Education to the Disabled"*, November 22-24, 2010 in Skopje/ Ohrid, Republic of Macedonia, Skopje, Macedonia: Friedrich Ebert Stiftung, Downloadable from: http://www.maaa.com.mk/sites/default/files/Action%20Plan_eng.pdf

Levkov, Nikola and Stuart Umpleby, 2009, 'How Service Learning is Conducted in a School of Business', *CEA Journal of Economics*, Vol. 4, Issue 2, fq. 25 – 34.

Lipscomb, Lindsay, Janet Swanson, and Anne West, 2004, *Scaffolding* in Orey, Michael (Ed.), 2004, *Emerging Perspectives on Learning, Teaching, and Technology*, Association for Educational Communications and Technology. Retrieved on July 8, 2012 from: <http://projects.coe.uga.edu/epltt/index.php?title=Scaffolding>.

Mooney, Linda and Bob Edwards, 2001, 'Experiential Learning in Sociology: Service Learning and Other Community-Based Learning Initiatives', *Teaching Sociology*, Vol. 29, No. 2, fq. 181-194.

Nye, Joseph, 2003, *Understanding International Conflict*, 4th edition, New York, NY: Longman.

Orey, Michael (Ed.), 2004, *Emerging Perspectives on Learning, Teaching, and Technology*, Association for Educational Communications and Technology. Retrieved on July 8, 2012 from: http://projects.coe.uga.edu/epltt/index.php?title=Main_Page.

Parker-Gwin, Rachel and J. Beth Mabry, 1998, 'Service Learning as Pedagogy and Civic Education: Comparing Outcomes for Three Models', *Teaching Sociology*, Vol. 26, No. 4, fq. 276 – 291.

Peters, Kimberly A., 2011, 'Including Service Learning in the Undergraduate Communication Sciences and Disorders Curriculum: Benefits, Challenges, and Strategies for Success', *American Journal of Audiology*, Vol. 20, fq. 181–196.

Rice, Kathleen, 2008, *A Guide to Reciprocal Community-Campus Partnership*, Proceedings from Portland State University's Partnership Forum, March 6-8, 2008 (A Unique Collaborative Study of Partnerships from the Perspectives of both Community Partners and Higher Education Partners), Portland University. Retrieved on July 10, 2012 from: http://depts.washington.edu/ccph/pdf_files/Guide_corrected_041808.pdf

- Robert**, Julie A. Hatcher and Steven G. Jones (Eds.), 2011, *International Service Learning. Conceptual Frameworks and Research. Vol. 1: IUPUI Series on Service Learning Research*, Sterling, Virginia: Stylus Publishing LLC.
- Sedlak**, Carol A., Margaret O. Doheny, Nancy Panthofer, and Ella Anaya, 2003, 'Critical Thinking in Student's Service-Learning Experiences', *College Teaching*, Vol. 51, No. 3, fq. 99 – 103.
- Seider**, Scott C., Samantha A. Rabinowicz, and Susan C. Gillmor, 2011, 'The Impact of Philosophy and Theology Service-Learning Experiences upon the Public Service Motivation of Participating College Students', *The Journal of Higher Education*, Vol. 82, No. 5, fq. 597 – 628, Retrieved on June 20, 2012 from:
http://people.bu.edu/seider/Consolidated%20papers/Public%20Service%20Motivation%20Paper%20Final%20Proofs_Seider%20et%20al.pdf.
- Seifer**, Sarena D., and Kara Connors (Eds.), 2007, *Community Campus Partnerships for Health: Faculty Toolkit for Service Learning in Higher Education*, Scotts Valley, CA: National Service-Learning Clearinghouse, Retrieved on June 02, 2012 from:
http://www.uri.edu/acadsupp_services/slearn/documents/HEtoolkit.pdf
- Sharma**, Aparna, Mindy Lanum, and Yolanda Suarez-Balcazar, 2000, *A Community Needs Assessment Guide: A Brief Guide on How to Conduct a Needs Assessment*, Chicago, IL: Center for Urban Research and Learning and the Department of Psychology, Loyola University Chicago.
- Strage**, Amy, 2004, 'Long-term Academic Benefits of Service-Learning: When and Where Do They Manifest Themselves', *College Student Journal*, Vol. 38, Issue 2, Last retrieved in HTML format from Academic Search Complete, Gelman Library on June 2, 2012.
- Taylor**, Pamela G., 2002, 'Service-Learning as Postmodern Art and Pedagogy', *Studies in Art Education*, Vol. 43, No. 2, fq. 124 – 140.
- Taylor**, Pamela A. and Christine Ballengee-Morris, 2004, 'Service-Learning: A Language of "We"', *Art Education*, Vol. 57, No. 5, Community, Collaboration, and Culture (Sep., 2004), fq. 6 – 12.
- The National and Community Service Act of 1990** [As amended through December 17, 1999, P.L. 106-170], Retrieved on June 26, 2012 from:
http://www.californiavolunteers.org/documents/About_Us/nca1990.pdf.
- Vogelgesang**, Lori J. and Alexander W. Astin, 2000, 'Comparing the Effects of Community Service and Service-Learning', *Michigan Journal of Community Service Learning*, Vol. 7, Issue Fall 2000, fq. 25 – 34.
- Weigert**, Kathleen Maas, 1998, 'Academic Service Learning: Its Meaning and Relevance', *New Directions for Teaching and Learning*, No. 73 (Spring 1998), fq. 3 – 10.
- Wells**, G., 2001, *Action, Talk, and Text: Learning and Teaching through Inquiry*, New York, NY: Teachers College Press, Columbia University.

ON-LINE RESURSE TJERA PËR KAPITULLIN 1

http://www.equalaccess4pws.org/sites/default/files/resources/AEIFproposal_MK_CR_finalists_narrative_new.pdf

<http://www.equalaccess4pws.org/activity-list>

<http://www.maaa.com.mk/jfdp-conference-2010>

<http://www.magnapubs.com/bio/124/>

http://www.servicelearning.org/what_is_service-learning/history

KAPITULLI 2

ASPEKTET PRAKTIKE TË INKORPORIMIT TË MËSUARIT SHËRBYES NË INSTITUCIONET E ARSIMIT SIPËROR

Hyrje

Edhe pse procesi i implementimit dhe integritit të mësuarit shërbyes në institucionet e arsimit sipëror tashmë shkurtimisht ishte sqaruar në Kapitullin 1, mendojmë se është e nevojshme që ai të sqarohet në mënyrë të hollësishme. Kemi për qëllim t'u ofrojmë ndonjë formë të kornizës konceptuale nga e cila do të mund të shtjerrin njohuri kur mendohet për fillimin e reformave të rëndësishme në kuadër të institucioneve arsimore sipërore në drejtim të sigurimit të procesit kualitativ të mësimit.

Në bazë të analizës të hollësishme të informatave dhe komenteve eksperte dhe analizave të bëra nga ana e Korporatës amerikane për ofrimin e shërbimeve në nivel nacional dhe lokal, Shtëpia nacionale për kliring për të mësuarit shërbyes, si dhe numër i madh i punimeve të publikuara në revista të njohura akademike, anëtarët e ekipit të angazhuar për implementimin e projektit dhe botimin e këtij publikimi identifikuan fond të madh të literaturës relevante dhe materialit tjetër nga fusha e të mësuarit shërbyes. Para se të fillojmë me prezantimin e versionit të adaptuar të udhëzimeve nga *Community Campus Partnerships for Health. Faculty Toolkit for Service-Learning in Higher Education* [Seifer and Connors, Eds., 2007] i cili shërbeu si model për drejtimet të cilat i propozoi ekipi ynë, do të kishim dashur të japim pasqyrë të një modeli për ndryshime institucionale të integritit të mësuarit shërbyes d.m.th. model i planit të veprimit për implementimin e të mësuarit shërbyes në institucionet e arsimit sipëror.

Ideja themelore udhëheqëse e kësaj pjese nga doracaku është t'u përgjigjet problemeve potenciale, me të cilat haset kuadri mësimor dhe administrativ në arsimin sipëror gjatë proceseve të ndryshimit të përmbytjes dhe strukturës së programeve mësimore në pajtim me lëvizjet më të reja globale, në pajtim me kërkesat e agjencive për akreditim, si dhe në pajtim me kërkesat për të mësuarit shërbyes të cilat i imponojnë studentët. Shpresojmë se institucionet e arsimit sipëror në Republikën e Maqedonisë do ta shfrytëzojnë këtë doracak, i cili përmban drejtime të dobishme praktike për realizimin e ndryshimeve sistematike lidhur me të mësuarit shërbyes dhe integrimin e tij në programet ekzistuese dhe të ardhshme mësimore.

Reformimi i gjendjes aktuale në arsimin sipëror përmes implementimit të Planit gjithëpërfshirës së veprimit për të mësuarit shërbyes (CAPSL)⁹²

Kjo pjesë e doracakut bazohet në modelin për implementimin dhe institucionalizimin e të mësuarit shërbyes në sektorin e arsimit sipëror të zhvilluar nga ana e Bringle dhe Hatcher (1996).⁹³ Modeli është rezultat i një projekti të madh për themelimin e Zyrës për të mësuarit shërbyes në Indiana University-Purdue University, Indianapolis, i cili është nën projekt i projektit trevjeçar për integrimin

⁹² Reforming the Present State of Higher Education by Implementing the Comprehensive Action Plan for Service-Learning (CAPSL)

⁹³ Bringle, Robert G., and Julie A. Hatcher, 1996, 'Implementing Service Learning in Higher Education', *The Journal of Higher Education*, Vol. 67, No. 2, fq. 221 – 239.

e shërbimeve në kuadër të studimeve akademike të realizuar nga ana e Campus Compact. Aktivitetet e projektit e rrumbullakojnë kornizën për hapat të cilat nevojitet të ndërmerren që të arrihet ndryshim sistemor organizativ (institucional) dhe të zhvillohet program i ri. Edhe pse aktivitetet janë prezantuar në formë lineare, në praktikë, ato shpesh kanë rrjedhë lineare. Bringle dhe Hatcher mendojnë se sipas natyrës së vet, zhvillimi i programit për të mësuarit shërbyes në nivel institucional është në formë cikli (përmban numër të madh të lidhjeve kthyesë dhe interaksion mes aktivitetëve).

Korniza analitike i përmban aktivitetet/detyrat që vijnë:

- Planifikimi fillestar;
- Ngritja e vetëdijes;
- Analiza e shembujve të kapshëm ose proto tipave të lëndëve mësimore;
- Grumbullimi i resurseve dhe dizajni i aktivitetëve;
- Ekspansioni;
- Dokumentimi i implementimit të mësuarit shërbyes (monitoringu);
- Evoluimi i rezultateve nga të mësuarit shërbyes;
- Njohja publike dhe njohja e rezultateve nga të mësuarit shërbyes në media, si dhe përmes punës akademike dhe publikimit të hulumtimeve nga fusha e të mësuarit shërbyes në revistat profesionale;
- Hulmtimi i mëtejshëm formal;
- Institucionalizimi i të mësuarit shërbyes përmes krijimit të programeve për fitim me shkallë arsimore.

Gjithashtu, Bringle dhe Hatcher, ofrojnë listë të aktivitetëve të cilat duhet të ndërmerren nga ana e institucioneve të larta arsimore, kuadrit mësimor, studentët dhe gjithë bashkësia. Këto aktivitete i prezantojmë në formë akademike që e propozojnë Bringle dhe Hatcher. Përmendëm se lista e hapave me elementet adekuate nga korniza më e gjerë institucionale ka të bëjë me SHBA-të, por në masë të madhe është e përshtatur për kontekstin më të gjerë të sistemit arsimor dhe shoqëror në vende të ndryshme.

Shembuj të aktivitetëve të cilat i ndërmerr institucioni arsimor⁹⁴

Planifikimi	<ul style="list-style-type: none">• Themelimi i grupit për planifikim i përbërë nga personalitete kyçe• Zbatimi i anketës për resurse institucionale dhe ambient• Vizitë institutit rajonal të Campus Compact• Zhvillimi i Planit të veprimit për të mësuarit shërbyes në nivel të institucioneve të larta arsimore• Formimi i komitet këshillëdhënës
Ndërtimi dhe ngritja e vetëdijes	<ul style="list-style-type: none">• Informimi i administratorëve kyç dhe grupeve të kuadrit mësimor për të mësuarit shërbyes dhe për zhvillimin e programeve mësimore• Anëtarësimi në organizata nacionale (shembull, Campus Compact, Shoqata nacionale për arsim nga përvoja, Partneriteti për të mësuarit shërbyes)• Vizitë konferencave për të mësuarit shërbyes
Prototip	<ul style="list-style-type: none">• Identifikimi dhe njohja me shembuj të programeve për të mësuarit shërbyes në kuadër të arsimit sipëror• Marrja e lejes administrative për themelimin e Zyrës për të mësuarit shërbyes (për shembull, buxhet, zyrë dhe personel)• Zhvillimi i mjeteve për koordinim të mësuarit shërbyes me programe tjera të cilat ekzistojnë në kuadër të kampit (për shembull, shërbime për mbështetje të studentëve, zhvillimi i kuadrit akademik etj.)• Aplikimi për grante

⁹⁴ Ibid, fq. 226.

Ekspansioni	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutimi lidhur me të mësuarit shërbyes para publikut më të gjerë të administruesve dhe kuadrit mësimor (shembull, dekanë, këshilltarë, çështje studentore) • Mbështetje për prezencën në konferenca për të mësuarit shërbyes • Bashkëpunimi me subjekte tjera në sferën e përpilimit të programeve dhe shkrimit të aplikimeve për grante • Organizimi i diskutimeve me përfaqësues nga kampi universitar dhe forume lidhur me të mësuarit shërbyes
Njohja	<ul style="list-style-type: none"> • Informimi i institucioneve tjera për aktivitetet që i ndërmerr universiteti lidhur me të mësuarit shërbyes • Pjesëmarrje në konferenca dhe punëtori • Publikimi i hulumtimeve • Publikimi i aktiviteteve lidhur me të mësuarit shërbyes në mediat lokale
Monitoringu	<ul style="list-style-type: none"> • Grumbullimi i të dhënave në kuadër të institucionit (për shembull, të dhëna lidhur me: numrin e lëndëve të ofruara të cilat përmbajnë të mësuarit shërbyes, numri i profesorëve të cilët ligjërojnë me të mësuarit shërbyes, numri i studentëve të regjistruar, numri i partnerëve të lidhura me agjenci të tjera)
Evoluimi	<ul style="list-style-type: none"> • Përpunimi i raporteve vjetore për punë të Zyrës për të mësuarit shërbyes • Inkuadrimi i të mësuarit shërbyes në vlerësimin e institucionit arsimor
Hulumtimi	<ul style="list-style-type: none"> • Implementimi i hulumtimit për të mësuarit shërbyes në kuadër të vetë institucionit dhe institucioneve tjera
Institucionalizimi	<ul style="list-style-type: none"> • Inkorporimi i shërbimit në misionin e universitetit dhe inkuadrimi/njohja e të mësuarit shërbyes në publikimet universitare • Inkorporimi i të mësuarit shërbyes si pjesë nga sistemi më i gjerë i arsimit në mënyrë që mund të njihet më lehtë • Inkuadrimi i plotë i lëndëve për të mësuarit shërbyes në buletinet e shkollave, orari i orëve dhe në përshkrimin e programit mësimor • Sponsorimi i konferencave rajonale dhe nacionale për të mësuarit shërbyes në nivel të universitetit • Projektimi dhe implementimi i pjesëve buxhetore në drejtim me mbështetjen e të mësuarit shërbyes

Shembuj për aktivitete të cilat i ndërmerr kuadri mësimor⁹⁵

Planifikimi	<ul style="list-style-type: none"> • Realizimi i anketës për interesimin që ekziston mes bashkësisë akademike dhe për lëndët që përmbajnë të mësuarit shërbyes, të cilët në momentin aktual janë pjesë e programit mësimor • Identifikimi i grupit për planifikim dhe komiteti adekuat nga kuadri mësimor i cili merret me të mësuarit shërbyes
Ndërtimi dhe ngritja e vetëdijes	<ul style="list-style-type: none"> • Distribucioni i informatave lidhur me të mësuarit shërbyes (për shembull, broshura, buletine, shkrime) • Identifikimi i personit për lidhje/kontakt personi nga kuadri mësimor në kuadër të bashkësisë akademike
Prototipi	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikimi ose zhvillimi i lëndëve për të mësuarit shërbyes që shërbejnë si prototip për zhvillimin e lëndëve të reja
Resurset	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikimi i kuadrit mësimor dhe mentorëve, të cilët janë ose do të ishin të interesuar për punë me studentë nga fusha e të mësuarit shërbyes • Formimi i bazës të dhënave për planet dhe programet mësimore nga fushat dhe disiplinat shkencore • Zhvillimi i fondit të bibliotekës me literaturë dhe materiale për të mësuarit shërbyes • Sigurimi i mjeteve financiare për zhvillim të kuadrit mësimor • Identifikimi i resurseve ekzistuese për mbështetje të zhvillimit të kuadrit mësimor të përfshirë në të mësuarit shërbyes

⁹⁵ Ibid, fq. 229.

	<ul style="list-style-type: none"> • Shpërblime për merita për kuadrin akademik i cili ka dhënë kontribut të veçantë për të mësuarit shërbyes
Ekspansioni	<ul style="list-style-type: none"> • Ofertë e punëtorive për zhvillim të kuadrit akademik • Organizimi i konsultimeve • Organizimi i diskutimeve për të mësuarit shërbyes në kuadër të departamenteve dhe fakulteteve në nivel të universitetit • Sigurimi i bursave dhe granteve për zhvillim të planeve mësimore me qëllim që të mbështetet të mësuarit shërbyes • Fokusimi i aktiviteteve në fakultete dhe shkolla të cilat janë më pak të përfaqësuara ose nuk janë përfaqësuar sa duhet në nivel të organizatave nacionale për të mësuarit shërbyes • Zhvillimi i programit për punë të kuadrit mësimor si mentorë nga fusha e të mësuarit shërbyes • Promovimi i zhvillimit të lëndëve mësimore të përgjithshme, të avancuara dhe ndër disiplinore për të mësuarit shërbyes
Njohja	<ul style="list-style-type: none"> • Shpallja e arritjeve të kuadrit akademik në fushën e të mësuarit shërbyes • Inkuadrimi i të mësuarit shërbyes në formularët për raportet vjetore për punë të kuadrit mësimor • Inkuadrimi i kuadrit mësimor në aktivitetet profesionale (për shembull, publikime, punëtori, konferenca, forume) • Shpallja e fituesve të shpërblimeve për merita në të mësuarit shërbyes
Monitoringu	<ul style="list-style-type: none"> • Grumbullimi i të dhënave për shkallën e inkuadrimit të kuadrit mësimor në programet për të mësuarit shërbyes (për shembull, numri i kuadrit akademik i përfshirë në aktivitetet zhvillimore, numri i kuadrit akademik i përfshirë në lëndët mësimore të cilat përmbajnë të mësuarit shërbyes)
Evoluimi	<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimi i metodave dhe zgjidhjeve ideore për vlerësimin e punës së kuadrit mësimor (shembull, portfolio, recension nga ana e kolegut) • Evoluimi i rezultateve sipas lëndëve të cilat përmbajnë të mësuarit shërbyes (për shembull, shkalla e kënaqësisë së studentëve, niveli deri ku studentët diçka kanë mësuar)
Hulumtimi	<ul style="list-style-type: none"> • Mbështetje për punën hulumtuese të kuadrit akademik në sferën e të mësuarit shërbyes • Zbatimi i hulumtimit për inkuadrimin e kuadrit akademik në të mësuarit shërbyes
Institucionalizimi	<ul style="list-style-type: none"> • Të mësuarit shërbyes bëhet pjesë e procesit të seleksionimit dhe rekrutimit të punësuarve të ri (për shembull, punësime të reja, vlerësimi i punës në nivel vjetor, avancimi dhe fitimi i titullit më të lartë) • Të mësuarit shërbyes është pjesë e përhershme përbërëse e lëndëve mësimore dhe programit mësimor • Të mësuarit shërbyes bëhet pjesë integruese e zhvillimit profesional të kuadrit mësimor

Shembuj të aktiviteteve që i ndërmarrin studentët⁹⁶

Planifikimi	<ul style="list-style-type: none"> • Zbatimi i anketës për inkuadrimin e studentëve në aktivitete shërbyese (për shembull, individë dhe grupe të studentëve) • Zbatimi i anketës për raportin e studentëve drejt të mësuarit shërbyes dhe në përgjithësi drejt ofrimit të shërbimeve • Identifikimi i studentëve për grupe dhe komitete këshillëdhënëse të cilët punojnë në sferën e planifikimit të mësuarit shërbyes
Ndërtimi dhe ngritja e vetëdijes	<ul style="list-style-type: none"> • Distribucioni i informatave lidhur me të mësuarit shërbyes (për shembull, përmes shkrimeve gazetareske, posterëve, broshurave, ngjarjeve për orientim të studentëve) • Informimi i pedagogëve/psikologëve të punësuar në fakultete/universitet për çështje lidhur me të mësuarit shërbyes

⁹⁶ Ibid, fq. 233.

	<ul style="list-style-type: none"> Organizimi i prezantimeve lidhur me të mësuarit shërbyes para organizatave studentore
Prototipi	<ul style="list-style-type: none"> Rekrutimi i studentëve për lëndët mësimore të cilat shërbejnë si prototip
Resurset	<ul style="list-style-type: none"> Shpallja e lëndëve të cilat përmbajnë të mësuarit shërbyes (për shembull, orari i orëve, personat e angazhuar për punë me studentë në kuadër të këtyre lëndëve) Vendosja e bursave për të mësuarit shërbyes Sigurimi i mjeteve financiare për asistentë dhe koordinatorë të lëndëve për të mësuarit shërbyes
Ekspansioni	<ul style="list-style-type: none"> Ofertë e gjerë e lëndëve nga fusha e të mësuarit shërbyes ku do të përfshiheshin lëndët e obligueshme nga fusha e arsimit të përgjithshëm, kurset vijuese të avancuara dhe lëndët ndër disiplinore Inkuadrimi i ish studentëve në rekrutimin e studentëve të ri, të cilët do ta ndjekin mësimin në lëndët që përmbajnë të mësuarit shërbyes Hapja e vendeve të punës për asistentë dhe koordinatorë të lëndëve të mësuarit shërbyes të cilët punojnë me studentë Zhvillimi i opsionit për kredi të katërt të studentëve të mund të zhvillojnë komponentë ‘të pavarur’ të mësuarit shërbyes Ofertë e lëndëve zgjedhore nga fusha e të mësuarit shërbyes Inkuadrimi i studentëve në zhvillimin e lëndëve që përmbajnë të mësuarit shërbyes dhe aktivitete të ngjashme (për shembull, punëtori, fokus grupe, organizata shtetërore dhe konferenca)
Njohja	<ul style="list-style-type: none"> Shpallja e fituesve të bursave studentore nga fusha e të mësuarit shërbyes Shkrimi i rekomandimeve për ata studentë që janë të përfshirë në të mësuarit shërbyes Nominimi i studentëve për shpërblime dhe mirënjohje lokale, nacionale dhe rajonale Përgatitja e raportit për përvojat lideri dhe përfshirja e kampit studentor (të ashtuquajtur co-curricular transcript)
Monitoringu	<ul style="list-style-type: none"> Grumbullimi i të dhënave për përfshirjen e studentëve (numri i studentëve të regjistruar, numri i studentëve të çregjistruar)
Evoluimi	<ul style="list-style-type: none"> Evoluimi i lëndëve që përmbajnë të mësuarit shërbyes (për shembull, niveli i kënaqësisë së studentëve, rezultatet nga të mësuarit, shkalla e mbajtjes së njohurive të mësuara, absolvuara)
Hulumtimi	<ul style="list-style-type: none"> Zbatimi i hulumtimit për përvojat e studentëve nga fusha e të mësuarit shërbyes Promovimi i përfshirjes së studentëve në hulumtim, qëllimi i të cilit është ndërmarrja e aksionit konkret në bazë të njohurive të fituara
Institucionalizimi	<ul style="list-style-type: none"> Shkallë e lartë konsistente me regjistrimit për ndjekjen e mësimit nga lëndët ku është integruar të mësuarit shërbyes Aplikim i gjerë i opsionit për kredinë e katërt Të mësuarit shërbyes bëhet pjesë e kulturës studentore

Shembuj për aktivitetet e bashkësisë⁹⁷

Planifikimi	<ul style="list-style-type: none"> Zbatimi i anketës për partneritetet ekzistuese mes universiteteve dhe bashkësisë Identifikimi i përfaqësuesve të bashkësisë në grupet për planifikim dhe komitetet këshillëdhënëse për të mësuarit shërbyes
Ndërtimi dhe ngritja e vetëdijes	<ul style="list-style-type: none"> Distribuidimi i informatave për të mësuarit shërbyes (për shembull, broshura, buletine) Inicimi i mbledhjeve dhe vizitave me personelin e agjencisë në kuadër të cilit realizohet intervenimi konkret për ofrimin e shërbimit në bashkësi Edukimi i personelit të agjencisë për dallimet mes punës vullnetare dhe të mësuarit shërbyes
Prototipi	<ul style="list-style-type: none"> Bashkëpunimi me personelin e agjencisë që të zhvillohen lëndë mësimore të cilat do të shërbejnë si prototip për lëndët e reja

⁹⁷ Ibid, fq. 235.

Resurset	<ul style="list-style-type: none"> • Kompilimi i vlerësimeve për nevojat e bashkësisë (për shembull, vlerësimi i nevojave të bashkësisë sipas metodologjisë United Way) • Sigurimi i mjeteve financiare për angazhimin e koordinatorëve të studentëve të cilët kanë punuar në vetë vendin • Shkrimi i doracakut për politikën universitare dhe procedurat universitare për angazhim në kuadër të bashkësisë, të cilat do t'i dedikoheshin përfaqësuesve të bashkësisë
Ekspansioni	<ul style="list-style-type: none"> • Inicimi i punëtorive dhe diskutimeve për të mësuarit shërbyes në kuadër të bashkësisë • Rritja e pjesëmarrjes së personelit të agjencisë në proceset e konceptimit dhe aktiviteteve lidhur me të mësuarit shërbyes në nivel të universitetit • Analiza e mundësive të reja në sferën e të mësuarit shërbyes • Bashkëpunimi me agjencitë nga bashkësia në përpilimin e programeve, shkrimin e propozim projekteve dhe organizimin e konferencave
Njohja	<ul style="list-style-type: none"> • Sponsorimi i ngjarjeve në kuadër të cilave do t'u jepet mirënjohje agjencive ku është realizuar shërbimi për bashkësinë dhe personelin e atyre agjencive • Publikimi i partneriteteve me bashkësinë në mediat lokale
Monitoringu	<ul style="list-style-type: none"> • Monitoringu i trajnimeve dhe mbikëqyrja e studentëve në agjenci • Udhëheqja e dosjeve për përfshirjen e studentëve dhe kuadrit mësimor në punën e agjencisë
Evoluimi	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve për të mësuarit shërbyes mbi plotësimin e nevojave të agjencisë dhe klientëve
Hulumtimi	<ul style="list-style-type: none"> • Bashkëpunimi me agjencitë në projekte hulumtuese të cilat do të duhej të rezultojnë me aksione konkrete për zgjidhjen e problemeve ose për plotësimin e nevojave të bashkësisë
Institucionalizimi	<ul style="list-style-type: none"> • Lidhja formale e kuadrit akademik me agjencinë (për shembull, përmes punës konsultuese, anëtarësimi në Këshillin e drejtorëve) • Involvimi formal i personelit të agjencisë në aktivitetet e universitetit (shembull, trajnimi për mbajtjen e mësimin ekipor, komitete të kampit universitar) • Alocimi i resurseve plotësuese për mbështetje dhe trajnim të studentëve-vullnetarëve nga ana e agjencive

Në procesin e shkrimit të këtij doracakut me rëndësi të madhe për ne kishte qasja për institucionalizimin e të mësuarit shërbyes, që u prezantua në publikimin *Faculty Toolkit for Service-Learning in Higher Education*. Në vazhdim të këtij kapitulli ua prezantojmë një version të shkurtuar të tij dhe të përshtatur për të cilin mendonim se mund të ndahet në kontekst të sistemit arsimor të Republikës së Maqedonisë dhe më gjerë, në Ballkan.

Themelimi i partneriteteve mes bashkësisë dhe kampit universitar në fushën e të mësuarit shërbyes

Për zhvillim të suksesshëm dhe implementim të programit mësimor që tërësisht e integron konceptin e të mësuarit shërbyes është e nevojshme të vendoset partneriteti funksional mes bashkësisë dhe kampit universitar. Ky partneritet paraqet mjet për artikullimin e nevojave të bashkësisë, ngritjen e vetëdijes dhe inkuadrimit të kuadrit akademik në zgjidhjen e problemeve të bashkësisë, si dhe për realizimin e ndikimit të vazhdueshëm në funksion të avancimit të shoqërisë në përgjithësi. Funksionimi dhe efektiviteti i këtij partneriteti nuk varet vetëm nga të ashtuquajturit “aspekte të rëndësishme të funksionimit të partneritetit siç janë: niveli i pjesëmarrjes së secilit nga partnerët, lidhjet mes partnerëve, mbështetje mes personelit, qasja deri te resurset, lidhshëria, menaxhmenti, komunikimi, menaxhimi, struktura e partneritetit dhe mjedisi i jashtëm.”⁹⁸ Sipas Lasker, Weiss dhe Miller (2001),

⁹⁸ Lasker, Roz D., Elisa S. Weiss, and Rebecca Miller, 2001, ‘Partnership Synergy: A Practical Framework for Studying and Strengthening the Collaborative Advantage’, *The Milbank Quarterly*, Vol. 79, Issue 2, fq. 179 – 205, fq. 182.

funksionimi dhe efektiviteti i partneritetit varet edhe nga shkalla e ndikimit pozitiv dhe mbi shoqërinë, në përgjithësi të shprehura përmes aftësisë për:

- Arritjen e rezultateve të pritura;
- Qëndrueshmëria;
- Avancimi i vazhdueshëm i përdorimit të resurseve dhe sa janë adekuate për nevojat e bashkësisë;
- Kursimi, gjegjësisht zvogëlimi i shpenzimeve dhe
- Avancimi i kualitetit dhe dërgimit të shërbimit.

Realizimi i gjithë kësaj është kushtëzuar nga operacionalizimi i sinergjisë mes partnerëve dhe nga 'harmonizimi' i të gjithë determinuesve. Supozimi themelor është se sinergia paraqet karakteristikë specifike ose aftësi për bashkëpunim të përbashkët përmes së cilës kombinohen resurset, shkathtësitë dhe pikëpamjet e pjesëmarrësve në mënyra të cilat shkojnë drejt rezultateve më të mëdha ose më të rëndësishme.⁹⁹

Që të mund të arrihet qëllimi parësor me të cilin është themeluar partneriteti, bile edhe të arrihen qëllimet të cilat janë më të mëdha dhe më të rëndësishme nga ato të cilat janë shtruar së pari, nevojitet që partneriteti mes bashkësisë dhe kampit universitar në fushën e të mësuarit shërbyes të bazohet në disa 'gurë themel' të rëndësishëm siç janë:

- Parime qartë të formuluar të partneritetit dhe mënyra eksplicite për aplikimin e tyre në procesin e zhvillimit të programit mësimor për të mësuarit shërbyes;
- Identifikimi i partnerëve dhe njoftimi me bashkësinë;
- Strategji efektive për bashkëpunim dhe njoftim më të mirë me partnerët/aktorët potencial në kuadër të bashkësisë;
- Strategji në fazën e përgatitjes për planifikim të aktiviteteve të cilat do t'i ndërmerren partnerët;
- Identifikimi i resurseve dhe partnerëve/aktorëve në kuadër të institucionit akademik të cilat mund të nxisin bashkëpunim me partnerët nga bashkësia;
- Lidhje të qëndrueshme me liderë nga bashkësia dhe aktorët tjerë prej të cilave do të mund të dilnin përfitime të përbashkëta;
- Qasje në punën me bashkësinë gjatë ndërtimit të partneritetit në sferën e të mësuarit shërbyes, që është i bazuar në qasjen e resurseve dhe mjeteve.¹⁰⁰

Edhe pse parimet e përmbajtura në publikimin *Community Campus Partnerships for Health. Faculty Toolkit for Service-Learning in Higher Education* [Seifer and Connors, Eds., 2007], para së gjithash, janë formuluar në sferën e shëndetësisë, duket se ato janë të ndryshueshme për cilindo të mësuar shërbyes ose projekte të bashkësisë lokale, qëllimi i të cilave është të zgjidhen nevojat ose problemet me të cilat ballafaqohen grupe të ndryshme shoqërore. Vijnë parimet në formën e tyre burimore:

1. "Partneritetet themelohen që të shërbejnë për arritjen e ndonjë qëllimi të caktuar, e me kalimin e kohës mund të përfshijnë dhe të realizojnë edhe qëllime tjera.
2. Partnerët kanë arritur marrëveshje lidhur me misionin, vlerat, qëllimet, rezultatet që maten dhe përgjegjësinë lidhur me partneritetin.
3. Lidhja mes partnerëve bazohet në besimin, respektin, sinqeritetin dhe përkushtim e ndërsjellë.
4. Partneriteti ndërtohet në bazë të anëve dhe mjeteve më të fuqishme të identifikuara, por gjithashtu përpiqet t'i përfshijë edhe nevojat e partnerëve dhe ta forcojë kapacitetin e tyre.
5. Partneriteti bazohet në fuqinë e balancuar mes partnerëve dhe mundëson ndarjen e resurseve mes partnerëve.

⁹⁹ Ibid, fq. 183.

¹⁰⁰ Seifer, S D., and K. Connors (Eds.), 2007, *Community Campus Partnerships for Health: Faculty Toolkit for Service Learning in Higher Education*, Scotts Valley, CA: National Service-Learning Clearinghouse, fq. 11.

6. Komunikimi i qartë dhe i hapur është prioritet i përhershëm i partnerëve. Partnerët përpiqen t'i kuptojnë më mirë nevojat dhe interesat e tyre dhe të zhvillojnë gjuhë të përbashkët.
7. Parimet dhe proceset në të cilat bazohet partneriteti vendosen me ndihmën e inuteve dhe përgjigje nga ana e të gjithë partnerëve, veçanërisht në situata kur duhet të miratohen vendime dhe të zgjidhet ndonjë konflikt/kontest.
8. Ekziston mbrehja kthyesë komunikuese mes të gjithë partnerëve përmes të cilave përpiqet të arrihet avancimi i vazhdueshëm i partneritetit dhe të rezultateve të cilat ai i jep.
9. Partnerët i ndajnë përfitimet nga arritjet e partneritetit.
10. Partneriteti mund të pushojë se ekzistuari dhe për këtë shkak, nevojitet të planifikohet procesi i shuarjes së tij.¹⁰¹

Nëse riformulohen, këto parime mund të futen në 'listën' e karakteristikave më të rëndësishme të partneriteteve efikase dhe efektive mes bashkësisë dhe kampit universitar:

- Qëllim qartë i definuar për shkak të cilit formohet partneriteti dhe target i tërësishëm i orientuar;
- Role qartë të definuar dhe përgjegjësi e të gjithë partnerëve dhe aktorëve të përfshirë;
- Dinamikë me kujdes e vlerësuar së fuqisë mes partnerëve dhe aplikimi i metodave për ri disrtibuimin e kësaj fuqie;
- Ndarja efektive e të gjitha resurseve (financiare, fizike, njerëzore, diturisë);
- Caktimi i prioritetit të detyrave dhe qëllimeve për zgjidhjen sa më urgjente të nevojave dhe problemeve të bashkësisë;
- Komunikim dhe koordinim i qartë, i hapur dhe i vazhdueshëm që shpijnë drejt bashkëpunimit efektiv;
- Formimi i kapitalit social inherent të nevojave të bashkësisë dhe të partneritetit (mendime, vlera. Norma, besimi, përkushtimi, lidhja, role dhe procedura të cilat janë kontraktuar bashkarish);
- Lidhje të inkorporuar kthyesë të cilat i përfshijnë të gjithë partnerët dhe ndihmojnë të miratohen vendime joformale;
- Implementimi i sistemeve për monitoring dhe evoluim;
- Ndarja e meritave për arritjet dhe vlerësimi i tyre i vërtetë;
- Evoluimi i vazhdueshëm i partneritetit, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër njëkohësisht, kufizim kohor dhe mundësi për shuarjen e partneritetit pasiqë të arrihen qëllimet për shkak të cilave është themeluar i njëjti.¹⁰²

Vendosja dhe vlerësimi i qëllimeve dhe kursit, rezultateve nga të mësuarit dhe kompetencat e fituara

Qëllimet kryesore të një lënde për të mësuarit shërbyes janë: 1) të jepet kontribut i rëndësishëm në zhvillimin e bashkësisë dhe 2) përmbajtja dhe lënda mësimore t'i japin rezultatet e pritura nga të mësuarit dhe të ndihmojnë në zhvillimin e kompetencave. Këto qëllime mund të arrihen nëse "anëtarët e kuadrit akademik tërësisht janë të aftësuar që ta ndihmojnë dhe ta vlerësojnë procesin e të mësuarit të studentët në kontekst të bashkësisë."¹⁰³ Të mësuarit shërbyes është një lloj i të mësuarit nga përvoja dhe për këtë shkak, duhet tërësisht të integrohet në programet mësimore të bazuara në kompetenca. Duke pasur parasysh gjithë këtë, nevojitet që gjatë procesit të caktimit dhe ofrimit të përvojave arsimore nga tipi i të mësuarit shërbyes të ndiqen hapa të caktuar. Dimensionet themelore të gjithë

¹⁰¹ Ibid, fq. 12.

¹⁰² Ibid, fq. 13 – 20.

¹⁰³ Ibid, fq. 43.

këtij procesi janë: qëllimi i kursit, rezultate nga leximi dhe kompetencat e fituara. Hapat themelor nëpër të cilët realizohet ky proces janë:¹⁰⁴

- **Vlerësimi i nevojave** – paraqet proces sistemor të 1) grumbullimit dhe analizës së informatave me qëllim që të identifikohen dhe të renditen nevojat arsimore në pajtim me prioritetin e tyre dhe 2) identifikimi dhe matja e jazit mes kompetencave të tanishme dhe të dëshiruara. Vlerësimi i nevojave nuk bëhet që të shërbejë për vlerësimin e subjektit i cili mëson, por që të shërbejë për identifikimin e atyre gjërave/aspekteve të cilat mungojnë në praktikën në rrjedhë të ligjëratave dhe/ose për avancimin e mungesave të ardhshme të ndryshimeve në nevojat e bashkësisë. Në këtë mënyrë vlerësimi i nevojave bëhet hap i rëndësishëm në zhvillimin ose revizionin e programit mësimor. Gjatë kësaj, theks i vihet:
 - Qëllimit;
 - Popullatës të targetuar të cilës i dedikohet programi;
 - Çështjet që duhet të zgjidhen;
 - Resurset;
 - Procesi i grumbullimit të dhënave;
 - Procesi i analizës së të dhënave;
 - Caktimi i prioritetit të nevojave.

Informatat të cilat janë të nevojshme për përpunimin e vlerësimit të nevojave mund të fitohen nga burime të ndryshme: informata objektive (rezultatet nga testimi), informata subjektive (individë të cilët i theksojnë nevojat e tyre), informata nga ekspertë për nevoja normative (për shembull: këshilla arsimore, organizata profesionale për akreditim etj.) dhe burime tjera të ndryshme të cilat kanë të bëjnë me nevojat e grupeve në një nivel të krahasueshëm. Më shpesh përdoren veglat metodologjike që vijnë për zbatimin e vlerësimit të nevojave: anketa, fokus grupe, intervista, punë me persona kyç të cilët sigurojnë informata, teknika të mendimit krijues dhe vendosja sipas ‘stuhisë së ideve’ etj. Gjatë vërtetimit të nevojave individuale për të mësuar, metoda më efektive, krahas vlerësimit të bërë nga ana e ekspertëve, është vetë vlerësimi dhe vetë refleksioni, të cilat janë shkathësitë themelore për arritjen e procesit të mësuarit gjatë gjithë jetës.¹⁰⁵

- **Identifikimi i kompetencave** – Në thelb, kjo sjell deri te identifikimi i njohurive, shkathësitë dhe llojeve të sjelljes cilat janë të nevojshme për praktikën efektive në fusha të caktuara ose profesione.¹⁰⁶ Ekzistojnë dy qasje për definimin e termit kompetencë:
 - “Kompetenca është aftësi që të kryhet një detyrë pune në nivel që kënaq, e gjatë kësaj detyrat dhe kriteret për sukses të definojnë qartë;
 - Kompetenca definohet si koncept më i gjerë nga parapraket dhe përfshin: qëndrime intelektuale, konjiktive dhe dimensione të formimit të qëndrimeve, si dhe realizimi i detyrave të punës. Në këtë model, as kompetencat, as kriteret për sukses nuk janë identifikuar dhe definuar qartë.”¹⁰⁷

Kompetencat ngushtë janë të lidhura me qëllimet e të mësuarit. Studentët të cilët mësojnë në mjedis, të bazuara në kompetencat, nxiten të zhvillojnë qëllime të brendshme të mësuarit dhe të zhvillojnë një komplet të kompetencave, për të cilat mendojnë se u nevojiten ose mendojnë

¹⁰⁴ Hauer, Julie, and Timothy Quill, 2011, ‘Educational Needs Assessment, Development of Learning Objectives, and Choosing a Teaching Approach’, *Journal of Palliative Medicine*, Vol. 14, No. 4, fq. 503 – 507, fq. 503, 504.

¹⁰⁵ Ibid, fq. 504, 505.

¹⁰⁶ Seifer, S D., and K. Connors (Eds.), 2007, *Community Campus Partnerships for Health: Faculty Toolkit for Service Learning in Higher Education*, cit., fq. 42.

¹⁰⁷ Whitty, Geoff, and Elizabeth Willmott, 1991, ‘Competence-based Teacher Education: Approaches and Issues’, *Cambridge Journal of Education*, Vol. 21, Issue 3, gjendet në internet faqen e Academic Search Complete Database, Retrieved in HTML format on Jun 15, 2012.

se janë të dobishme për punën që e bëjnë. Që të und mjedisi për mësim të nxisë motivim të studentët, nevojitet ajo të jetë e organizuar në atë mënyrë që t'u përgjigjet interesave të studentëve dhe t'u shtrojë detyra relevante dhe që njihen lehtë. Kështu qëllimet e shtruara nxisin procese më të thella të mësuarit dhe me vetë aktivitetet konjunktive të thella dhe rezultate më të mira nga të mësuarit se sa qëllimet e jashtme të cilat janë orientuar drejt fitimit të diturisë së "pastër" (Ausubel, 1968; Kaldeway, 2006; Novak, 2002; Rozendaal, 2002).¹⁰⁸

- **Caktimi i qëllimeve në procesin e të mësuarit** – "Qëllimi i procesit të mësuarit definohet si rezultat përmes të cilit identifikohen dituria, shkathtësitë dhe raportet të cilat duhet t'i demonstrojnë subjektet që mësojnë. Qëllimet e procesit të mësuarit shfrytëzohen në kontekst të ndryshëm: ato e prezantojnë atë që personi i cili mëson është i aftë ta shprehë: pas përfundimit të mësimin nga lënda, pas një rotacioni ose pas një përvoje më afatgjatë.¹⁰⁹ Qëllimet e definuar në mënyrë kualitative të mësuarit sipas natyrës janë: specifike, të matshme, qartë të artikuluar dhe lehtë të kuptueshme për atë që mëson dhe për arsimtarin; ato janë lidhur me kompetencat të cilat janë specifike për një disiplinë dhe me standarde të cilat duhet të fitohen dhe të arrihen; ato janë fokusuar në nivelin e të mësuarit dhe më në fund, mund të klasifikohen në më shumë nivele.¹¹⁰

Shembull për parashtrimin e qëllimeve për lëndë konkrete që studiohet në Universitetin e shtetit Merilend¹¹¹

Përshkrimi i lëndës: Lënda dëgjohet në Departamentin për studime afro-amerikane (AASP 498E: Tema të zgjedhura nga kultura e popullatës zezake: përkatësia racore, përkatësia gjinore dhe identiteti) dhe të Departamentit për studime amerikane (AMST 418E: Tema nga fusha e kulturës së Amerikës: përkatësia racore, përkatësia gjinore dhe identiteti). Fokusi është mbi mënyrat e ndryshme ku përkatësia racore, gjinore dhe identiteti, bashkë me aspektet tjera të identitetit të personalitetit, ndikojnë dhe e formojnë jetën dhe përvojat e njerëzve të cilët jetojnë në SHBA.

Qëllimet e lëndës: Studentët i studiojnë raportet komplekse mes procesit të ndërtimit të identitetit personal, realitetit material ku jetojnë individët, mendimin kulturor dhe ideologjik dhe sistemin e vlerave, si dhe të institucioneve të shoqërisë. Studentët, gjithashtu, njoftohen edhe me mënyrat në të cilat bota materiale, rrethimi që e ka krijuar njeriu dhe veçanërisht mjediset urbane në të cilat jetojmë, ndikojnë mbi identitetet tona të shumëfishta, mbi të cilat ne ndikojmë me botën tonë materiale.

Metodat mësimore: Krahas udhëheqjes së ditarit ku i shkruajnë përvojat dhe përshtypjet e tyre, prezantimet në orë dhe pjesëmarrja aktive në orë, nga studentët të cilët e ndjekin lëndën kërkohet që të bëjnë hulumtim integral origjinal dhe të realizojnë ndonjë shërbim në bashkësi. Nga studentët kërkohet të realizojnë hulumtim dhe analizë nga fushat Greenbelt dhe Langston Terrace, të cilat janë dy bashkësi të krijuara lokale planifikuese. Në mënyrë burimore, Greenbelt ka qenë e planifikuar për familjet e të bardhëve, derisa Langston Terrace për popullatën zezake. Nga studentët pritet që të shkruajnë një punim ku do të analizohen lokalitetet dhe vendet, si dhe t'i prezantojnë gjetjet e tyre në pajtim me literaturën dhe materialet mësimore, sipas të cilave ligjërohet dhe studiohet kjo lëndë. Përmes ofrimit të shërbimit në bashkësi, studentët punojnë në bashkësi të cilët ata i studiojnë dhe hynë në interaksion me anëtarët e popullatës. Kjo u mundëson studentëve më mirë t'i kuptojnë raportet mes njerëzve dhe mjedisit material në të cilin jetojnë. Gjithashtu, studentët mund t'i hulumtojnë mënyrat e

¹⁰⁸ Koopman, Maaik, Peter Teune, and Douwe Beijaard, 2008, 'How to Investigate the Goal Orientations of Students in Competence-Based Pre-Vocational Secondary Education: Choosing the Right Instrument', *Evaluation and Research in Education*, Vol. 21, No. 4, fq. 318 – 334, fq. 319.

¹⁰⁹ Hauer, Julie, and Timothy Quill, 2011, 'Educational Needs Assessment, Development of Learning Objectives, and Choosing a Teaching Approach', cit., fq. 505.

¹¹⁰ According to Fink, L. D., 2003, *Creating Significant Learning Experiences: An Integrated Approach to Designing College Courses*, San Francisco: Jossey-Bass siç është prezantuar në ibid, fq. 506.

¹¹¹ Ky shembull është marrë në formën origjinale nga Commuter Affairs and Community Service, 1999, *Faculty Handbook for Service-Learning*, College Park, MD: University of Maryland, fq. 24. Materiali burimor i shkarkuar më 27 korrik 2002 nga:

http://www.snc.edu/sturzcenter/docs/UMD_service_learning_faculty_handbook.pdf.

ndryshimeve të cilat ata i iniciojnë, ndikojnë mbi vetë bashkësitë.

Qëllimet e ofrimit të shërbimit për bashkësinë: Nga studentët kërkohet ta aplikojnë njohurinë e fituar nga literatura, e cila përdoret për mësim dhe të mësuarit, nga diskutimet në orë dhe nga hulumtimet që vetë i kanë realizuar që të mund të promovohet ndonjë ndryshim në bashkësi, të cilat ata i studiojnë. Për shembull, studentët mund t'i nxisin banorët ta kuptojnë, ta njohin historinë e bashkësisë së tyre.

Mundësi të tjera: Duke marrë parasysh se kjo është lëndë ndër disiplinore, studentët do të duhej të dizajnojnë projekte, të cilat në vete inkorporojnë ekspertizë nga një spektër shumë i gjerë të disiplinave të ndryshme. Për shembull, studentët e arkitekturës mund të zgjedhin t'i dokumentojnë botimet të cilat kanë rëndësi kulturore-historike, derisa studentët të cilët studiojnë historinë e artit dhe konservim mund të zgjedhin t'i hulumtojnë, pastrojnë dhe konservojnë frizet e mureve në bashkësi. Për studentët të cilët e ndjekin mësimin e studimeve afro-amerikane, studimeve amerikane, antropologji, histori ose studime gjinore, një formë e mundshme e projekteve do të ishte zbatimi i intervistave me gojë për rëndësinë e hapësirës ose evidentimi kronologjik i zhvillimit historik të bashkësisë të dedikuar për pasurimin e koleksionit të librave në bibliotekën lokale publike.

“Pasiqë një herë do të definohen, rezultatet e pritura dh qëllimet e të mësuarit, pastaj shfrytëzohen për caktimin e elementeve tjera, si për shembull, përmbajtja e programit mësimor, strategjia e të mësuarit dhe ligjëratat, vlerësimi dhe evoluimi i personit që mëson, personi që e mëson dhe të efektivitetit të programit mësimor.”¹¹² Gjithashtu, ata paraqesin formular për planifikim të udhëzimeve lidhur me përgatitjen e lëndës dhe ndihmojnë në definimin e standardeve ose kriterëve për matjen e suksesit të procesit të mësuarit.¹¹³

- **Caktimi i metodave të ligjërimit** – Aplikimi eksplicit i metodave arsimore të cilat shërbejnë për fitimin më të lehtë të njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve, definohet në pajtim me qëllimet e të mësuarit. Aplikimi i një lloji të caktuar të metodave të ligjërimit varet nga madhësia e grupit dhe nga mjedisi ku zhvillohet mësimi për lëndën e dhënë. Nëse qëllimi i lëndës është zhvillimi i partneritetit të fuqishëm mes kuadrit akademik dhe atyre që mësojnë (siç është për shembull rasti me lëndët e të mësuarit shërbyes), atëherë subjektet në mësim mund të sjellin ose të fitojnë përvojë (siç është për shembull rasti me shkathtësitë për zgjidhjen e problemeve, vetëdijes, përvojës menaxheriale etj.) në mënyrë që njëkohësisht do t'i respektojë mundësitë për pjesëmarrje pozitive në procesin e të mësuarit të instruktorit/mësuesit, do ta respektojë qasjen fleksible nga ana e edukatorit dhe do të mbajë llogari për nevojat dhe problemet e bashkësisë.¹¹⁴
- **Caktimi i metodave të vlerësimit** – Një nga mënyrat e mundshme për vlerësimin e procesit nëpërmjet të cilit studentët mësojnë në kuadër të projekteve për të mësuarit shërbyes, është aplikimi i të ashtuquajturit DEAL model. Ky model paraqet mekanizëm për udhëheqje dhe evoluim kuantitativ të mendimeve kritike studentore në suaza të lëndëve me të mësuarit shërbyes përmes shfrytëzimit të rangimeve të jashtme për thellësinë e të mësuarit dhe për të menduarit kritik (Ash & Clayton, 2004; Ash, Clayton, & Atkinson, 2005; Ash, Clayton, & Day, 2005).¹¹⁵ Modeli bazohet në:

¹¹² Ibid, fq. 505.

¹¹³ Seifer, S D., and K. Connors (Eds.), 2007, *Community Campus Partnerships for Health: Faculty Toolkit for Service Learning in Higher Education*, cit., fq. 42.

¹¹⁴ Адаптирано од Hauer, Julie, and Timothy Quill, 2011, ‘Educational Needs Assessment, Development of Learning Objectives, and Choosing a Teaching Approach’, cit., fq. 506, 507.

¹¹⁵ Molee, Lenore M., Mary E. Henry, Valerie I. Sessa, and Erin R. McKinney-Prupis, 2010, ‘Assessing Learning in Service-Learning Courses through Critical Reflection’, *Journal of Experiential Education*, Vol. 33, No. 3, fq. 239 – 257, fq. 241.

- Punën teorike të Bloom (1956) i njohur për nga taksonomia e tij e qëllimeve arsimore (klasifikimi i nën qëllimeve arsimore)¹¹⁶, dhe
- Puna ekstensive e Paul dhe Elder (2002) në fushën e të menduarit kritik.

Modeli DEAL paraqet proces prej tre hapave ku studentët lëvizin nga:

- “Përshkrimi (**Describing**) i përvojës së tij në fushën e të mësuarit shërbyes, përmes
- Studimi (**Examining**) i kësaj përvoje të tyre përmes analizës së qëllimeve specifike të mësuarit për arritjen e përmirësimit akademik, rritjen personale dhe aktivitetit qytetare, deri te
- Artikulimi (**Articulating**) i të mësuarit të tyre (**Learning**) në të menduarit e tyre (Ash & Clayton, 2004; Ash, Clayton, & Moses, 2007; Jameson et al., 2008).

Modeli i përfshin të gjitha ndryshimet e të mësuarit dhe ligjëratave, si dhe ndryshimet të cilat ndodhin kur studentët involvohen në proces kofra-normativ të mësuarit përmes lidhjes së të[mësuarit akademik dhe shërbimit në bashkësi përmes aktivitetit mendor (Clayton & Ash, 2004).”¹¹⁷

- **Caktimi i metodave për avancimin e programit për të mësuarit shërbyes** – Qëllimi i përdorimit të këtyre metodave është ofrimi i edukimit të vërtetë efikas, që do të jetë në dobi të studentëve dhe të ligjëruesve/profesorëve dhe njëkohësisht, do të ketë dobi nga zhvillimi i kuadrit mësimor. Zhvillimi efektiv i kuadrit mësimor është mjaft i rëndësishëm për avancimin e programit për të mësuarit shërbyes. Me rëndësi të madhe për zhvillimin e kuadrit mësimor është: të ofrohen informata kthyes, të ekzistojnë raporte efektive ndër kolegiale, të bëhen intervenime mirë të dizajnuara, të cilat do t’i respektojnë parimet e të mësuarit dhe ligjëratave, të shfrytëzohen metoda të ndryshme edukative në kuadër të intervenimeve të caktuara etj.

Secili nga hapat e lartpërmendur në zhvillimin dhe revizionin e një programi të mësuarit shërbyes është i domosdoshëm për mbylljen e jazit në kualitetin e shërbimit që një program ua ofron bashkësisë dhe të gjithë aktorëve të kyçur. Programet për të mësuarit shërbyes janë efikase vetëm nëse procesi i nevojave shfrytëzohet në krijimin e qëllimeve të mësuarit. Nga ana tjetër, qëllimet e të mësuarit janë lidhur me rezultatet nga të mësuarit, metodat e të mësuarit dhe vlerësimi i natyre që mësojnë, të edukatorëve dhe programit në përgjithësi.¹¹⁸

Hapat në krijimin e rezultateve të mësuarit dhe kompetencat në kurs për të mësuarit shërbyes përfshijnë:

- Revizion i kompetencave për disiplinën ose profesionin specifik, si dhe cilësdo kompetencë që sektori ose programi mësimor i ka etabluar tashmë;
- Pjesëmarrja e partnerëve të bashkësisë në diskutime për pritjet e tyre lidhur me rezultatet nga të mësuarit;
- Pjesëmarrja e kuadrit akademik dhe studentëve në diskutime për pritjet e tyre lidhur me rezultatet nga të mësuarit;
- Krijimi i qëllimeve për të mësuar dhe shërbimi lidhur me kursin;
- Identifikimi i detyrave, ose kompetencave të cilat studentët pritet t’i kryejnë pas përfundimit të suksesshëm të kursit;
- Identifikimi i subjekteve të cilat studentët më së shumti i mësojnë me qëllim që t’i kryejnë detyrat e dhëna;

¹¹⁶ DeMers, Michael N., 2009, ‘Using Intended Learning Objectives to Assess Curriculum Materials: The UCGIS Body of Knowledge’, *Journal of Geography in Higher Education*, Vol. 33, Supplement 1, fq. S70 – S77, fq. S71 – S73.

¹¹⁷ Ibid, fq. 241.

¹¹⁸ Hauer, Julie, and Timothy Quill, 2011, ‘Educational Needs Assessment, Development of Learning Objectives, and Choosing a Teaching Approach’, cit., fq. 507.

- Caktimi i masave për vlerësim të rezultateve nga të mësuarit e studentëve;
- Përgatitja për identifikim të metodologjive për ligjërata dhe mënyrën mëtejshme të dizajnit të kursit për të mësuarit shërbyes.¹¹⁹

Të përmbledhim: Lista e hapave ose kompetentëve të cilët kanë rëndësi të madhe për caktimin e rezultateve të studentëve i arrijnë dhe kompetencat të cilat i fitojnë në kuadër të cilësdo lëndë nga të mësuarit shërbyes, përfshijnë:

- Revizioni i kompetencave për disiplinën ose profesionin konkret, si dhe revizioni i cilësdo kompetencë, që departamenti ose programi përkatës për fitimin e titullit shkencor e ka caktuar paraprakisht;
- Angazhimi i partnerëve nga bashkësia në diskutimet për pritjet e tyre lidhur me rezultatet nga procesi i të mësuarit të studentëve;
- Angazhimi i kuadrit mësimor dhe studentëve në diskutimet për pritjet e tyre lidhur me rezultatet nga procesi i të mësuarit;
- Caktimi i qëllimeve të lëndës të cilat kanë të bëjnë me procesin e të mësuarit, nga njëra anë dhe ofrimi i shërbimit për bashkësinë, nga ana tjetër;
- Identifikimi i detyrave të punës ose kompetencave, për të cilat pritet se studentët do t'i realizojnë dhe do t'i fitojnë pas përfundimit të suksesshëm të mësimit dhe dhënien e provimit;
- Identifikimi i asaj që studentët duhet ta mësojnë që të mund t'i kryejnë detyrat e punës;
- Caktimi i masave për vlerësim të rezultateve nga procesi i të mësuarit;
- Përgatitja për identifikimin e metodologjive të punës mësimore dhe mënyrave për avancimin mëtejshëm të dizajnit të lëndës me të mësuarit shërbyes.¹²⁰

Planifikimi i udhëzimeve dhe aktiviteteve në kuadër të lëndës

Plani për përbërjen e udhëzimeve për lëndën dhe për aktivitetet nëpër të cilat ai realizohet paraqet 'udhë rrëfim' për gjithë atë që studentët duhet ta mësojnë dhe për atë si procesi i të mësuarit duhet të bëhet efektiv gjatë vetë mësimit. Proces i planifikimit gjithnjë do të duhet të llogaritet si ngushtë i lidhur me njohjen e qëllimeve për të mësuar dhe me strategjitë për marrjen e informatave kthyesë lidhur me atë se si studentët mësojnë.¹²¹ Në të vërtetë, planifikimi paraqet pjesë e rëndësishme nga triada e fazave të procesit të dizajnit të lëndës që përfshinë:

1. Njohja e rezultateve të dëshiruara – QËLLIMET (qëllime lidhur me përmbajtjen, qëllime lidhur me shkathësitë ose në rastin konkret me lëndët/projektet lidhur me të mësuarit shërbyes, qëllime për procesin e të mësuarit dhe qëllime lidhur me shërbimin që i ofrohet bashkësisë);
2. Caktimi i dëshirave të pranueshme – PROGRESI (vlerësimi i aftësisë që t'i arrijnë qëllimet për procesin e të mësuarit);
3. Planifikimi i përvojave të cilat dalin nga të mësuarit dhe të udhëzimeve për lëndën – PRAKTIKA (planifikimi i aktiviteteve për të mësuar me çka mbështeten qëllimet e lëndës për vetë procesin e të mësuarit).¹²²

Në rastin e të mësuarit shërbyes, planifikimi i udhëzimeve për lëndët dhe aktivitetet është e lidhur ngushtë me:¹²³

¹¹⁹ Seifer, S D., and K. Connors (Eds.), 2007, *Community Campus Partnerships for Health: Faculty Toolkit for Service Learning in Higher Education*, cit., fq. 43 – 45, 50.

¹²⁰ Seifer, Sarena D., and Kara Connors (Eds.), 2007, *Community Campus Partnerships for Health: Faculty Toolkit for Service Learning in Higher Education*, cit., fq. 43 – 45, 50.

¹²¹ Milkova, Stiliana, *Strategies for Effective Lesson Planning*, Center for Research on Learning and Teaching, University of Michigan, Last retrieved on July 27, 2012 from http://www.crlt.umich.edu/gsis/P2_5.php.

¹²² Center for Teaching, *Course Design*, Vanderbilt University, E shkarkuar nga <http://cft.vanderbilt.edu/teaching-guides/preparing-to-teach/course-design/> më 27 korrik 2012.

- **Njohja e komponentëve kyç të orëve të mësimit pas të mësuarit shërbyes** – Bëhet fjalë për elemente sipas të cilave lëndët me të mësuarit shërbyes dallohen nga zhvillimi tradicional i mësimit. Këtu marrin pjesë:
 - Ligjëratë e një pjese të programit mësues jashtë nga shkolla dhe në kuadër të bashkësisë;
 - Shkallë më e lartë e kompleksitetit nga aspekti i numrit të stejkholderëve, të cilët janë të involvuar edhe nga aspekti i kualitetit, harmonizimi dhe natyra e transferimit të diturisë dhe ndërtimi i kompetencave;
 - Qëllime të shumëfishta të cilat duhet të përcaktohen me kujdes, që të mund ta reflektojnë ‘vlerën e përzier’, e cila duhet të krijohet me programet e të mësuarit shërbyes;
 - Komponentë unike dhe e kuptimësuar, e qëllimshme e refleksionit;
 - Shkallë më e lartë e strukturimit në krahasim me lëndët tradicionale.¹²⁴
- **Caktimi i elementeve kritike të silabusit (programit) të lëndëve me të mësuarit shërbyes ose revidimi i tyre** – Qëllimi është të caktohen pritje, por gjithashtu edhe të sqarohet roli kyç që të mësuarit shërbyes mund ta luajë në procesin e përgjithshëm arsimor. “Sipas Heffernan (2001), silabusë (programet) mjaft kualitative për të mësuarit shërbyes që mund të shërbejnë si shembull:
 - Në mënyrë eksplicite theksojnë se të mësuarit shërbyes shfrytëzohet si një nga strategjitë e shumta të mundshme për mbajtjen e mësimit nga lënda përkatëse dhe për të mësuar;
 - E përcaktojnë qartë të mësuarit shërbyes dhe e përkufizojnë nga llojet tjera të përvojave që fitohen përmes angazhimit në bashkësi, siç është për shembull, puna vullnetare;
 - I deklaron qëllimet për të mësuarit, të cilat duhet të arrihen përmes përvojës me ofrimin e shërbimit për bashkësinë;
 - E përshkruajnë natyrën e shërbimit dhe/ose projektit;
 - I definojnë nevojat të cilat plotësohen me shërbimin e kryer;
 - I specifikon rolet dhe përgjegjësitë e studentëve në procesin e caktimit për kryerjen e shërbimit dhe/ose gjatë projektit, me të cilin i ofrohet shërim bashkësisë (për shembull, transporti, koha e nevojshme për realizim, kontaktet me dhe në kuadër të bashkësisë etj.);
 - Specifikojnë si pritet nga studentët të tregojnë çfarë kanë mësuar me caktimin të ofrojnë shërbim në bashkësi, gjegjësisht me pjesëmarrjen në projekt për të mësuarit shërbyes (mbajtja e ditarit, shkrimi i punimeve, mbajtja e prezantimeve);
 - Përcaktojnë çfarë paraqet refleksioni ose hulumtimi kritik, si dhe prej çfarë përbëhet refleksioni kualitativ;
 - Prezantojnë detyra pune për reflektimin që e lidh përvojën nga ofrimi i shërbimit me përmbajtjen mësimore;
 - Në mënyrë të qartë caktojnë se si do të vlerësohen dhe/ose evoluohet detyrat e punës me refleksion.”¹²⁵
- **Kuptimi i rolit dhe refleksionit gjatë lidhjes së të mësuarit dhe kryerjes së shërbimit** – Në kapitullin e mëparshëm u sqarua roli i refleksionit. Këtu do të kishim dashur të fokusohemi më shumë në karakteristikat e procesit të refleksionit, që kontribuojnë ai të jetë efektiv në lidhjen

¹²³ Seifer, Sarena D., and Kara Connors (Eds.), 2007, *Community Campus Partnerships for Health: Faculty Toolkit for Service Learning in Higher Education*, cit., fq. 69.

¹²⁴ Ibid, fq. 69, 70.

¹²⁵ Heffernan, Kerissa, 2001, *Fundamentals of Service-Learning Course Construction*, Providence, RI: Campus Compact as cited in Office of Service-Learning, 2008, *Syllabus Template for Classes with Service-Learning Components*, Duquesne University. Shkarkuar nga www.duq.edu/core-curriculum/_pdf/syllabus-sl.doc më 27 korrik 2012; Bringle, Robert G., and Julie A. Hatcher, 1999, ‘Reflection in Service Learning: Making Meaning of Experience’, *Educational Horizons*, Summer 1999, fq. 111 – 117, fq. 114. Shkarkuar nga http://www.westmont.edu/_offices/provost/documents/Curriculum/GE/Workshops/2007%20Service%20Learnin%20Workshop/S-L%20Workshop-%20Reflection%20in%20Service%20Learning.pdf më 28 korrik 2012.

e përvojës nga ofrimi i shërbimit dhe procesin e të mësuarit dhe në vlerësimin e vetë refleksionit. Sipas Kerri Ribek (2000) dhe Bringle and Hatcher (1999), refleksioni efektiv:

- o paraqet aktivitetet të strukturuar, të udhëhequr dhe i orientuar drejt qëllimeve – ai është i strukturuar nga aspekti i përshkrimit, pritjeve dhe kriterëve për vlerësim të aktivitetit;
- o rregullisht ndodh që gjatë semestrit studentët të mund të ushtrojnë që t'i shprehin mendimet e tyre (të reflektojnë) dhe ta zhvillojnë aftësinë që të inkuadrohen në një refleksion më të thellë dhe më të gjerë;
- o i lidh qëllimet dhe shërbimin dhe qëllimet e lëndës d.m.th. e lidh përvojën nga ofrimi i shërbimit me përmbajtjet mësimore dhe qëllimet e të mësuarit;
- o përfshinë si të menduarit e individëve, ashtu edhe të opinionit më të gjerë dhe ofron informatë kthyesë për ligjëruesin lidhur me disa aktivitete të refleksionit;
- o nxitë drejt përgjegjësisë qytetare dhe vlerësimit/pranimin e dallimeve;
- o e inkuadron mundësinë që studentët t'i hulumtojnë, sqarojnë dhe ndryshojnë vlerat e tyre.¹²⁶

Në shkrimin e njëjtë nga viti 1999, Bringle dhe Hatcher e theksojnë rëndësinë e vlerësimit të shkallës së lehtësisë, me të cilën studentët inkuadrohen në procesin e refleksionit dhe në atë se sa shpejtë piqet aftësia e tyre të mësojnë diçka nga refleksioni. Bringle dhe Hatcher në të vërtetë prezantojnë një komplet të kriterëve për vlerësim të refleksionit të tyre që e ka zhvilluar Bradley (1995). “Nëse këto kritere u prezantohen studentëve para fillimit të aktiviteteve të refleksionit, atëherë mund të ketë ndihmë të madhe në formimin e pritjeve lidhur me zhvillimin e tyre personal, si persona të cilët mësojnë përmes refleksionit. Nga studentët, gjithashtu, mund të kërkohet t'i vlerësojnë mendimet, refleksionet e tyre, duke i aplikuar këto kritere para vetë ligjëruesit që t'i vlerësojë. Ushtrimi i këtillë studentëve u ofron mundësi për vetë evoluim, si dhe mundësi që të krahasohen notat nga studenti dhe notat që i ka dhënë ligjëruesi.”¹²⁷

- **Njohja e strategjive për nxitjen e refleksionit dhe të menduarit kritik** – Ekzistojnë qasje dhe metoda të shumta inovative për strukturimin e aktiviteteve lidhur me refleksionin të cilat janë formale dhe joformale. Për shembull, mund të reflektohet, mendohet në një temë të dhënë përmes: 1) *udhëheqja e ditarit* (ditar i shprehjeve kyçe, termeve; ditar ku dyfish shënohen përshtypjet dhe ndodhitë; ditar ku evidentohen ngjarjet kritike; ditar prej tre pjesëve; të shkruarit e orientuar etj.); 2) *punim hulumtues i cili bazohet në përvoja*; 3) *analiza etike dhe raste*; 4) *të lexuarit e orientuar dhe përpunimi i materialeve*; 5) *detyra të orientuara për shkrim*; 6) *prezantime në orë*; 7) *reflektimi me anë të postës elektronike*; 8) *‘rrëfimi digjital i tregimeve’, ‘rrëfimi i tregimeve’ udhëheqja e ditarit me fotografi ose prezantim vizual i shkrimeve*; 9) *dialog në grup* (sy më sy ose me anë të rrugës elektronike); 10) *provimet* etj. Pa marrë parasysh në çfarë forme do të realizohet, “e rëndësishme për çdo detyrë lidhur me refleksionin është të paraqesë sfidë për studentët, të bazohet në ndonjë përvojë konkrete, që kërkon mendim kritik dhe të nxitë interesim të mëtejshëm për të mësuar”¹²⁸
- **Njohja e obligimeve të cilat studentët dhe partnerët nga bashkësia duhet t'i plotësojnë gjatë zhvillimit të programit mësimor ku është integruar të mësuarit shërbyes** – Programi mësimor, ku është integruar të mësuarit shërbyes, do të duhej të planifikohet në një mënyrë integruese, mu për atë se qasja e këtillë ndihmon të sigurohet se kërkesat e të gjithë partnerëve do të plotësohen, realizimi i përmbajtjeve mësimore do të jetë efikas nga aspekti i kohës dhe

¹²⁶ Ribek, Kerri, 2000, *A Faculty Manual for Integrating Service-Learning in Health Education* as cited in Seifer, Sarena D., and Kara Connors (Eds.), 2007, *Community Campus Partnerships for Health: Faculty Toolkit for Service Learning in Higher Education*, cit., fq. 85.

¹²⁷ Bringle, Robert G., and Julie A. Hatcher, 1999, ‘Reflection in Service Learning: Making Meaning of Experience’, cit., fq. 114.

¹²⁸ Seifer, Sarena D., and Kara Connors (Eds.), 2007, *Community Campus Partnerships for Health: Faculty Toolkit for Service Learning in Higher Education*, cit., fq. 73.

qëllimet do të harmonizohen. Në të vërtetë, kualiteti dhe rezultatet të cilat fitohen me planin mësimor ku është integruar të mësuarit shërbyes varet nga ekzistimi i partneritetit të thellë dhe thelbësor në bashkësi dhe me bashkësinë në të cilën:

- Institucionet të cilat janë involvuar në partneritet shmangen të veprojnë në mënyrë të paanshme kur shprehen ose kanë prezantim në opinion;
- Ekzistojnë vizita të përbashkëta në vendngjarje që të afrohen mjediset akademike dhe bashkësia dhe të detyrohen të gjejnë ‘gjuhë të përbashkët’;
- Duhet të jepen propozime lidhur me mënyrat si partnerët nga bashkësia t’i plotësojnë diskutimet e vetë formimit;
- Përmes punës së përbashkët duhet të vendosen pritje të qarta lidhur me rolet, aktivitetet, përgjegjësitë dhe llogaridhënien e të gjitha palëve të involvuara;
- Nevojat e bashkësisë dhe përmbajtjet programore nuk duhet të caktohen në mënyrë unilaterale;
- Me kujdes dhe në bazë afatgjate ndërtohet besimi dhe marrëdhëniet e ndërsjella.¹²⁹

Sa i përket procesit të planifikimit të lëndës ku është inkorporuar të mësuarit shërbyes, ndërsa i cili duhet të përgjigjet në pyetjet me të cilat ballafaqohet bashkësia dhe t’i shprehë rezultatet e dëshiruara nga vetë lënda mësimore, mendojmë se, që të mund të arrihet optimalja në arritjen e qëllimeve, të cilat anëtarët e partneritetit i kanë identifikuar si ekzistuese në bashkësi, nevojitet të ndërmerren hapat që vijnë.¹³⁰

- Caktimi i qëllimeve për të mësuar dhe kompetencat;
- Të caktohet nëse lënda e zgjedhur është adekuate nga aspekti i arritjes së qëllimeve të veta në kuadër të bashkësisë;
- Definimi i përvojës nga të mësuarit shërbyes;
- Zgjedhja e llojeve të emërimit për pjesëmarrje në forma të mësuarit shërbyes, projekte ose aktivitete të cilat e ndihmojnë realizimin e shërbimit dhe arritjen e qëllimeve lidhur me procesin e të mësuarit;
- Zgjedhja e strukturës dhe kërkesa të cilat janë adekuate për kompetencën e shërbimit dhe kompetencën e të mësuarit;
- Caktimi i qasjes për vlerësim të punës së studentëve;
- Zgjedhja e qasjes për ndihmën e procesit të mësuarit të studentët;
- Inkorporimi i aktiviteteve të rëndësishme të refleksioni;
- Caktimi i nivelit adekuat të ngarkesës së studentëve me detyra pune nga lënda e caktuar;
- Zhvillimi i lëndëve të strukturuar mësimore, të cilat janë bazuar në projekte të kaluara ose në rrjedhë e sipër, ku studenti ofron shërbim;
- Shqyrtimi i strategjive të ndryshme për vazhdimin e partneritetit dhe aktiviteteve nga lënda gjatë pushimeve;
- Identifikimi i mundësive për orientim të studentëve dhe bashkësisë drejt të mësuarit shërbyes;
- Identifikimi i mundësive për përgatitje të partnerëve nga bashkësia për rolin e tyre si ligjërues dhe mbikëqyrës të punës së studentëve;
- Identifikimi i strategjive adekuate për evoluim të lëndëve;
- Sigurimi i kohës së nevojshme, kuadrit adekuat dhe ekspertizës, si dhe ambienteve brenda dhe jashtë institucionit akademik;
- Caktimi i nivelit të realizimit të lëndës nga aspekti i pritjeve të bashkësisë;
- Sigurimi i përshtatshmërisë së lëndës nga aspekti i asaj se si studentët e mësojnë përmbajtjen e asaj lënde;
- Sigurimi se lënda në vete inkorporon çështje me karakter qytetar/publik për zgjidhjen e të cilit do të mund të ndihmojnë vetë aktivitetet e bazuara në bashkësi;

¹²⁹ Ibid, fq. 71.

¹³⁰ Hapat janë marrë burimisht nga ibid, fq. 74 – 79.

- Sigurimi i zhvillimit të shkathtësive të studentëve për të menduarit kritik gjatë mësimit nga lënda përkatëse;
- Identifikimi i mundësive për të mësuarit interdisiplinar ose multidisiplinar mes kuadrit mësues, studentëve dhe liderëve në bashkësi;
- Mundësimi që lënda e cila mësohet nga studentët, t'u ndihmojë ta zhvillojnë tolerancën dhe pranimin e dallimeve të ndërsjella;
- Sigurimi se lënda që studiohet nga studentët mund të ndihmojë të shqyrtohen përparësitë, anët e fuqishme të bashkësisë, mjetet me të cilat ajo disponon, si dhe nevojat e saja;
- Identifikimi i mundësive thelbësore për studentët dhe partnerët nga bashkësia të involvohen në zhvillimin e lëndës dhe aktivitetet ose të ndihmojnë gjatë mësimit në atë mënyrë që do t'i 'huazojnë' shkathtësitë e tyre arsimore;
- Zhvillimi i mundësive në kuadër të vetë lëndës për involvimin e studentëve dhe partnerëve nga bashkësia në planifikimin dhe implementimin e aktiviteteve në bashkësi;
- Caktimi i kornizës kohore për vendosjen dhe fillimin me mësime nga lënda e caktuar, e cila inkorporon të mësuarit shërbyes me qëllim që çdo vjet të avancohet.

Aspektet e rëndësishme të këtij procesi janë:

- Ndryshim në lëndën mësimore e cila dëshirohet të arrihet;
- Mënyra të mundshme përmes të cilave të mësuarit shërbyes mund/do të ndikojë në rezultatet që do t'i arrijnë studentët nga të mësuarit dhe bashkësia;
- Ndryshimi i roleve të kuadrit mësues të cilët e udhëheqin mësimin nga lënda përkatëse;
- Aktivitete të mundshme lidhur me lëndën, me të cilat shqyrtohen çështjet nga fsha e kulturës ose disparitetet;
- Aktivitete të planifikimit faktik dhe vlerësimi, të cilat janë pjesë nga lënda dhe efektiviteti i tyre;
- Rolet të cilat u janë besuar studentëve, bashkësisë dhe liderëve mes kuadrit mësues në fakultete;
- Evoluimi i lëndës dhe aktivitetet e planifikimit – të përmbajtjes dhe zhvillimi i këtyre lëndëve bëhet pasurimi i tyre për disa lëndë të ardhshme të mundshme;
- Transferimi dhe shpërndarja e të dhënave për evoluimin e lëndës dhe aktiviteteve të planifikimit.¹³¹

Me qëllim që ta afrojmë procesin faktik të planifikimit të udhëzimeve dhe aktiviteteve për lëndën ku është inkorporuar të mësuarit shërbyes, në vazhdim do të prezantojmë një analizë të rastit, të fokusuar në aspektet të cilat janë kyçe për këtë proces. Rasti është marrë në formë integrale nga origjinali nga *Community Campus Partnerships for Health: Faculty Toolkit for Service Learning in Higher Education*.¹³²

¹³¹ Ibid, fq. 79.

¹³² Ibid, fq. 79 – 80.

Analiza e rastit: Hulumtimi participativ i bazuar në bashkësi- rasti me projektin në Baltimor për qasjen deri te shërbimet sociale për personat në pozitë të palakueshme materiale

Prapaskena e rastit:

Studentët e mjekësisë në programin shërbyes të Fondacionit Soros për praktika verore në fushën e shëndetit publik kanë marrë si detyrë të zbatojnë projekt të bazuar në bashkësi, me të cilin do të avancohet procesi arsimor, hulumtues dhe vetë shërbimi të cilin e ofrojnë studentët. Për programin për praktikumin në verën e vitit 2001, konzorciumi dhe organizatat e bazuara në bashkësi, të cilat duhej të pranojnë studentë, kanë vendosur të realizojnë studim për vlerësimin e nevojave dhe anketë për qasjen deri te mbrojtja shëndetësore në tetë lokacionet e tyre. Qëllimi i këtij projekti ka qenë: 1) të shfrytëzohet anketa për identifikimin e nevojave dhe çështjeve të përbashkëta, me të cilat ballafaqohen institucionet të cilat ofrojnë strehim (strehë për të pastrehuarit, shtëpi publike, institucione shëndetësore në nivel të bashkësisë, qendra ditore dhe strehimor); 2) të përdoret ky projekt për promovimin e avokimit kolektiv të interesave të grupeve në vend që të zgjidhen probleme/raste/çështje kontestuese të fragmentuara ose të izoluar; dhe 3) të 'hartohen' (pasqyrohen) çështjet dhe nevojat të cilat janë specifike për çdo organizatë individualisht, dhe të cilat do të mund të ishin prej dobie kur organizata përkatëse do të nisë iniciativë për kërkimin e sponsorimeve dhe ndihmës tjetër financiare, si dhe gjatë evoluimeve të brendshme. Rezultatet nga ky hulumtim janë përmbledhur në një raport gjithëpërfshirës për qasjen e shërbimeve dhe nevojat e pakënaqshme në qytetin e Baltimorit (www.soros.org/baltimore/assets/2001_access_report.htm).

Përshkrimi i projektit:

Vetë projekti përbëhej prej tre fazave: (1) përpilimi i pyetësorit anketues; (2) grumbullimi dhe analiza e informacioneve, dhe (3) disemenimi i gjetjeve nga hulumtimi. Konzorciumi ka përpiluar pyetësor të standardizuar, në të cilin është përfshirë mundësia që çdo grup nga bashkësia të jap pyetje specifike të cilat janë unike për organizatën e tyre ose për popullatën e klientëve të tyre. Që të qaset në mënyrë konsistence dhe efektive drejt anketimit, studentët të cilët janë caktuar të punojnë në secilën prej lokacioneve në bashkësi gjatë asaj vere, janë trajnuar nga ana e personelit të fondacionit, për atë se si duhet të realizohet anketimi dhe kanë punuar nën mbikëqyrjen e mentorit nga bashkësia. Anketimi ka qenë anonim dhe pasi ka përfunduar hulumtimi, pyetësorët janë dërguar në fondacion që të futen në bazën e të dhënave për analizë të mëtejshme. Deri te konzorciumi i organizatave nga bashkësia përmes formës elektronike kanë qarkulluar apejtime të përkohshme të dhënave përshkruese që të fitohen komente kthyes dhe interpretime. Raporti përfundimtar dhe rekomandimet kanë qenë të kapshme para se të publikohet raporti. Gjatë dy javëve të fundit nga puna praktike, studentët kanë marrë pjesë në punëtori për trajnim për shfrytëzimin e mediave si përgatitje për pres konferencën e caktuar, ku do të prezantoheshin rezultatet. Raporti me gjetjet nga hulumtimi që është zbatuar në lokacione konkrete është dërguar deri te secili prej këtyre lokacioneve ku kanë punuar praktikantët. Ky raport është përgatitur nga ana e vetë studentëve si pjesë e projektit të tyre final.

Rezultatet:

Secili student ka realizuar mes 20 dhe 30 intervista sa ka zgjatur praktika, ndërsa janë bërë gjithsej 225 anketa. Në raportin përfundimtar janë identifikuar komorbiditete të shumta dhe të rëndësishme mjekësore dhe komorbiditete të shëndetit mendor, si dhe nevoja të shumta për shërbim mes të anketuarve, është përshkruar si rol kritik që e luan sistemi i institucioneve që formojnë 'rrjet të sigurisë' për personat në pozitë të palakueshme materiale dhe sociale, që të mbahen këta njerëz në jetë dhe të mund të funksionojnë, ndërsa gjithashtu janë prezantuar edhe disa nga sfidat me të cilat ballafaqohen këto grupe në pikëpamje të sigurimit të mjeteve financiare. Konferenca për shtyp ku u prezantuan gjetjet nga studimi, është emetuar në programin e tre stacioneve lokale televizive, ndërsa në nivel nacional është emetuar vetëm në rrjetin e NPR dhe Associated Press. Përveç kësaj, më vonë gjatë verës rezultatet nga hulumtimi janë shfrytëzuar gjatë dëshmisë në Kongres lidhur me masat e propozuara ligjore nga kjo sferë.

Zgjedhja e teksteve dhe resurseve tjera për të mësuar

Resurset për të mësuar, të cilat shpeshherë quhen edhe “media”, janë pjesa thelbësore nga zhvillimi historik i të mësuarit shërbyes. Varësisht nga qëllimi i dëshiruar ose nga forma e ligjërimit të kursit, mund të shfrytëzohen media të ndryshme dhe atë në mënyra të ndryshme. Pritet që tekstet dhe resurset tjera për të mësuar të zgjidhen në mënyrë të aspekteve të ndryshme dhe multi disiplinore, me qëllim që dukshëm ta mbështesin zhvillimin e kursit. Hapat të cilat aplikohen në seleksionimin e tyre përfshijnë:

- Vendosja e kompetencave dhe qëllimeve për të mësuar;
- Caktimi i qëllimit dhe dedikimit të resurseve për të mësuar ose mediave, me qëllim që të forcohen kompetencat dhe qëllimet e të mësuarit, si dhe të përmirësohet formati i ligjërimit aplikohet në kuadër të lëndës;
- Zgjedhja e llojeve të ndryshme të mediave, të cilat shfrytëzohen gjatë mësimit nga lënda përkatëse (kompjuteri, videoja, audio prezantimet, ligjërues ose vegla tjera interaktive), mënyra në të cilat do të aplikohen ato, shkalla deri te cila mediat do t'i ndajnë stilet e ndryshme të mësuarit të studentëve, si dhe zgjedhja e paletës së stileve të ndryshme të mësuarit;
- Identifikimi i resurseve krijuese për të mësuar dhe teksteve në kuptimin më të gjerë. Materialet duhet të jenë nga disiplina të ndryshme dhe të përfshijnë më shumë perspektiva dhe qasje të ndryshme;
- Aplikimi i teknologjisë ekzistuese që të nxitet të mësuarit (për shembull, grupet elektronike për diskutim);
- Formulimi i qartë i roleve të reja të studentëve dhe partnerëve nga bashkësia.¹³³

Dizajni i evoluimeve të lëndës dhe planet për avancimin e tij

Në këtë publikim shpeshherë e potencuam rëndësinë e përvojës së rëndësishme nga të mësuarit. Kjo për shkak se mendonim se mes individëve dhe studentëve të inkuadruar në arsimin sipëror ekziston nevojë e padyshimtë dhe e përhershme për disa lloje të ndryshme të rëndësishme të mësuarit, siç janë: të mësuarit si të mësohet, mësimi për fitimin e shkathtësive lider, mësimi për marrëdhëniet ndër njerëzore, morali, mësimi për fitimin e shkathtësive komunikuese, aftësia për ndërrimin dhe përshtatjen drejt ndryshimit etj. Ky ‘trend’ në të vërtetë e zbulon nevojën që të pranohet dhe të miratohet një qasje e re drejt të mësuarit, që të mësuarit e definojnë nga aspekti i ndryshimit – ndonjë formë e ndryshimit të vazhdueshëm në jetë të atij që mëson.

Dee Fink (2003) ofron taksonomi të re të mësuarit të rëndësishëm, thelbësor:¹³⁴

- **Të mësuarit themelor** – Njohuri ose njohja që ka të bëjë me aftësinë e studentëve të kuptojnë dhe të mbajnë mend informata dhe ide specifike. Kjo mundëson të kuptuarit themelor që është e domosdoshme për llojet tjera të mësuarit.
- **Aplikimi** – Të mësuarit si të 1) inkuadroheni në aktivitete intelektuale, fizike ose shoqërore; 2) inkuadroheni në lloje të ndryshme të mësuarit (kritik, krijues, të mësuarit praktik); 3) zhvillonin shkathtësi të caktuara; ose 4) të udhëheqin projekte të ndërlikuara. Ky tip i të mësuarit mundëson llojet tjera të mësuarit të bëhen të *dobishme*.

¹³³ Ibid, fq. 94 – 96.

¹³⁴ Dee Fink, L., 2003, *Creating Significant Learning Experience: An Integrated Approach to Designing College Courses*, San Francisco, CA: Jossey-Bass, A John Wiley & Sons, Inc. Imprint, fq. 29 – 33. Ky libër Këshillat amerikane për arsimin ndërkombëtar adhuruan të gjithë pjesëmarrësve në Junior Faculty Development Program pas përfundimit të suksesshëm të programit në vitin.

- **Integrimi** – Të mësuarit t’i shqyrtoni dhe t’i kuptoni lidhjet mes gjërave të ndryshme – idetë konkrete, numër i madh i ideve, njerëz ose fusha të ndryshme nga jeta. Kjo në të vërtetë është akt i krijimit të lidhjeve të reja përmes të cilave personat që mësojnë fitojnë formë të re të fuqisë.
- **Dimensionin human** – Të mësuarit për veten dhe për tjerët që i mundëson individëve në mënyrë më efektive të funksionojnë dhe të përgjithësohen. Kjo studentëve u jep pasqyrë të re për veten (kuptimi për veten) dhe/ose ideal për veten (vizion për atë çfarë dëshirojnë të bëhen). Kjo formë e të mësuarit i ‘informon’, gjegjësisht ‘mëson’ studentët për *rëndësinë e asaj që është mësuar për vetë njeriun*.
- **Kujdesi** – Proces i të mësuarit përmes së cilit studentët formojnë ndjenja të reja, interesa ose vlera dhe fillojnë të kujdesen për të tjerët më shumë ose të kujdesen në mënyrë tjetër. Ky tip i të mësuarit u jep studentëve *energji* që u nevojitet për të mësuar më shumë dhe shndërrimi i mësimi si pjesë përbërëse e jetës së tyre.
- **Të mësuarit si të mësojmë** – Të mësuarit për vetë procesin e mësimi – si të jeni studentë më i mirë, si të inkuadroheni në ndonjë hulumtim ose si vetë të orientoheni kur mësoni. Vlera e këtij lloji të mësuarit është se i bën studentët *të aftë për të mësuarit e përhershëm dhe më efektiv*.

Kjo qasje e klasifikimit të llojeve të mësuarit nuk është hierarkike, por më shumë racionale dhe interaktive – “Çdo lloj i të mësuarit është lidhur me tjerat dhe arritja e cilitdo lloj të mësuarit, njëkohësisht e rrit mundësinë për arritjen e llojeve tjera të mësuarit... Llojet e ndryshme të mësuarit është sinergjik. Për këtë shkak nuk duhet të pezullohet ndonjë lloj i të mësuarit që të fillojnë me ndonjë lloj tjetër. Në vend të kësaj, kur arsimtari do të gjejë mënyrë si t’u ndihmojë studentëve të arrijnë lloj të caktuar të mësuarit, në të vërtetë mund të avancohet, e jo të zbrapset arritja që studenti e ka arrirë me llojet tjera të mësuarit.”¹³⁵

Krijimi i përvojave të rëndësishme nga të mësuarit për studentët dhe për mësimin është pikërisht ajo që paraqet të mësuarit shërbyes dhe që përpiket të arrijë me atë. Me ‘matjen’ ose ‘evoluimin’ e një ose më shumë lëndëve me të mësuarit shërbyes vetëm e kompletton rrethin në të cilin pjesë/nënsisteme thelbësore janë gjithashtu ‘planifikimi’ dhe ‘implementimi’. “Nëse ata që e praktikojnë të mësuarit shërbyes, nuk e ‘kompletojnë kursin’ me vlerësim dhe integrim të gjetjeve në vetë programin ose dizajnin e lëndës mësimore, atëherë nuk vlen të shpenzohet kohë që të grumbullohen të dhëna për evoluimin.”¹³⁶

Në bazë të një analize më të gjerë të literaturës së kapshme, autori dhe redaktorët e këtij publikimi mendojnë se një nga mënyrat më të mira të mundshme për kalimin nëpër procesin e revizionit dhe avancimit të planit dhe lëndëve mësimore është të përpiqeni t’u përgjigjeni pyetjeve që vijojnë:¹³⁷

- “A u arritën të gjitha qëllimet këshillëdhënëse?
- Cilat ishin problemet lidhur me ato qëllime që një numër i dukshëm i studentëve nuk kanë arritur t’i arrijnë?
- Programi a ka qenë i suksesshëm vetëm për studentë të caktuar, e jo për të gjithë? Nëse është kështu, cilat dallime ekzistojnë mes dy grupeve?
- Cilat elemente specifike nga programi ishin më pak të suksesshme nga ajo që instruktori/mësuesi ka shpresuar? Nëse janë paraqitur probleme specifike me njësitë mësimore, cila kanë qenë ato?

¹³⁵ Ibid, fq. 32.

¹³⁶ Seifer, Sarena D., and Kara Connors (Eds.), 2007, *Community Campus Partnerships for Health: Faculty Toolkit for Service Learning in Higher Education*, cit., fq. 101.

¹³⁷ The list is taken in its original form from Diamond, Robert M., 2008, *Designing and Assessing Courses and Curricula: A Practical Guide*, San Francisco, CA: Jossey-Bass, A John Wiley & Sons, Inc. Imprint, fq. 298. This book was given by American Councils for International Education to all the participants in Junior Faculty Development Program upon their successful completion in 2009.

- Plani i përgjithshëm mësimor ose vetë lënda janë paguar? A shfrytëzohen me efikasitet resurset dhe koha e studentëve dhe kuadrit mësimor?
- Nëse nevojiten ndryshime të rëndësishme, cilat probleme specifike janë më të rëndësishme dhe cilave probleme duhet t'u jepet prioritet në procesin e revizionit? Prej ku do të fillonin?"

Është e pamundur t'u përgjigjet këtyre pyetjeve pa u grumbulluar, analizuar dhe shfrytëzuar informatat kualitative të cilat janë fituar nga burime të ndryshme, siç janë:

- Baza e të dhënave;
- Fondi i përgjithshëm i njohurive të studentëve, si dhe fondi i përgjithshëm i njohurive për nevojat e disiplinave specifike;
- Prioritetet (qëllimet, qëllimet specifike, misioni, vizioni) e institucionit;
- Njohuri për atë çfarë kompetencash janë të nevojshme që të arrihet sukses në shoqërinë e sotme;
- Pasqyrë e literaturës nga fusha e punës mësimore dhe të mësuarit etj.

Në bazë të këtyre informatave, kuadri akademik duhet t'i identifikojë ndryshimet të cilat janë të domosdoshme që të përmirësohet kualiteti dhe efikasiteti i lëndës ose programit mësimor për të mësuarit shërbyes. Gjatë dizajnit të përmbajtjeve mësimore ose programit mësimor këto informata vazhdimisht shfrytëzohen që të bëhen ndryshime të drejtpërdrejta ose përshtatje në dizajnin, për të cilat nuk janë të domosdoshme disa ndryshime të mëdha strukturore, ose nevojitet shumë kohë për t'u implementuar. Në fazat e mëvonshme nga procesi i avancimit të përmbajtjeve të lëndëve dhe planit mësimor, këto informata janë të nevojshme që të identifikohen problemet me vëllim të madh dhe të formohen njohuri për atë si tërësisht të zgjidhen ose të zvogëlohen problemet. Shumë shpesh, avancimi i lëndëve dhe programit mësimor zhvillohet përmes:

- Rikonstruimit dhe ndryshimit të renditjes së përmbajtjeve të lëndës, me qëllim që të gjendet zgjidhje për problemet e paparashikuara lidhur me lëndët, të cilat janë parakusht për regjistrimin për përcjelljen e një lënde të caktuar, si dhe problemet lidhur me kohën e nevojshme për përfundimin e një njësie tematike;
- Zvogëlimi i vëllimit të nevojshëm të punës lidhur me lëndën;
- Zvogëlimi, bile edhe eliminimi i materialit më pak të rëndësishëm etj.

Pasiqë e gjithë kjo të bëhet, profesorët/ligjëruesit mund të caktojnë cilat aktivitete specifike duhet të ndërmerren.¹³⁸

Autorët dhe redaktorët e *Community Campus Partnerships for Health: Faculty Toolkit for Service Learning in Higher Education* i japin 'këshillat' që vijnë për fillimin e drejt me evoluimin dhe planet për përmirësimin e lëndëve:

- "Pyeteni veten: Kujt i duhet evoluimi?
- Pyeteni veten: Cilët janë stejkholderët kryesor (palët e prekura) të inkuadruar në procesin e evoluimit dhe çfarë dëshirojnë të marrin vesh?
- Caktoni fushat parësore të evoluimit.
- Njihni aspektet e logjistikës dhe politikave adekuate të cilat janë të rëndësishme për realizimin e evoluimit.
- Vërtetoni sa janë shpenzimet për evoluimin.
- Zhvilloni sistem me të cilin në planin për evoluim do të ndërtohet avancim i vazhdueshëm.
- Sa më herët nisni të grumbulloni informata relevante për evoluimin.
- Kontrolloni bazën e evidencës për rezultatet nga të mësuarit shërbyes.
- Kushtoni vëmendje dhe nxjerrin dobi nga mundësitë ekzistuese për grumbullimin e të dhënave evolutive.

¹³⁸ Ibid, fq. 297, 298.

- Njihni mënyrat përmes të cilave partnerët nga bashkësia do të inkuadroheshin në të gjitha fazat e planifikimit të evoluimit dhe vlerësimit.
- Zhvilloni qëllime dhe rezultate reale të cilat janë të rëndësishme për stejkholderët.
- Vendosni qëllime për lëndën.
- Vendosni nën qëllime për lëndën.¹³⁹
- Caktoni cilat ndryshime do të duhet të ndodhin si rezultat i realizimit të programit.
- Nën qëllimet lidhni drejtpërdrejt me aktivitetet të cilat janë paraparë me lëndën.
- Caktoni ndikimin në bashkësi.
- Vërtetoni ndikimin e studentëve.
- Vërtetoni sa është ndikimi i institucionit.
- Shqyrtoni mundësinë për angazhimin e evoluesit të jashtëm nëse është e mundshme ose e domosdoshme.
- Vërtetoni se si do të përdoren rezultatet nga evolimi.
- Dizajnoni plan për diseminim të gjetjeve nga evolimi dhe zbatoni të njëjtin në vepër.
- Shqyrtoni mundësitë për dhënien e bursave.
- Shprehni respekt për meritat dhe krentoni!¹⁴⁰

Përsëri, si në pjesën paraprake të këtij kapitulli, ua prezantojmë studimin e rastit që në formë origjinale është ndërmarrë nga *Community Campus Partnerships for Health: Faculty Toolkit for Service Learning in Higher Education*.¹⁴¹

Analiza e rastit: Evoluimi i ndikimit të bashkësisë përmes iniciativës për partneritet të bazuar në bashkësi

Kjo analizë e rastit është përshtatur me leje të Janet Hamada, Drejtoreshë për zhvillim e Westside Health Authority.

“Partneriteti mes Westside Health Authority, West Suburban Medical Center (WSMC), West Suburban College of Nursing, Loyola University Chicago dhe organizata të tjera është themeluar nga ana e US Department of Commerce dhe nga WSMC. Qëllimi ka qenë të zhvillohet dhe implementohet iniciativa e bazuar në bashkësi e quajtur Every Block A Village Online. Iniciativa ka qenë e dizajnuar t’u mundësojë banorëve të bashkësisë Ostin nga Çikagoja, shkathtësi dhe pajisje të nevojshme për qasje deri te internet resurset shëndetësore dhe të sigurisë dhe t’i adresojë brengat e bashkësisë. Disa qëllim janë vendosur përmes kësaj iniciative. Një pjesë prej tyre ishin angazhimet që të përmirësohet shëndetësia, të rritet siguria dhe të përmirësohet kualiteti i jetës në fqinjësi përmes: 1) zvogëlimit të proporcionit të foshnjave të lindura me masë të vogël të lindur në rajon; 2) zvogëlimi i vizitave të ndihmës së shpejtë në rajon përmes qasjes deri te kujdesi primar, dhe 3) vendosja e Citizen Leaders (CLs) në teknologji, të cilët do të shfrytëzohen si vegël për përmirësimin e bashkësive të tyre. (Citizen Leaders janë rekrutuar nga çdo bllok në Beat 1524 dhe kanë kërkuar pëlqim për shërbim për fqinjët e tyre dhe ua është blerë pajisje për WebTV dhe printer. Ata janë trajnuar për proceset e bashkësisë dhe për përdorimin e internetit dhe janë kontaktuar brenda javës që ta mbështetin përdorimin e tyre të medias së re për komunikim). Studentët e shëndetësisë janë involvuar në lojën fillestare në role të ndryshme.

Ekipi i projekti ka shfrytëzuar qasje hulumtuese për evoluim, i cili ndërmerr aktivitete të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë [Hulumtim përmes pjesëmarrjes së drejtpërdrejt (Participatory research) paraqet qasje partneriteti drejt hulumtimit, i cili, për shembull, përfaqësuesit e organizatave dhe procesit, në mënyrë të barabartë i inkuadron anëtarët e bashkësisë, përfaqësuesit e organizatave dhe hulumtuesit. Gjatë kësaj, të gjithë partnerët kontribuojnë me ekspertizën e tyre, si dhe përmes ndarjes së ndërsjellë të përgjegjësive dhe pronësisë, me qëllim që të përmirësohet mirëkuptimi i fenomenit të caktuar dhe të integrohet dituria e fituar përmes aktiviteteve në drejtim të përmirësimit të shëndetit dhe mirëqenies së anëtarëve të bashkësisë (Israel, B., 2000)]. Gjatë tre viteve, ku ishte siguruar mbështetja financiare, u grumbulluan të dhëna dhe informata, ndërsa ato u shfrytëzuan për

¹³⁹ Vërejtje: nën qëllimet e lëndës do të duhej të jenë edhe të natyrës kualitative dhe kuantitative, duhet të udhëhiqen nga qëllimet e përgjithshme të mësimin dhe direkt ti reflektojnë rezultatet dhe efektet e dëshiruara.

¹⁴⁰ Seifer, Sarena D., and Kara Connors (Eds.), 2007, *Community Campus Partnerships for Health: Faculty Toolkit for Service Learning in Higher Education*, cit., fq. 102 – 107.

¹⁴¹ Ibid, fq. 111, 112.

përmirësimin dhe nisjen e iniciativës në pajtim me nevojat e bashkësisë. Ekipi hasi në të dhëna të tipit sa është pesha trupore gjatë lindjes, ose përdorimi i vizitave urgjente, por gjithashtu edhe disa të dhëna të përpunuara lidhur me ndikimin e përditshmërisë të WebTV-to (televizioni përmes internetit) mbi jetën e liderëve qytetar (Citizen Leaders - CLs). Ekipi mbeti në lidhje të ngushtë me CLs përmes mbajtjes së mbledhjeve, fokus grupeve dhe bisedat vijuese telefonike me qëllim të dokumentimit të përdorimit të WebTV dhe të tregimeve. Disa nga rezultatet sugjerojnë se në bashkësinë e krahasuar, përqindja e peshës së vogël trupore gjatë lindjes është rritur, derisa në bashkësinë partnere përqindja e peshës së vogël trupore gjatë lindjes është zvogëluar. Në momentin e zbatimit të hulumtimit, të dhënat për përdorimin e qendrës urgjente si burim i kujdesit primar, nuk ishin të mjaftueshme që të mund të evoluohet. Në hulumtimet e mëtejshme do të sigurohen të dhëna plotësuese.

Të dhënat e grumbulluara procesuale sigurojnë informata me vlerë rreth ndikimit të teknologjisë mbi jetën e qytetarëve në bashkësi. Gjatë gjithë hulumtimit u vërejtën (u shkruan) shembuj të tregimeve të suksesshme, si dhe anekdota interesante. Shumë nga pjesëtarët e bashkësisë informuan për suksesin në sigurimin e informatave lidhur me shëndetin, sigurinë dhe punësimin, si nga vendi, ashti edhe përmes Sajtit të trajnimeve të rrjetëzuara (Network Training Site). Gjatë tre viteve, ekipi i projektit grumbulloi 450 tregime të suksesshme (storje). Këto storje mund të gjenden në faqen fillestare të (www.ebvonline.org) dhe janë dëshmi për kualitetin e përmirësuar të jetës që e provuan CLs. Në 17 për qind nga storjet e grumbulluara, televizioni përmes internetit (WebTV) u shfrytëzua si vegël përmes cilës ndërmerren aktivitetet për zgjidhjen e disa problemeve personale ose probleme lidhur me bashkësinë. Marrë në përgjithësi, më shumë se 50 për qind nga ueb tregimet kanë përpunuar probleme lidhur me definicionin e gjerë dhe holistik të shëndetit, duke përfshirë edhe problemin e mjedisit të sigurt dhe të pastër të shëndoshë jetësor, punësimi dhe në përgjithësi kualitetin e jetës.”

Ndërtimi i infrastrukturës për lëndën mësimore

Duke marrë parasysh se për përpilimin në lëndëve mësimore dhe aktivitetet në kuadër të bashkësisë gjithnjë është e nevojshme më shumë kohë, se gjatë kësaj dalin më shumë hollësi dhe supozohet se kompleksiteti është më i madh se sa fillimisht ka qenë planifikuar ose është pritur, gjithnjë është e dobishme të ketë pasqyrë të qartë rreth disponimit dhe qasjes së resurseve dhe materialeve të domosdoshme për zhvillim efektiv dhe vendosjen e lëndëve mësimore, në të cilat është integruar të mësuarit shërbyes. Prandaj, procesi i ndërtimit të infrastrukturës së lëndës mësimore fillon me identifikimin e resurseve të dobishme institucionale dhe resurse nga bashkësia të cilat janë të domosdoshme për zhvillimin dhe vendosjen e lëndëve mësimore të lartpërmendura. Faza e ardhshme është krijimi mi të ashtuquajturit ‘plani i veprimt’ sipas të cilit faktikisht do të realizohet zhvillimi dhe implementimi i lëndëve, e zbatimi i tij dhe pastaj vijon njohja e obligimeve dhe përgjegjësi të nxënësve, partnerët nga bashkësia dhe kuadri mësimor në procesin e ndërtimit të infrastrukturës së lëndës. Elementi i fundit nga ky cikël është përgatitja për sigurimin e qëndrueshmërisë së lëndës mësimore për të mësuarit shërbyes.

Gjatë procesit të ndërtimit të infrastrukturës për lëndën mësimore, kuadri mësimor duhet:

- Me kujdes t’i parashih dhe propozojë/vlerësojë barrierat ose faktorët e brendshme dhe/ose të jashtme të cilat do të mund t’i kufizonin ose pamundësojnë efektivitetin e procesit të ndërtimit të lëndës mësimore;
- Të caktojnë se cila pjesë nga planifikimi i lëndës mësimore për të mësuarit shërbyes është më interesante dhe çfarë mund të bëjnë që të vazhdojnë edhe më tej në mënyrë të pasionuar të punojnë në këtë fushë;
- Ta njohin dhe me kujdes t’i shqyrtojnë cilat elemente nga lënda mësimore për të mësuarit shërbyes do të ishin më interesante për partnerët nga bashkësia.¹⁴²

Duke e ndjekur qasjen e prezantuar në *Community Campus Partnerships for Health: Faculty Toolkit for Service Learning in Higher Education*¹⁴³, autori dhe redaktorët e këtij publikimi i sugjerojnë

¹⁴² Ibid, fq. 121.

¹⁴³ Ibid, fq. 124, 125.

komponentët kyç që vijnë ose ‘aktivitetet’ për ndërtimin e infrastrukturës së lëndës mësimore për të mësuarit shërbyes:

1. Njohja e politikave dhe procedurave institucionale të cilat duhet të përcillen që të zhvillohet lënda mësimore;
2. Vlerësimi nëse lënda mësimore duhet të miratohet nga komiteti mësimor shkollor/universitar;
3. Vlerësimi nëse lënda mësimore duhet të miratohet nga Këshilli institucional shkollor/universitar për shqyrtimin dhe vlerësimin e hulumtimeve (Institutional Review Board [IRB]);
4. Studime nëse ekzistojnë disa procese të veçanta të cilat kanë të bëjnë me procesin hulumtues që i ka paraparë Këshilli për shqyrtimin dhe vlerësimin e hulumtimeve në nivel të bashkësisë (Community Review Board);
5. Vlerësimi i kujdesshëm i nivelit të mbështetjes për lëndën mësimore, që është dhënë/ofruar nga udhëheqësit e departamenteve, kuadrit mësimor, studentëve dhe partnerëve nga bashkësia;
6. Vlerësimi dhe planifikimi për plotësimin e nevojave nga kuadri mësimor për lëndën e dhënë;
7. Kërkimi pas mënyrave për inkuadrim të organeve ekzistuese në kuadër të kampit universitar në procesin e zhvillimit të lëndës mësimore për të mësuarit shërbyes;
8. Studimi për t’u vërtetuar nëse ekzistojnë mundësi për shoqatat e studentëve ose grupeve të tjera nga bashkësia universitare që të inkuadrohen në lëndën mësimore;
9. Dizajni dhe vendosja e ‘planit për marketing’ për lëndën;
10. Locimi i hapësirës adekuate për takime dhe planifikimi i lëndës mësimore;
11. Inicimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i interesimit, përfshirjes dhe mbështetjes nga partnerët nga bashkësia;
12. Vlerësimi i resurseve me të cilat disponon bashkësia (nëse ekzistojnë), dhe të cilat do të kontribuonin në realizimin e aktiviteteve nga të cilat përbëhet, ose janë të lidhura me procesin e ndërtimit të infrastrukturës së lëndës mësimore.

Dhe në fund të kësaj pjese, pa hyrë në shumë hollësi, u prezantojmë disa ‘këshilla’ ose strategji nga Seifer dhe Connors (2007) për përpilimin e lëndëve mësimore dhe aktiviteteve programore për të mësuarit shërbyes në nivel të 1) brendshëm¹⁴⁴ dhe të 2) jashtëm¹⁴⁵ të mbështetjes për zhvillimin e të mësuarit shërbyes.¹⁴⁶

“Sistemet për mbështetje të brendshme për zhvillimin e lëndës mësimore për të mësuarit shërbyes

1. Njoftohuni me politikat dhe procedurat institucionale të cilat duhet të përcillen gjatë zhvillimit të lëndës mësimore për të mësuarit shërbyes.
2. Vërtetoni nëse lënda e juaj mësimore do të duhet të marrë pëlqim nga komiteti mësimor.
3. Vërtetoni nëse lënda juaj mësimore dhe/ose aktivitetet shërbyese ndaj bashkësisë, të cilat studentët i kanë ndërmarrë në kuadër të mësimit nga ajo lëndë, do të duhet të marrin miratim nga Këshilli institucional për shqyrtim dhe vlerësim të hulumtimeve.
4. Vërtetoni cilat çështje lidhur me qëndrueshmërinë dhe rreziqet e mundshme duhet të zbulohen dhe shqyrtohen para se të ofrohet lënda mësimore.
5. Kërkoni dhe siguroni mbështetjen për lëndën mësimore nga dekani, shefi i katedrës, kuadrit mësimor, studentëve dhe partnerëve nga bashkësia.

¹⁴⁴ Koment: këtu nën nivel të brendshëm të mbështetjes nënkuptohet mbështetja e cila ekziston dhe/ose është e kapshme brenda kornizave të fakultetit ose universitetit.

¹⁴⁵ Koment: këtu nën nivel të jashtëm të mbështetjes nënkuptohet mbështetja e cila ekziston dhe/ose është e kapshme jashtë nga kornizat e fakultetit ose universitetit.

¹⁴⁶ Ibid, fq. 118 – 121.

6. Caktoni nevojat për kuadrin mësimor për lëndën përkatëse.
7. Hulumtoni pas resurseve të brendshme të cilat mund të shfrytëzohen që të mbështetet lënda mësimore për të mësuarit shërbyes.
8. Vërtetoni nëse shoqatat studentore ose grupet tjera të kampit do të mund të shërbenin si resurs për lëndën mësimore që përmban të mësuarit shërbyes.
9. Dizajnoni dhe implementoni 'plan marketingu' për lëndën mësimore për të mësuarit shërbyes.
10. Gjeni ambient në qytetin universitar për takime dhe planifikim të lëndës mësimore.
11. Njoftohuni edhe me çështjet tjera të cilat janë të rëndësishme nga aspekti i logjistikës, duke përfshirë edhe udhëtimet deri te zyra/selia e organizatave, të cilat janë partnerët të bashkësisë.
12. Caktoni mbledhje informative para fillimit të komponentit shërbyes të lëndës mësimore.
13. Njoftohuni mirë me rregullat e institucionit tuaj për kontroll dhe vlerësim të hulumtimeve, avancimeve dhe marrjen e titullit më të lartë.

Sisteme të jashtme për mbështetje të zhvillimit të lëndës mësimore për të mësuarit shërbyes

1. Siguroni mbështetje dhe zgjoni interesim te personat kompetent ose përfaqësuesit e bashkësisë lokale.
2. Vërtetoni cilat resurse me të cilat disponon bashkësia do të kontribuojnë për realizimin e aktiviteteve lidhur me lëndën.
3. Njihni organin/trupin në nivel të bashkësisë që është përgjegjëse për shqyrtimin dhe miratimin e hulumtimeve dhe projekteve që përmbajnë të mësuarit shërbyes.
4. Mbështetni, shpërbleni dhe dorëzojuni mirënjohje partnerëve nga bashkësia.
5. Njihni burimet e jashtme të financimit.”

Qëndrueshmëria e lëndëve të cilat përmbajnë të mësuarit shërbyes

Qëndrueshmëria e cilësdo lëndë mësimore për të mësuarit shërbyes është kushtëzuar nga shumë të ashtuquajtura 'elemente strukturore' mes të cilave janë:

- Entuziazëm i vazhdueshëm;
- Komunikim i rregullt dhe dhënia konstruktive e informatave kthyes;
- Gatishmëria të pranohen ndryshimet dhe të ndryshohet vetja;
- Masa kritike e partneriteteve, kurseve/lëndëve mësimore dhe pjesëmarrësve;
- Evoluimi rigoroz dhe ri-përsëritja e vlerës shkollore;
- Përkushtim i fuqishëm nga ana e kuadrin mësimor, administratës dhe trupit studentor;
- Integrim i tërësishëm i të mësuarit shërbyes në kulturën e institucionit;
- Integrimi i të mësuarit shërbyes në sistemin e avancimit dhe fitimit të titujve më të lartë;
- Besim i plotë dhe i thellë dhe përkushtim në marrëdhëniet me partnerët nga bashkësia;
- Përpjekje të vazhdueshme të studentëve që në mënyrë konsistence t'u sigurohen kushte për të mësuarit mirë të përpiluar, mirë të strukturuar dhe mitë të përmbajtur dhe përvoja që del nga ofrimi i shërbimit për bashkësinë.¹⁴⁷

Qëndrueshmëria e lëndës mësimore që integron të mësuarit shërbyes mund të sigurohet me ndjekjen e 'hapave' që vijojnë:¹⁴⁸

- **Diversifikimi i burimeve për financim** – Kur shqyrtohen strategjitë për financim, personat përgjegjës që e zhvillojnë dhe e implementojnë të mësuarit shërbyes do të duhet të mendojnë më gjerë dhe në mënyrë më krijuese. Kjo do të thotë se ata duhet:

¹⁴⁷ Seifer, Sarena D., and Kara Connors (Eds.), 2007, *Community Campus Partnerships for Health: Faculty Toolkit for Service Learning in Higher Education*, cit., fq. 126, 127.

¹⁴⁸ Ibid, fq. 127 – 134.

- T'i shqyrtojnë llojet e ndryshme të financimit (për shembull, burimet e jashtme përkundër të brendshmeve, grante projekti përkundër pikave ekzistuese në buxhet, fondet publike përkundër atyre private etj.);
 - Ta njohin relevanten e iniciativave lidhur me rezultatet tjera gjerë të pranuar dhe
 - Të jenë të vendosura në mënyrë strategjike lidhur me qasjen e tyre ndaj financimit.
- **Rritje adekuate me kapacitetin** – Kjo në të vërtetë do të thotë: 1) mirënjohje se të hollat e fituara janë përcjellë me pritje të caktuara, rezultatet të cilat duhet të arrihen dhe raporte të përgjegjësive dhe llogaridhënies dhe 2) mbajtja e fotografisë reale për atë që do të mund të arrihej. Gjithnjë duhet të jesh i kujdesshëm rreth kapërcimit të hershëm të projektit ose institucionit dhe që është më me rëndësi, gjithnjë duhet të mendohet se dëshpërimi të financuesit e parë do të mund ta pengonte qasjen deri te infrastruktura dhe përvojat ekzistuese për mbështetje të buxhetit të madh për lëndën mësimore ose projektin për të mësuarit shërbyes.
 - **Rruajtja e partneritetit financiar derisa hulumtohen opsionet tjera** – Pasi të sigurohen madhësia kritike ose adekuate dhe përbërja e fondit për financim, me rëndësi thelbësore është të punohet në ruajtjen e partneritetit. Për mbajtjen e partneritetit financiar, është e rëndësishme në institucion të gjendet dhe sigurohet roli i rëndësishëm dhe në tërësi të kuptohen përgjegjësitë dhe linjat nëpër të cilat duhet të jepet llogaridhënia dhe nëpër të cilat jepet llogari për atë që është bërë dhe shpenzuar.
 - **Kultivimi i lidhjeve me financuesit** – Kjo në të vërtetë do të thotë hulumtim dhe aplikim i sugjerimeve/qasjeve të ndryshme për inicimin, zhvillimin dhe mbajtjen e lidhjeve të ndryshme në sektorët të ndryshëm të bashkësisë e cila e ofron ndihmë financiare. “Më e rëndësishmja është të jenë pro aktiv në gjetjen e mënyrave që të bashkëpunohet me bashkësinë e cila financon, me çka do të tejkalohen kornizat e procesit tradicional të kërkesës së ofertës (Request for Proposal – RFP).”¹⁴⁹
 - **Shfrytëzimi i mediave** që, nga njëra anë, më së miri arrihet me përvojën, kohën dhe kujdesin më afatgjatë dhe aktivitet aktiv dhe krijues, nga ana tjetër.
 - **Sigurimi i përgjegjësive politike dhe llogaridhënies** që përfshinë:
 - Gjetjen e partnerëve stabil të vërtetë në sistemin ligjdhënës (i cili për nga natyra vështirë parashihet);
 - Fitimi i qasjes deri te fondet publike, bile edhe në kohë në kërkesa mjaft të rrepta, të cilat mund të paraqesin sfidë të vërtetë nga aspekti dhe inkorporimi i tyre në planin buxhetor për lëndën/projektin mësimor për të mësuarit shërbyes;
 - Sigurimi i mbështetjes nga organet e pushtetit (në nivel lokal ose shtetëror) si pjesë nga rrjeti ose konzorciumi më i madh;
 - Vendosja e lidhjeve të fuqishme ligjdhënëse me të cilat fitohen informata, pozita nga të cilat mund të kryhet ndikim etj.
 - **Institucionalizimi (zhvillimi i partneritetit të qëndrueshëm mes bashkësisë dhe kampit universitar)** – “Në publikimin *Benchmarks for Campus-Community Partnerships* të publikuar nga ana e National Campus Compact’s (www.compact.org), qëndrueshmëria përshkruhet si drejtpërdrejt e lidhur me ndjenjën për reciprocitet, që është e lidhur me shkëmbimin e njohurive dhe resurseve. Autorët Gelmon dhe Holland sugjerojnë tre komponentë të cilët janë kyç për qëndrueshmërinë e partneritetit mes bashkësisë dhe kampit universitar: (1) integrimi në misionin e çdo partneri; (2) proces i madh dhe stabil për komunikim, vendosje dhe ndryshime të planifikuara dhe të kuptimësuar dhe (3) evoluim rigoroz dhe i rregullt me rezultate që maten. Integrimi në kuadër të universitetit do të thotë fitimi i pëlqimit për

¹⁴⁹ Ibid, fq. 128.

inkorporimin e pikave buxhetore për financimin e të mësuarit shërbyes nga ana e personit përgjegjës për krijimin dhe realizimin e buxhetit të universitetit. Nga ana tjetër, integrimi i të mësuarit shërbyes në kuadër të bashkësisë nga aspekti financiar sjell në fitimin e mbështetjes nga Këshilli i drejtorëve. Veçanërisht është e rëndësishme definimi i qartë i pritjeve dhe vendosja e mënyrave të kapshme për komunikim dhe forma të komunikimit të rregullt. Evoluimi do të duhej të inkuadrojë edhe elemente formale (shembull për këtë është metodologjia për vetë evoluim që e ka propozuar Andy Furco) dhe elemente joformale (siç janë shënimi i anekdotave). Metodologjia për vetë evoluim i Andy Furco është dizajnuar me qëllim që t'u ndihmojë partnerëve të universitetit në sigurimin e dëshmimeve formale, të qëndrueshme për vlerat edukative dhe hulumtuese në mësimin shërbyes. Për çdo rast, bile edhe bisedat joformale, ku janë përfshirë edhe studentët, mund të mundësojnë informata të vlefshme, të cilat mund të shfrytëzohen për përmirësimin dhe përsosjen e programit.

Në përvojat e përbashkëta nga partneritetet e suksesshme janë radhitur edhe ato ku ka ndodhur zhvendosje e fokusit nga nevojat drejt resurseve që i disponojmë, si dhe situata ku ekziston ndarje implicite e normave dhe proceseve mes partnerëve. Mund të paraqiten vështirësi dhe të jetë pa e pakëndshme gjatë orvatjeve që të zbulohen 'rezultatet e vërteta matëse' që arrihen mes partnerëve. Sidoqoftë, duke marrë parasysh se aspak nuk është e zakonshme prishja e partneriteteve të caktuara, ku dyshimet dhe mosbesimi në sferën e qëllimeve dhe rezultateve të përbashkëta cilat është dashur të arrihen, asnjëherë nuk janë mënjanuar në tërësi, siguri se dyert kanë mbetur të hapura për bashkëpunim dhe se punohet në qëllime, të cilat partnerët padyshim i ndajnë, me rëndësi të jashtëzakonshme është të kalohet nëpër të gjitha pakëndshmëri dhe mospajtime. Gjithashtu është e rëndësishme të mos krijohet anësi drejt definimit të një 'roli të përgjithshëm, gjithëpërfshirës të studentëve', si dhe studentët të cilët janë involvuar në projekte/lëndë me të mësuarit shërbyes, të mos vlerësohen si vullnetarë dhe jo si klasë më e gjerë, por si individë të veçuar me përvoja dhe vlera unike."¹⁵⁰

Seifer dhe Konors (2007) gjithashtu propozojnë edhe strategji me realizimin e të cilave, në një vend, do të përqendroheshin hapa të shumët konkret të ndërlikur mes veti dhe në mënyrë etapore, gradualisht do të realizoheshin ato hapa me qëllim që të arrihet qëndrueshmëri maksimale e projektit/lëndës mësimore/planit mësimor për të mësuarit shërbyes. Për shkak të kufizimit të hapësirës dhe me qëllim të shmangim përsëritje, këto strategji nuk do t'i shqyrtojmë në hollësi. Nga shkaqet e njëjta nuk do ta prezantojmë as veglën/metodologjinë për vet vlerësim të qëndrueshmërisë së programeve/formave për të mësuarit shërbyes. Megjithatë, i nxisim lexuesit t'i shqyrtojnë këto aspekte siç janë prezantuar në *Community Campus Partnerships for Health: Faculty Toolkit for Service Learning in Higher Education* (në pjesën nga faqja 140 deri te faqja 148) ose të njoftohen me veprat e publikuara të Kevin Keeskes dhe Julie Muyllaert nga Western Region Campus Compact Consortium dhe me veprat e Andrew Furco, Campus Compact Engaged Scholar nga University of California-Berkeley Service-Learning Research dhe Development Center mbi të cilat është bazuar kjo vegël.

Praktikumi i formave të mësuarit shërbyes që mbajnë llogari për dallimet kulturore (të mësuarit shërbyes kulturor kompetente - Culturally Competent Service-Learning)

Këtë doracak, do të kishim dashur ta përfundojmë me pasqyrë të proceseve të zhvillimit dhe të implementimit të përvojave me forma të mësuarit shërbyes ku janë përfshirë individë/bashkësi nga kultura dhe shtete të ndryshme. Këto procese nuk janë të izoluar, e as paraqesin 'raste' për vete. "Në çdo nivel të planifikimit të lëndës mësimore për të mësuarit shërbyes, si dhe në procesin e implementimit të tij, duhet të inkorporohet praktikumi i shkathtësive për komunikim dhe bashkëpunim ndërkulturor."¹⁵¹ Me rëndësi të veçantë është të zhvillohet programi mësimor "që përfshinë shkathtësi

¹⁵⁰ Ibid, fq. 129, 130.

¹⁵¹ Ibid, fq. 149.

për komunikim dhe negocim me vështrime të veçanta për dallimet kulturore, që të arrihet tejkalimi i dallimeve në bazë të përkatësisë racore dhe etnike dhe rritja e rasteve për tejkalimin e anësisë personale dhe paragjyqimeve të ai i cili praktikon të mësuarit shërbyes, si dhe të hulumtojë me cilat zbulohet madhësia dhe shkaktuesit e ndryshëm të problemit që ta fitojnë njohurinë e nevojshme (v.j. gjegjësisht të vlerësohen më shumë).¹⁵² Qëllimi thelbësor i inkuadrimin të kompetencave kulturore në planet moderne mësimore dhe veçanërisht në të mësuarit shërbyes është inkorporimi i sferave të vetëdijes, njohurive dhe shkathtësive në praktikën studentore të mësuarit. Kjo nga shkak se studentët hasin në individë të cilët kanë nevojë nga ndihma e natyrës së ndryshme, dhe të cilat janë të ndryshme nga aspekti i racës, gjinisë, përkatësisë etnike, religjionit të tyre, statusit socio-ekonomik, moshës, orientimit seksual dhe aftësive mendore/fizike.¹⁵³

Plani i këtillë mësimor ose lënda mësimore për të mësuarit shërbyes do të duhej të zhvillohet përmes:

- Krijimit dhe implementimit të strategjive efektive për zhvillimin dhe ruajtjen e qasjeve dhe praktikave të cilat mbajnë llogari për dallimet kulturore;
- Vlerësimi i nivelit të integritit të kompetencave për raportet ndërkulturore në zhvillimin e përgjithshëm dhe implementimin e lëndës mësimore për të mësuarit shërbyes në kuadër të bashkësisë dhe në nivel të universitetit;
- Identifikimi i obligimeve dhe përgjegjësi (roleve) të kuadrit mësimor, studentëve dhe partnerëve nga bashkësia në promovimin e qasjes kulturore kompetente dhe praktikave në bashkësinë edhe të kampit universitar.¹⁵⁴

Aktivitetet të cilat e përbëjnë ose janë të lidhura me këtë proces do të duhej të realizohen në: nivel të individit, nivel të partneritetit, nivel institucional, nivel të kuadrit mësimor dhe më së fundi, por jo edhe më pak e rëndësishme, nivel të bashkësisë.

Lexuesit të cilët janë të interesuar më shumë për këtë fushë, do të mund të gjejnë materiale të dobishme në publikimet e botuara nga ana e Qendrës nacionale për kompetenca kulturore pranë Universitetit Xhorxhtaun (National Center for Cultural Competence, Georgetown University) në këtë internet faqe: <http://nccc.georgetown.edu/resources/publicationstype.html#guides>.

¹⁵² E përshtatur nga Anand, R., 1999, *Cultural Competence in Health Care: A Guide for Trainers*, National Multicultural Institute as cited in Katz, Pinna Rea, 2009, *Becoming Culturally Competent: Clinical Service Learning in Physician Assistant Education*, Dissertation No. 114, Marquette University, fq. 29. Gjetet në: http://epublications.marquette.edu/dissertations_mu/114.

¹⁵³ Ibid, fq. 27.

¹⁵⁴ Seifer, Sarena D., and Kara Connors (Eds.), 2007, *Community Campus Partnerships for Health: Faculty Toolkit for Service Learning in Higher Education*, cit., fq. 149.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR PËR KAPITULLIN 2

- Bringle**, Robert G., and Julie A. Hatcher, 1996, 'Implementing Service Learning in Higher Education', *The Journal of Higher Education*, Vol. 67, No. 2, fq. 221 – 239.
- Bringle**, Robert G., and Julie A. Hatcher, 1999, 'Reflection in Service Learning: Making Meaning of Experience', *Educational Horizons*, Summer 1999, fq. 111 – 117, last retrieved on July 28, 2012 from: http://www.westmont.edu/_offices/provost/documents/Curriculum/GE/Workshops/2007%20Service%20Learning%20Workshop/S-L%20Workshop-%20Reflection%20in%20Service%20Learning.pdf.
- Center for Leadership and Service, Division of Student Affairs**, 2010, *Service-Learning Faculty Handbook: Lead. Serve. Grow. 2010 – 2011*, Gainesville, FL: University of Florida, last retrieved on July 27, 2012 from: <http://www.leadershipandservice.ufl.edu/docs/service-learning-faculty-handbook.pdf>.
- Center for Teaching**, *Course Design*, Vanderbilt University, Last retrieved on July 27, 2012 from: <http://cft.vanderbilt.edu/teaching-guides/preparing-to-teach/course-design/>.
- Commuter Affairs and Community Service**, 1999, *Faculty Handbook for Service-Learning*, College Park, MD: University of Maryland, fq. 24. Last retrieved on July 27, 2012 from: http://www.snc.edu/sturzlcenter/docs/UMD_service_learning_faculty_handbook.pdf
- Dee Fink**, L., 2003, *Creating Significant Learning Experience: An Integrated Approach to Designing College Courses*, San Francisco, CA: Jossey-Bass, A John Wiley & Sons, Inc. Imprint.
- DeMers**, Michael N., 2009, 'Using Intended Learning Objectives to Assess Curriculum Materials: The UCGIS Body of Knowledge', *Journal of Geography in Higher Education*, Vol. 33, Supplement 1, fq. S70 – S77.
- Diamond**, Robert M., 2008, *Designing and Assessing Courses and Curricula: A Practical Guide*, San Francisco, CA: Jossey-Bass, A John Wiley & Sons, Inc. Imprint.
- Hauer**, Julie, and Timothy Quill, 2011, 'Educational Needs Assessment, Development of Learning Objectives, and Choosing a Teaching Approach', *Journal of Palliative Medicine*, Vol. 14, No. 4, fq. 503 – 507.
- Katz**, Pinna Rea, 2009, *Becoming Culturally Competent: Clinical Service Learning in Physician Assistant Education*, Dissertation No. 114, Marquette University, fq. 29. Downloadable from: http://epublications.marquette.edu/dissertations_mu/114.
- Koopman**, Maaike, Peter Teune, and Douwe Beijaard, 2008, 'How to Investigate the Goal Orientations of Students in Competence-Based Pre-Vocational Secondary Education: Choosing the Right Instrument', *Evaluation and Research in Education*, Vol. 21, No. 4, fq. 318 – 334.
- Lasker**, Roz D., Elisa S. Weiss, and Rebecca Miller, 2001, 'Partnership Synergy: A Practical Framework for Studying and Strengthening the Collaborative Advantage', *The Milbank Quarterly*, Vol. 79, Issue 2, fq. 179 – 205.
- Milkova**, Stiliana, *Strategies for Effective Lesson Planning*, Center for Research on Learning and Teaching, University of Michigan, Last retrieved on July 27, 2012 from: http://www.crlt.umich.edu/gsis/P2_5.php.
- Molee**, Lenore M., Mary E. Henry, Valerie I. Sessa, and Erin R. McKinney-Prupis, 2010, 'Assessing Learning in Service-Learning Courses through Critical Reflection', *Journal of Experiential Education*, Vol. 33, No. 3, fq. 239 – 257.
- Office of Service-Learning**, 2008, *Syllabus Template for Classes with Service-Learning Components*, Duquesne University, Last retrieved on July 27, 2012 from: www.duq.edu/core-curriculum/_pdf/syllabus-sl.doc.
- Seifer**, Sarena D., and Kara Connors (Eds.), 2007, *Community Campus Partnerships for Health: Faculty Toolkit for Service Learning in Higher Education*, Scotts Valley, CA: National Service-Learning Clearinghouse, Retrieved on June 02, 2012 from: http://www.uri.edu/acadsupp_services/slearn/documents/HEtoolkit.pdf
- Whitty**, Geoff, and Elizabeth Willmott, 1991, 'Competence-based Teacher Education: Approaches and Issues', *Cambridge Journal of Education*, Vol. 21, Issue 3, Available online from Academic Search Complete Database, Retrieved in HTML format on June 15, 2012.

ON-LINE RESURSE TJERA PËR KAPITULLIN 2

- Service Learning Workbook**. Last retrieved on July 27, 2012 from: <http://www.purdue.edu/servicelearning/documents/workbook.pdf>
<http://nccc.georgetown.edu/resources/publicationstype.html#guide>.

KAPITULLI 3

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE DHE HAPA TË ARDHSHME TË MUNDSHME

Siç u përmend në parathënien e kryeredaktorit, *qëllimi* kryesor i këtij publikimi është të theksohet rëndësia e metodologjisë së të mësuarit shërbyes dhe të sqarohet si do të mund e njëjta të shfrytëzohet në ndërtimin e sinergjisë multi dimensionale dhe nga më shumë kënde mes kuadrit mësues, studentëve, institucioneve dhe bashkësisë më gjerë dhe atë në mënyrë që do t'i afronte të gjithë ata në përpjekjet e përbashkëta që të arrihet plotësimi i nevojave të përbashkëta dhe një mënyrë më e lirë dhe e plotësuar e jetës. Përveç kësaj, ky publikim ka për qëllim që ta forcojë vetëdijen se të gjithë ne duhet t'i bashkojmë forcat në 'luftën' për nevojat e përbashkëta dhe jetë më të mirë, si dhe qëndrimi se duhet të bëjmë çdo gjë që është në fuqinë tonë që t'i garantojmë, sigurojmë, mbrojmë dhe promovojmë të drejtat e barabarta të personave me handicap/invaliditet/pengesa në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fushat e jetës dhe më gjerë, në shoqëri.

Në përgjithësi edhe ata që punojnë si edukatorë dhe ata që mësojnë, arrijnë nivele të ndryshme të zhvillimit intelektual, social dhe moral. Ajo që është me rëndësi esenciale është se të gjithë ne luajmë rol të ndryshëm si pjesëmarrës aktiv në interaksionin e quajtur 'proces i të mësuarit' – rol i cili na imponon të mendojmë në mënyrë krijuese dhe pastaj, të reflektojmë sipas një aktiviteti të caktuar në të cilin kemi qenë të involvuar. Derisa punonim në këtë publikim, vazhdimisht e kishim parasysh faktin se si ligjërues dhe arsimtarë, të gjithë ne kemi obligim ta nxisim interesimin e studentëve të mësojnë dhe ta 'zgjojnë' kërshërinë e tyre; të krijojmë situata nëpër të cilat me të vërtetë mësohet; t'i studiojmë dhe nxisim përvojat potenciale të atyre që mësojnë; t'i zgjedhim ata për të cilët mendojmë se kanë gjasa më të mëdha që të mësojnë diçka; t'i vlerësojmë rezultatet e arritura dhe më në fund, të vlerësojmë cilat qëndrime janë të volitshme për rritjen e vazhdueshme dhe zhvillimin.¹⁵⁵

Nxitjen për punën tonë e shternim nga veprat e shkencëtarëve dhe edukatorëve siç është Dewey, i cili e veçon **filozofinë e përvojës si një nga qasjet më adekuate për punën pedagogjike**. Në këtë mënyrë, ka menduar Dewey, ndërlidhen teoria dhe praktika, si dhe shkollat (institucionet arsimore) dhe bashkësia. Vetë të mësuarit paraqet proces, proces aktiv i cili zhvillohet nëpërmes interaksionit të atij që mëson dhe atij që edukon, mes rrethimit dhe studentëve. Prej këtu vijon se suksesi i procesit të mësuarit rritet për shkak se: 1) leksionet dhe materiali i mësuar në mënyrë të drejtpërdrejt janë implementuar në praktikë dhe 2) ai që edukon, e ka ngritur vetëdijen dhe ndërgjegjen dhe në memorien e studentëve ka mbjellë ndjenjën për kujdes dhe ngushëllim. Më këtë vihet shenjë, mbetet përshtypje e përgjithshme në kujtimet e studentëve për përvojën që e kanë fituar, e kjo përshtypje vështirë mund të fushat pikërisht për shkak të vetë përvojës që është ofruar dhe të cilën e kanë fituar ata që kanë mësuar.

Bile edhe ata që paraqiten në rolin e edukatorëve nuk janë imun ndaj efekteve të cilat dalin nga mënyra e të mësuarit. Aq më shumë, kur ekziston interaksion mes shërbimit që i ofrohet bashkësisë, në modelet mendore ose perceptimet e edukatorëve ndodh ndryshim i thellë lidhur me vetë procesin e të mësuarit dhe rolin e tyre të personave që 'sigurojnë', gjegjësisht 'ofrojnë' njohuri dhe mundësi për

¹⁵⁵ E përshtatur nga Hironimus-Wendt, Robert J. and Larry Lovell-Troy, 1999, 'Grounding Service Learning in Social Theory', *Teaching Sociology*, cit., fq. 364; Taylor, Pamela G., 2002, 'Service-Learning as Postmodern Art and Pedagogy', *Studies in Art Education*, cit., fq. 127, 128.

të mësuar [Brzozowski et al., 2012; Eyler et al. 2001].¹⁵⁶

Siç u përmend edhe më herë “Aktivitetet e dizajnuara me kualitet të ofrimit të shërbimit u besojnë të rinjve role, me të cilat kontribuojnë për shkollën/fakultetin e tyre dhe për bashkësinë, të punojnë bashkë me moshatarët e tyre dhe të afërmit dhe të fitojnë përvoja të rëndësishme të cilat dalin nga puna në kuadër të bashkësisë.”¹⁵⁷ Karakteristika e përbashkët e pothuaj të gjitha aktiviteteve të dizajnuara me kualitet dhe të suksesshme për ofrimin e shërbimit dhe projekteve për të mësuarit shërbyes, është se të gjithë ato mbështeten në ‘rregulla’ të caktuara ose ndjekin hapa të caktuar për ndërmarrjen e aksionit, me qëllim që të plotësohen, ndërsa ndonjëherë me mundësi edhe të tejkalohen qëllimet paraprakisht të hartuara të projektit. Pa kurrfarë qëllimi të proklamojmë se e ofrojmë ‘RECEPTIN E VETËM VEPRUESE’ për implementim të suksesshëm të mësuarit shërbyes në arsimin e lartë, se duhet t’i kushtohet vëmendje aspekteve që vijojnë:

1. Duhet të identifikohen mundësi interesante, gjegjësisht mundësi të cilat zgjojnë interesim dhe mahnitje (këtu nën mundësi mendohet për aktivitetet ekzistuese dhe/ose projektet e reja).
2. Të rinjtë duhet të ndërlidhen me përvojat e reja të cilat përkujnë me interesimet dhe qëllimet e tyre personale dhe arsimore.
3. Është e domosdoshme që të caktohen qëllime të qarta dhe reale për përvojat e ofrimit të shërbimit në bashkësi.
4. Aktivitetet shërbyese gjithnjë duhet të jenë inkluzive.
5. Studentët në mënyrë efikase dhe të natyrshme duhet të involvohen, e gjithashtu të jenë efektiv edhe gjatë projektit me të mësuarit shërbyes.
6. Në çdo aktivitet programor duhet të inkorporohen mundësitë që studentët të mendojnë (reflektojnë) për aktivitetin ose shërbimin.
7. Suksesi dhe ndikimi i programeve për të mësuarit shërbyes duhet vazhdimisht të mbikëqyren, vlerësohen dhe avancohen.¹⁵⁸

Përvoja jonë nga faza e implementimit të projektit “Sigurimi i qasjes së barabartë për personat me handicap/invaliditet/pengesa përmes të mësuarit shërbyes” tregoi se ‘receta’ e tillë me të vërtetë mund të zbatohet në vepër. Për shembull, anëtarët e ekipit të projektit arritën të identifikojnë një sërë të mundësive, të cilat mund t’i ofrohen bashkësisë së personave me handicap/invaliditet/pengesa dhe të cilat kanë potencial të rriten në projekte solide, që zbatohen lehtë dhe të suksesshme. Në kuadër të këtij projekti u vlerësua qasja e përgjithshme në kampet universitare dhe u identifikuan çështjet/problemimet më të hidhura. U propozuan zgjidhje në dy nivele:

- Zgjidhje të cilat janë të realizueshme bile dhe kur nuk ekziston kurrfarë ose ekziston involvim minor dhe angazhim në nivel të institucionit dhe
- Zgjidhje për të cilat është e domosdoshme angazhim më i rëndësishëm institucional.

Me zgjidhjet janë përfshirë spektër i gjerë i çështjeve të cilat lëvizin nga çështje teknike, fizike përmes atyre institucionale, çështje lidhur me planin arsimor, e deri te çështjet juridike (technical, physical, institutional, curricular and legal issues ose shkurtimisht: TechPhInCuLe). Më shumë informata për analizat konkrete të rasteve të mësuarit shërbyes në kuadër të projektit tonë do të mund të gjenden në atë ashtuquajturat ‘tregime për të mësuarit shërbyes të suksesshëm’, që është planifikuar të publikohen si publikim i veçantë. Por, bile edhe kur të publikohet ky publikim, ne nuk mendojmë se me këtë, lista e projekteve të cilat janë të domosdoshme të ndërmerren në shoqëritë tona, do të jetë finale dhe sedo të

¹⁵⁶ E përshtatur nga Brzozowski, Bonnie, Nicholas Homenda, and Loriene Roy, 2012, ‘The Value of Service Learning Projects in Preparing LIS Students for Public Services Careers in Public Libraries’, *The Reference Librarian*, cit., fq. 35, 36; Community Service-Learning Center, University of Minnesota, *Benefits of Service-Learning*, <http://www.servicelearning.umn.edu/info/benefits.html>, cit.; Eyler, Janet, Dwight E. Giles, Jr., Christine M. Stenson, and Charlene J. Gray, 2001, *At a Glance: What We Know about the Effects of Service-Learning on College Students, Faculty, Institutions and Communities, 1993 – 2000*, Third Edition, cit, fq. 8.

¹⁵⁷ Carter, Erik W., Beth Swedeen and Colleen K. Moss, 2012, ‘Engaging Youth with and without Significant Disabilities in Inclusive Service Learning’, *Teaching Exceptional Children*, Vol. 44, No. 5, fq. 46 – 54, fq. 47.

¹⁵⁸ Ibid, fq. 48.

prezantohen të gjithë shembujt e mundshëm. Përkundrazi, ne i nxitim të gjitha palët e prekura relevante (stejkholderët) që t'i bashkojnë forcat që të identifikohen çështjet e reja shoqërore, ekonomike dhe institucionale në sferën e sigurimit të qasjes së barabartë dhe të drejtave të barabarta për personat me handicap/invaliditet/pengesa për zgjidhjen e të cilave nevojitet qasje efektive e domosdoshme.

Më tej, studentët nga universitetet të cilët marrin pjesë në këtë projekt, punuan në lloje të ndryshme punuese. Disa nga këto detyra ishin dizajnuar veçmas nga ana e ligjëruesve të tyre dhe nga vetë ata. Detyra tjera janë integruar në programet ekzistuese mësimore dhe përshkrim i lëndëve mësimore dhe përputhen me prapavijën profesionale, përvojat, interesimet arsimore të qëllimeve të studentëve dhe të edukatorëve. Për shembull, një pjesë e ekipit tonë ishin studentët të cilët studionin lëndë të ndryshme duke u nisur nga inxhinieria, drejtësia, përmes krijimit të politikave, ekonomisë, marrëdhënie me opinionin, psikologjia, gjuhët e huaja, siguria, arti, sporti, arsimit special, veterinaria, e deri te pedagogjia, filozofia, gazetaria etj. Të gjithë punonin nën mentorin të profesorëve të tyre dhe ndihmuan të forcohet bindja jonë se të mësuarit shërbyes mund të aplikohet dhe të implementohet në çdo disiplinë, lëndë ose program mësimor të mundshëm.

Qëllimet e projekteve konkrete të mësuarit shërbyes në të cilat punuan studentët nën koordinim të arsimtarëve, të cilët gjithashtu morën pjesë në projekt, u definuan në mënyrë reale dhe me realizimin e tyre të bashkësisë së targetuar të personave me handicap/invaliditet/pengesa, iu ofruan sa më shumë shërbime. Atje ku kjo nuk ishte e mundur në mënyrë të drejtpërdrejtë, qëllimet e projektit u miratuan si shërbim indirekt që duhet t'i ofrohet gjithë bashkësisë. Detyrat e punës për të mësuarit shërbyes të cilat u definuan, promovuan dhe u zbatuan përmes punës në terren të studentëve përfshijnë aktivitete të cilat janë lidhur ngushtë me jetën, nevojat, mundësitë dhe vullnetin e lirë të personave me handicap/invaliditet/pengesa dhe anasjelltas, informata kthyesë, komente dhe reagime të cilat arrinin nga personat me handicap/invaliditet/pengesa gjatë kryerjes së përfundimit të detyrave të punës, ishte diçka që DUHEJ të arrihet.

Duke marrë parasysh se detyrat e punës për të mësuarit shërbyes u realizuan në kuadër të planeve dhe programeve ekzistuese mësimore, edukatorëve iu mundësua autonomi e plotë në pikëpamje të modaliteteve të dhënies së kredive për punën që e kanë bërë studentët. Profesorët kanë mundur të zgjedhin nëse gjatë vlerësimit vetëm disa përqindje nga vlerësimi final do të dedikohen për detyrat e projektit të mësuarit shërbyes ose do t'u japin studentëve të gjitha kreditë e parapara për kryerjen e asaj lënde varësisht nga pesha, përfshirja dhe korniza të parapara për realizimin e detyrës së punës dhe realizimin e mësimit për një lëndë përkatëse. Pa marrë parasysh formën, në fillim të çdo semestri, gjegjësisht para fillimit me mësime nga lëndë të caktuara, studentët janë informuar në kohë për dobitë potenciale, mbështetjen dhe për përfitimet të cilat priten të arrihen me inkuadrimin e tyre në projektet e të mësuarit shërbyes. Në këtë mënyrë me studentëve, kuadrit mësimor nga fakultetet dhe bashkësia qëllimore e zgjedhur u formua mundësia për fitim të trefishtë. Më tej, derisa realizoheshin projektet për të mësuarit shërbyes, edukatorët kishin përgjegjësi të identifikojnë, dizajnojnë dhe t'i udhëheqin obligimet e punës të studentëve dhe atë në mënyrë që do të zgjonte mendim për nevojat, qasjen, mundësitë, të drejtat dhe vlerat e personave me handicap/invaliditet/pengesa.

Më në fund, anëtarët e ekipit që e realizuan këtë projekt fituan njohuri të mëdha të rëndësishme lidhur me strategjitë për monitring, evoluim dhe vlerësim të kryqëzuar të arritjeve tona nga ana e të gjithëve që ishin të inkuadruar në projekt (persona që e realizuan procesin mësimor dhe arsimor, studentët, institucionet arsimore dhe bashkësia). Të gjithë ne mendojmë se me publikimin e:

- Përmbledhjes së drejtimeve (doracakut) për implementimin e suksesshëm të metodologjisë për të mësuarit shërbyes;
- Përmbledhjen e analizave të rastit të përvojave të suksesshme me të mësuarit shërbyes në Maqedoni dhe Kroaci, si dhe me
- Përmbledhjen e udhëzimeve për edukatorët dhe studentët lidhur me atë se si t'u qaset dhe të komunikohet me personat me handicap/invaliditet/pengesa.

u dha kontribut i rëndësishëm për fondin e njohurive dhe për praktikën nga sfera e të mësuarit shërbyes. Kjo përmbledhje e publikimeve do të ofrohet në mënyrë transparente opinionit të gjerë – falas dhe në format të volitshëm për shkarkimin e lirë nga internet faqja e projektit tonë.

Në fund, do të kisha dashur t'u bej thirrje krijuesve të politikave, para së gjithash në sferën e arsimit, punës sociale dhe marrëdhënieve të punës, por edhe më gjerë, të sigurojnë 'tokë të shëndoshë' për inkorporimin e përvojave tona në sistemet e arsimit sipëror në Maqedoni dhe Kroaci. Përveç kësaj, theksojmë se përvojat tona dhe 'leksionet që ne i mësuam', pa marrë parasysh nëse janë lidhur me rezultatet pozitive ose negative, do të mund të jenë me rëndësi të madhe për përpjekjet e ardhshme për zgjidhjen e nevojave dhe problemeve të personave me handicap/invaliditet/pengesa të cilat ishin jashtë fushëveprimit të këtij projekti. Për shembull, institucionet relevante do të mund të mendonin për: 1) inkuadrimin e metodologjisë për të mësuarit shërbyes në programet arsimore në universitetet shtetërore dhe/ose private në Maqedoni dhe Kroaci, si dhe për 2) integrimin e të mësuarit shërbyes në të gjitha nivelet e arsimit në Maqedoni dhe/ose Kroaci, bile edhe më gjerë në vendet nga Evropa Lindore dhe Juglindore, të cilat përpiqen të qasen dhe të fitojnë anëtarësim të plotë në Bashkimin Evropian.



ALUMNI ENGAGEMENT INNOVATION FUND



STATE ALUMNI
YOUR GLOBAL COMMUNITY